# GAZETA SHQIPTARE







Kryeredaktor: Erl MURATI
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com

Viti XXIV - Nr. 7534 E diel 20 Maj 2018 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)







Opinioni i Ditës

Nga FATOS ÇOÇOLI

## Çelja e negociatave dhe zhurmënaja 'Xhafaj'



Kur në mars 2005 Komisioni Evropian, qeveria e BE-së, i rekomandoi Parlamentit të Bashkimit Evropian të miratonte hapjen e negociatave për Kroacinë ...

Vijon në faqen 21

Opinioni i Ditës

Nga VASIL KURETA

## Populistët në Itali, me një kontratë për qeverinë e ndryshimit



Pas negociatave të zgjatura e të vështira, më së fundi duket që një qeveri e re, pas asaj "Xhentiloni", do të drejtojë Italinë fqinje. Mësohet se drejtuesit ...

Vijon në faqen 22




Jetmir Olldashi: Vlora është pa kontroll

# Gazetari: I vura pajisje regjistrimi dëshmitarit para takimit me Xhafajn

Rama: Zhytu Lulzim më thellë në llum, pres ekspertizën. Basha: Qeveria, skenar kriminal

Gazetari Jetmir Olldashi, i cili intervistoi të ashtuquajturin "dëshmitari X", Albert Veliun ka marrë përsipër dje se kjo ngjarje, ku denoncohet përfshirja e vëllait të ministrit të Brendshëm, Agron Xhafaj në afera droge ka qenë një investigim që ai e ka nisur për ta publikuar në televizionet ku ka punuar. Në një dalje për mediat, Olldashi ...

Në faqen 2

KORÇE/ FLET NENA E 3 FEMIJEVE: E VRAU POLICIA, KISHTE SHENJA DHUNE

# I RIU VDIQ NE KOMISARIAT, GRUAJA: GJILPERA NE TRUP

27-vjeçari Enea Ftoj ndërroi jetë pas arrestit, sekuestrohen kamerat e sigurisë. Identifikohen 3 policët e dyshuar. Familjarët: Duam drejtësi





*(Në foto)* Entela Ftoj, bashkëshortja e 27-vjeçarit Enea Ftoj

Në faqen 7

LISTA EMERORE

## Të përndjekurit, ja si do ndahen 263 milionë lekë si dëmshpërblim

Në faqen 8

INTERVISTA

## Drejtësia, Rama: "Peshat e rënda" janë nën kontroll, më parë s'prekeshin

Në faqen 5

SHKATERROHET GRUPI

## Prostitucion e pastrim parash, 11 persona në gjyq në Shkodër

Në faqen 7

INTERVISTA

## Autori italian: Italia që ëndërronte Enveri dhe mbreti ynë i përbashkët

Në faqen 12

EMRAT PER KOMPENSIM



## Pronat në Fier, lista e dytë me 1 mijë dosjet që po shqyrton ATP

Në faqet 10-11

MILOSAO

Arben Biçoku: Si arkitekt, nuk jam kundër kullave. Ja simbolikat e Tiranës

# Piramida, pse jo një Bibliotekë Kombëtare?

*Në brendësi: Letërsi e angazhuar nga Silvana Leka. Vizatimet e Maks Velos*

Nga BEN ANDONI

Piramida po shndërrohet në një qendër multifunksionale ashtu si në Tiranë janë zhvendosur në kohë të ndryshme shumë nga objektet e dikurshme. Për ekipin e ri të bashkisë, ky quhet një novacion, por





për Tiranën është humbja e një simboli të jashtëzakonshëm, që mund t'i shërbente Shqipërisë me atribute të tjera shumë më simpatike... Z. Biçoku, ju e njihni më së miri historinë e arkitekturës në Shqipëri, së bashku ...

Suplement

# ÇESHTJA "XHAFAJ"

## DESHMITE

Përplasja e dëshmive, Jetmir Olldashi: Biseda me Agron Xhafajn, në praninë time

# Gazetari që intervistoi "dëshmitarin X": I vura pajisje regjistrimi Veliut

## *"Investigimi, gjendja në Vlorë jashtë kontrollit"*

Gazetari Jetmir Olldashi, i cili intervistoi të ashtuquajturin "dëshmitari X", Albert Veliun ka marrë përsipër dje se kjo ngjarje, ku denoncohet përfshirja e vëllait të ministrit të Brendshëm, Agron Xhafaj në afera droge ka qenë një investigim që ai e ka nisur për ta publikuar në televizionet ku ka punuar. Në një dalje për mediat, Olldashi u shpreh: "Historia e këtij investigimi fillon pasi u telefonova nga një burim, i cili më tha se donte të më njihte me një person që kishte të dhëna lidhur me trafikun e drogës në qytetin e Vlorës. Burimi më dërgoi një numër telefoni. E kam telefonuar personin të cilin ju tashmë e njihni me emrin Albert Veliu. Kam dëgjuar rrëfimet e tij mbi situatën e drogës në Vlorë dhe pas disa takimesh, vendosa të shkoja në terren". Më tej gazetari Olldashi tha se bashkë me dëshmitarin Veliu shkuan në Vlorë, në lokalin e vëllait të ministrit Xhafaj dhe pasi nuk e gjetën, i telefonuan Agron Xhafajt. "Pas kësaj, kur u larguam nga lokali, Albert Veliu telefonoi në praninë time numrin 0672014472 për të cilin më tha se është numri i Agron Xhafajt, të cilin në të gjitha bisedat që kryente me të, e quante Pasha. Numrin e verifikova në 'True Caller' dhe rezultoi që ishte i regjistruar me emrin Goni Xhafaj! Pas bisedës telefonike, Albert Veliu u kthye në lokal, ndërkohë që unë qëndrova në lokalin përballë. Theksoj se në të gjitha takimet i kisha vënë një pajisje regjistruese Albert Veliut. Alberti erdhi menjëherë pas takimit me Agron Xhafaj (Gonin) dhe unë i mora pajisjen e regjistrimit të bisedës që i kisha vënë. Nga zbardhja e bisedës së përgjuar që është bërë tashmë edhe publike, Albert Veliu i kishte kërkuar Agron Xhafajt ndihmë për të siguruar dhe trafikuar një sasi kanabisi në drejtim të Italisë dhe Agron Xhafaj e kishte dërguar tek një person për të mbaruar punë", tregoi dje gazetari Olldashi. Por, në fakt, një ditë më parë, në dëshminë e tij, Albert Veliu tha se nuk e kishte përgjuar ai Agron Xhafajn. Olldashi tregon më tej, se si shkuan "në një lokal, i cili sipas Albertit njihej si lokali poshtë Habilajve. Aty erdhi një person, me të cilin u zhvillua një bisedë për të siguruar sasinë e drogës dhe më pas udhëtuam drejt Tragjasit për të siguruar sërish një sasi tjetër kanabisi". "Nga i gjithë investigimi kam vënë re se pavarësisht raporteve në media se janë goditur grupe kriminale, gjendja në Vlorë ishte jashtë kontrollit", tha ai. Ai thotë se më pas u largua nga emisioni dhe nuk mundi ta transmetonte gjithçka kishte regjistruar. Duke vlerësuar se kjo ishte e rrezikshme për sigurinë e tij, ai vendosi t'ia dorëzonte Partisë Demokratike, që sipas Olldashit kishte interes të denonconte trafikun e drogës. "Iu drejtova opozitës, jo se ishte Partia Demokratike, por edhe sikur të kishte qenë e kundërta që të ishte Partia Socialiste në opozitë, patjetër që do të isha drejtuar tek opozita për të gjetur mbrojtje. Në Partinë Demokratike kontaktova me deputetin Ervin Salianji, një nga deputetët që ka denoncuar trafikun e drogës dhe kanabizimin nga parcelat e hashashit. E informova në detaje për investigimin dhe rezultatet e tij, si garanci për sigurinë e burimit tim dhe sigurinë time personale". Olldashi tha se një pjesë e përgjimit do të transmetohet të hënën.


Kreu i PD-së, Lulzim Basha, gjatë një konference për shtyp


Gazetari Jetmir Olldashi, i cili intervistoi Albert Veliun

### ÇFARË THA "DËSHMITARI X", ALBERT VELIU?

**Në këtë aventurën tënde që thua se e provove, e bëre, ke bërë filmime të tjera?**

**Veliu:** Filmime të tjera unë s'kam bërë, filmime të tjera. Filmimet i ka bërë vetë Agroni, nuk i kam bërë unë dhe aty janë.

**Si i ka bërë?**

**Veliu:** Po ku di gjë unë si i ka bërë, me dashje, pa dashje, i di Agroni, jo unë.

**Po ti thua që Agroni ka përgjuar veten?**

**Veliu:** Po normale, ku di unë ça i është vënë Agronit dhe akuzon Andonin në anën tjetër. Ato të gjitha janë gjëra që janë fakte reale, si zëri që ne kemi folur. Gjithmonë e ha një fukara, nuk e ha një i pasur.

**Po ti vetë kur e kujtove bisedën, kur pe këto video- përgjimet, e kujtove bisedën?**

**Veliu:** Po normale. Kur unë e pashë te djali, te lokali të gjitha këto foljet që u bënë, doli. Të gjitha thëniet që ne kemi bërë, thashë ç'ne këto përgjime ne?!

**Domethënë, ti mendon që Agronin e kanë përgjuar të tjerët?**

**Veliu:** Normale, unë s'kam lidhje.

**Nuk e ke përgjuar ti?**

**Veliu:** Secili ka mbrojtjen e tij ore. Ai tijën, unë timen, po nga ka ardhë kjo, e gjen Agroni, këto përgjime. Këto janë gjërat që po të them unë.

**LUÇIANO BOÇI**

Deputeti demokrat tha dje se dëshmia e gazetarit "rrëzoi çdo pandehmë 'të laboratorëve prestigjiozë' të Ramës dhe po nxit me shpejtësi rrokullisjen e pashpresë të Rilindjes&co. Zhveshi çdo iluzion 'drejtësie' shtetërore e zbuloi implikimin e institucioneve që prodhojnë padrejtësi e hakmarrje politike".

### Nënkryetari i PD-së: Sa më shumë i mbron, zhytet në llum

# Paloka: Edvin, ti me xhevahiret e tu punoni çdo ditë kundër Shqipërisë



Nënkryetari i PD-së, Edi Plaoka, reagoi dje pas deklaratës së kryeministrit Rama, i cili tha se "po pret me durim provën shkencore të audio-përgjimit nga prokuroria dhe këtu jemi, shqiptarët do shohin e do gjykojnë!" Në një postim në "Facebook", Paloka shkroi "Edvin, je ti që me 'xhevahiret' e tu, nga Elvis Roshi tek Sajmir Tahiri e Fatmir e Agron Xhafaj, duke punuar për pushtetin dhe pasurinë tuaj, punoni ditë e natë kundër Shqipërisë e shqiptarëve. E nxori kokën fare pak nga llumi, sa për të treguar se po kapin fundin. Sa më shumë përpiqet dhe i mbron, aq më shumë zhytet në llumin e tij të krimit, aq më i pashpresë bëhet. Dje pasi mashtroi prapë mbi ekspertizën për përgjimin që paskësh bërë vetë, nuk gjente dot derën për të dalë nga salla e konferencës me gazetarët. Sot u përdrodh prapë e deklaroi se po pret ekspertizën e prokurorisë së tij", u shpreh Paloka. "Mblodhi llumin e krimit e drogës dhe ua paraqiti shqiptarëve si xhevahire duke i bërë kryetarë bashkie, deputetë e ministra… Edvin, je ti që me 'xhevahiret' e tu, nga Elvis Roshi tek Saimir Tahiri e Fatmir e Agron Xhafaj duke punuar për pushtetin dhe pasurinë tuaj, punoni ditë e natë kundër Shqipërisë e shqiptarëve. Më 26 maj shqiptarët janë thirrur që të pastrojnë llumin tënd Edvin. Priti tek dera…", u shpreh nënkryetari demokrat i Kuvendit, Edi Paloka.

REDAKSIA: **Redaktor i Suplementeve dhe Sociales:** Rezarta Delisula, **Redaktor i Rretheve:** Trëndafile VISHA, **Redaktor i Kulturës:** Fatmira Nikolli, ***Art Designer:*** Nevila SAMARXHI.
ADMINISTRATA**: Përgjegjëse e Financës:** Alma Smokthina 0682074397, **Shpërndarja:** Elvis Llaka Cel 0682074416, ***Marketingu*:** Cel:0682074415-***email:marketing@gazetashqiptare.com***, **ADRESA**: Ish-Drejtoria e Uzinës së Autotraktorëve, Tiranë - Tel:(04) 2359-104 Tel&Fax:(04) 2359-116 ***Marketingu*:** Tel:(04) 2359-104/359-123. Tiranë, **Internet**: www.balkanweb.com, **Email**: gazetashqiptare@hotmail.com; redaksia@gazetashqiptare.com, **SHTYPUR në "Klasik"Shpk**




## Dëshmia e gazetarit për audio-përgjimin, kreu i PD: Protestë më 26 maj

# Basha: Xhafaj e Rama, skenar kriminal
# Rama: Zhytu Lulzim më thellë në llum

## *Kreu i qeverisë: Pres provën shkencore*

Darina Tanushi

Kryeministri Edi Rama e kryetari i PD-së, Lulzim Basha reaguan dje pas dëshmisë së dhënë nga gazetari Jetmir Olldashi. Pas shfaqjes së konferencës së gazetarit Olldashit edhe në selinë e PD-së, kryeministri Rama iu drejtua kreut të PD-së, me fjalët: "Zhytu Lulëzim, zhytu, thellë e më thellë, nxirr nga fundi i llumit sa më shumë nga këta xhevahire dhe dërgojua vrap miqve të tu t'i përdorin kundër Shqipërisë! Unë do pres me durim provën shkencore të audio-përgjimit nga prokuroria dhe këtu jemi, shqiptarët do shohin e do gjykojnë!". Edhe një ditë më parë, kryeministri tha se ai e kishte marrë përgjigjen e audio-përgjimit nga një laborator prestigjioz dhe është i bindur në faktin se Fatmir Xhafaj duhet të vazhdojë detyrën. Nga ana e tij, kryetari i PD-së, Lulzim Basha, pasi ka ndjekur deklaratën e gazetarit Olldashi, u shpreh para gazetarëve: "Edi Rama edhe dje gënjeu pacipësisht duke pretenduar se ia ka bërë në Surrel ekspertizën dhe se i paska dalë false. Kur gazetarët i kërkuan se në cilën agjenci e ka bërë ekspertizën brenda 24 orëve, heshti dhe i bëri bisht përgjigjes. Kjo për një arsye të thjeshtë: Edi Rama është pjesë e këtij skenari, e këtij komploti për të mbuluar veprat kriminale që janë denoncuar". Sipas kreut të PD-së, "vepra e parë kriminale; Agron Xhafaj vazhdon të jetë një nga kokat e drogës në Shqipëri, bosi i drogës në Vlorë. Kjo është arsyeja se përse, ndërkohë që u mbrojt dhe u mbajt këtu në kundërshtim të hapur me vendimin e drejtësisë italiane dhe në kundërshtim të hapur me ligjin shqiptar derisa ligji u ndryshua nga Fatmir Xhafaj, pa pritur pas denoncimit u përcoll në fshehtësi të plotë dhe me urgjencë që Prokuroria Rama-Marku-Prela të thotë: 'Ne nuk e kapim dot! Nuk e hetojmë dot!'". Basha tha se vepra tjetër penale "përfshin drejtpërdrejt Fatmir Xhafajn, ministrin e Brendshëm, i cili këto 8 apo 9 ditë të denoncimeve ka heshtur, e ka gënjyer dhe ka shpenzuar shumicën dërrmuese të kohës së tij për të mbuluar veprat penale të vëllait të vet me një skenar kriminal". "Fatmir Xhafaj dhe Edi Rama janë sot të dyshuar për veprën penale të mbulimit të veprimtarisë kriminale të Agron Xhafajt, të mbulimit të veprimtarisë kriminale të mosveprimit të ligjit antimafia, të mbulimit të veprimtarisë kriminale të falsifikimin të dokumenteve zyrtare dhe korrupsionit të zyrtarit të lartë në detyrë. Këto janë arsyet përse Fatmir Xhafaj vazhdon të qëndrojë në detyrë. Për të vazhduar manipulimin për të shkatërruar provat, për të intimiduar apo joshur këdo që tregon të vërtetën ashtu siç është dhe jo ashtu siç gënjen Edi Rama dhe Fatmir Xhafaj", akuzoi kreu i PD-së, Lulzim Basha. "Qeveria sot është një organizatë e strukturuar kriminale me ministër të Brendshëm, anëtar të familjes mafioze Xhafaj, që kontrollon drogën dhe aktivitetin kriminal në qytetin e Vlorës. Në krye të kësaj kupole qëndron Edi Rama", tha Basha.



Kryeministri Edi Rama



Kreu i PD-së, Lulzim Basha

**THIRRJA E BASHËS**

"Ju ftoj të gjithëve, të shtunën në orën 11:00, të bashkohemi në protestën kombëtare, për t'i dhënë mesazhin Europës, se Shqipëria dhe shqiptarët europianë do bëjnë gjithçka që qeveria antieuropiane e lidhur me krimin dhe drogën t'i hapë rrugë, përmes çlirimit të vendit nga kjo qeverisje, një qeverisjeje të ndershme, e cila do të realizojë kushtet për hapjen e negociatave", tha dje Basha.

**PROTESTA**

Nisur nga këto akuza, kreu i PD-së, Basha ftoi të gjithë qytetarët të mblidhen në Tiranë, më 26 maj, në orën 11:00 për të protestuar për largimin e ministrit Xhafaj e qeverisë. Më herët ai pati një takim me krerët e degëve për të biseduar detajet e kësaj proteste, që do të nisë tek Ministria e Brendshme. Por, sipas skenarit, nëse Xhafaj ka dhënë dorëheqjen deri të shtunën tjetër, protesta do të mbahet para Kryeministrisë.

## Kryetari i grupit të LSI-së: Prokuroria po rrënon besimin

# Vasili: Ndjekje penale për Ramën, gënjeu shqiptarët për analizat e audio-përgjimit



Kryetari i grupit parlamentar të LSI-së, Petrit Vasili, kërkoi dje ndjekje penale për kryeministrin Edi Rama, për deklaratat e gënjeshtërta sa i përket audio-përgjimit, që implikon vëllain e ministrit të Brendshëm, Fatmir Xhafaj në pazare droge. "Kryeministri gënjeu për audio-përgjimin dhe tani i kapur në faj gjoja po pret ekspertizën. Kryeministri gënjeu paturpësisht dhe tha një javë më parë përpara grupit të tij parlamentar: 'Unë kam kërkuar nga një agjenci e specializuar ndërkombëtare për ekspertizën e këtij incizimi. Unë e kam marrë mbrëmë përgjigjen e analizës shkencore, mua ajo përgjigje më mjafton për t'ju thënë juve se jemi para një akti mashtrimi të opinionit publik me një material joautentik'", citoi kreu i grupit parlamentar të LSI-së, ato çka tha Rama në grupin parlamentar të PS-së. "Sot pas një jave po i njëjti kryeministër, tashmë një gënjeshtar i rëndomtë dhe i çekuilibruar thotë të kundërtën. Ja ç'thotë sot: 'Unë do pres me durim provën shkencore të audio-përgjimit nga prokuroria dhe këtu jemi, shqiptarët do shohin e do gjykojnë!'", u shpreh më tej Vasili. "Ky mashtrues që shpërdoron pacipësisht postin e kryeministrit për të gënjyer shqiptarët duhet të ndiqet penalisht për deklaratat e tij. Kjo prokurori duke mos reaguar ndaj tij po rrënon totalisht besimin e popullit shqiptar tek ajo dhe po dëshmon kapjen e saj të rrezikshme dhe të ndëshkueshme. Përsa i takon kryeministrit, deklaratat e tij gënjeshtare janë shumë të qarta për këdo që di shkrim dhe këndim. Kushdo që përpiqet që t'i japë alibi këtij mashtruesi, vetëm sa tregon shpërlarjen morale të vetvetes", u shpreh Vasili.

## Berisha: Rama dështoi të bindë skeptikët e BE

Ish-kryeministri Sali Berisha deklaroi dje se Rama ka dështuar për të bindur vendet skeptike të BE-së për të hapur negociatat me Shqipërinë. "Të dashur miq, piktori dështak ndërmori këto dy muajt e fundit të ashtuquajturën ofensivë të sharmit për të bindur vendet skeptike të BE për hapjen e negociatave me Shqipërinë. Këtë ofensivë ai e hapi me vizitën e tij në Berlin, në të cilën për shkak të qëndrimeve të tij staliniste mori si 'sukses' bojkotin e paprecedent të darkës së shtruar në 'China Club' prej tij nga grupi politik parlamentar më i fuqishëm në Bundestag dhe në Europë, grupi parlamentar i CDU/CSU. Ky dështim total u shoqërua me një rumor dhe zhurmë mediatike negative në të gjitha vendet, kancelaritë dhe mediat e Europës", tha Berisha. Ai shtoi më tej se mediat gjermane thanë se Rama mori një "Jo" të qartë nga Makron. "Pa u tharë ende boja e 'Jo'-së së fundit, pra të Parisit, Rama mori një goditje fatale në samitin e Sofjes, nga i cili u largua para kohe me bisht ndër shalë dhe këpucë të kuqe, duke i kujtuar kështu zonjës së zezë Nexhmije largimin e burrit të saj dhe të atit shpirtëror të Edvinit nga Samiti i Bukureshtit", tha dje Berisha.



## Manjani: Prokuroria të reagojë, çfarë pret të provojë?

Ish-ministri i Drejtësisë, Ylli Manjani, i ka bërë thirrje prokurorisë të reagojë pas dëshmive të dhëna nga "dëshmitari X" dhe gazetari Olldashi. Përmes një statusi në "Facebook", Manjani u shp-reh: "Çfarë pret nga prokuroria ky mor aman?! Janë dëshmitarët gjallë dhe po deklarojnë çdo ditë se ai takim ka ndodhur dhe ato fjalë janë thënë! Jua tha edhe vetë i zoti i punës, të cilin e çuan në burg për gjithë natën në Itali! Sot jua tha edhe gazetari, që është një punë investigative e tij. Siç bëjnë të gjithë gazetarët investigativë në gjithë botën. Çfarë rezultati pret nga prokuroria ky?! Nga prokuroria në fakt pritet dhe shumë madje, por jo të vërtetohet që ai takim ka ndodhur ose jo, sepse ai takim ka ndodhur. Kjo është e superprovuar. E kuptoj se s'ka ç'të thotë më. E kuptoj edhe se nuk guxon të hapë 'kutinë e Pandorës' në radhët e rilindasve që presin t'i zënë vendin shokut Fatmir", u shpreh më tej, Manjani, duke e cilësuar këtë "krizë të rëndë".

# ÇESHTJA "XHAFAJ"

## REAGIMET

Kreu i grupit të PS: Do të kishim marrë masa, nëse "Babale" do ishte e vërtetë

# Balla: Opozita dhe gjyqtarë të korruptuar inskenuan kundër Xhafajt

*"Shantazhi ndaj ministrit, për të mos lejuar vetingun"*

Darina Tanushi

Kryetari i grupit parlamentar të Partisë Socialiste, Taulant Balla, u shpreh dje se në atë që PS e quan "inskenim" ndaj ministrit të Brendshëm, Fatmir Xhafaj janë përfshirë edhe gjyqtarë të korruptuar. Gjatë turit të llogaridhënies së qeverisë në Librazhd, Balla tha se në këtë inskenim janë të përfshirë jo vetëm politikanë të korruptuar si Saliu, Monika, Luli, por edhe gjyqtarë të korruptuar, duke qenë se vetingu do t'i pastrojë nga sistemi i drejtësisë. "Ne do të kishim marrë masa të ashpra ndaj kujtdo, nëse një e një mija e kësaj historie me 'Babalen' do të ishte e vërtetë. Por gjithë ky inskenim shantazhi ndaj Fatmir Xhafajt si ministër vjen për shkak të luftës pa kompromis që ky i fundit i ka shpallur krimit të organizuar. Dhe në këtë inskenim janë të përfshirë jo vetëm politikanë të korruptuar si Saliu, Monika, Luli etj., por është i përfshirë edhe ndonjë gjyqtar i korruptuar, të cilët duke qenë se vetingu do t'i pastrojë nga sistemi i drejtësisë, u munduan të shantazhojnë ministrin, të shantazhojnë qeverinë, për të mos lejuar vijimin e aksionit 'Forca e Ligjit' dhe për të mos vijuar punën që kemi nisur", u shpreh Balla. Kreu i grupit parlamentar të PS-së reagoi edhe një ditë më parë pas shfaqjes së "dëshmitarit X". Balla e ka quajtur një mashtrues të rëndomtë dëshmitarin Albert Veliu. Sipas tij, PD po përdor një skemë kriminale dhe mafioze për të rrëzuar qeverinë, ndërsa i bëri thirrje urgjente prokurorisë të zbardhë sa më shpejt ngjarjen. Balla theksoi se superdëshmitari i PD duhet të merret menjëherë si i pandehur, ose të merret në mbrojtje nga Krimet e Rënda, duke shtuar se demokratët e kanë paguar superdëshmitarin Veliu. "Asnjëherë deri më sot nuk ishte parë që një parti politike të humbiste kaq rëndë arsyen sa të përfshihej në një skenë kriminale mafioze. Deri dje kemi besuar se interesa të caktuara të grupeve kriminale apo të intrigantëve të ndryshëm kishin shfrytëzuar interesin legjitim të një opozite, të PD, për të gjetur dhe denoncuar fakte nga më të ndryshmet, që ndikon për keq në imazhin e qeverisë. Kemi menduar se naiviteti i Bashës ka bërë që kjo parti të përfshihej në një skenë të pastër të shantazhit kundër ministrit përgjegjës për luftën kundër krimit. Ajo që ndodhi me paraqitjen publike të personit që pretendon se ka qenë në bashkëbisedimin e publikuar nga PD mes tij dhe vëllait të ministrit është tregues i shndërrimit të një partie në një organizatë të rrezikshme, që përdor forma mafioze të adresimit të interesave të saj. Lulzim Basha është autori, regjisori dhe aktori i video-përgjimit të montuar, me të cilin ka shpresën e fundit për të bllokuar vendimin për hapjen e negociatave mes Shqipërisë dhe BE", u shpreh Balla dy ditë më parë. Deri tani, PS i ka shprehur mbështetjen ministrit Xhafaj, i cili po ashtu e sqaroi historinë e vëllait të tij.



Kryetari i grupit parlamentar të Partisë Socialiste, Taulant Balla

**AGRON XHAFAJ**

Pak ditë më parë, pas publikimit të dëshmisë nga Albert Veliu, por edhe akuzave të rënda nga opozita në drejtim të ministrit Fatmir Xhafaj, vëllai i tij, Agron Xhafaj i dënuar në Itali që në vitin 2002 për drogë deklaroi publikisht se do të shkonte të vuante dënimin, edhe pse nuk kishte një kërkesë ndaj tij.



## Koço Kokëdhima: Rilindja e PD po sulmojnë Xhafajn se i ka prekur

Kryetari i partisë "Zgjidhja", Koço Kokëdhima, ka komentuar situatën politike të ditëve të fundit në vend, pas denoncimit nga Partia Demokratike të një audio-përgjimi, që implikon vëllain e ministrit të Brendshëm, Fatmir Xhafaj, në trafikun e drogës. Pas rrëfimit të "dëshmitarit X", PD kërkon dorëheqjen e ministrit Xhafaj. Në emisionin "Kjo javë" me Nisida Tufën në "News 24", Kokëdhima tha se Fatmir Xhafaj po sulmohet nga Rilindja dhe PD, sepse i ka prekur me punën e tij si ministër i Brendshëm prej shtatorit 2017. "Natyrisht që roli vendimtar dhe përgjegjësia vendimtare i kalon kryeministrit të radhës, unë mendoj se Xhafaj është përgjegjës për të gjitha zhvillimet shumë të vështira të Shqipërisë në këto 27 vjet", tha Kokëdhima. "Nuk kam për qëllim që të mbroj Xhafajn, as nuk kam ndonjë raport personal me të, por duhet të jemi realistë në analizat që bëjnë, që të kuptojmë dhe të orientohemi si duhet. E më pas duhet të identifikojmë aktorët dhe të kuptojmë lojën e tyre. Partitë e vjetra, kryesisht PD dhe PS janë parti të kriminalizuara, që kanë kriminalizuar gjithë shtetin shqiptar dhe e kanë sjellë vendin në këtë derexhe. Të mos zgjatemi, pasi populli këto gjëra i di shumë mirë. Kanë shkatërruar ekonominë, kanë vjedhur gjithçka dhe kanë kriminalizuar gjithçka", tha kreu i "Zgjidhja". "Kjo polici me ministër Fatmir Xhafajn nuk është më kartel i drogës, por është Polici e Shtetit. Na pëlqen apo s'na pëlqen ne, Fatmir Xhafaj e ka vënë këtë polici në shërbim të rendit dhe të sigurisë, dhe sigurisht që ky është një zhvillim i padëshiruar për partitë e vjetra, të cilat punojnë në bashkëpunim krejtësisht të ngushtë me njëra-tjetrën. Rama dhe PD janë një, kush nuk e kupton është thjesht një qorr, ose një i paguar, ose një njeri i leshtë. Ata punojnë bashkë, kanë kapur bashkë shtetin, i japin siguri të plotë njëri-tjetrit", u shpreh Kokëdhima.





## Presidenti Meta me fëmijët jetimë: Shqipëria pa jetimë, edhe më pranë BE-së

Presidenti i Republikës, Ilir Meta, në bashkëpunim me Institutin Kombëtar të Integrimit të Jetimëve Shqiptarë organizoi një pritje me fëmijë dhe të rinj jetimë, në kuadër të 20 majit Dita Kombëtare e Jetimëve. Gjatë bisedës me fëmijët e të rinjtë, Meta vlerësoi edhe sloganin që kishin zgjedhur "Shqipëria pa jetimë, edhe më pranë BE-së". Në fjalën e tij gjatë këtij aktiviteti, Presidenti Meta u shpreh: "Që kur kam marrë detyrën si President i Republikës, e kam bërë të qartë që kujdesi ndaj fëmijëve jetimë do të jetë prioritar. Ju me të drejtë keni sjellë me vete edhe sloganin 'Shqipëria pa jetimë, edhe më pranë BE-së'. Besoj që kjo është një gjetje shumë domethënëse dhe e mençur. Ne në fakt kemi qenë një komb jetim për një kohë të gjatë, derisa kemi gjetur veten dhe besoj se tani nuk jemi një komb i tillë, jemi një komb shumë më i sigurt për të ardhmen e tij. Jemi anëtar në NATO, jemi pranë Bashkimit Evropian dhe shpresojmë të anëtarësohemi në Bashkimin Evropian. Natyrisht që BE ka parime shumë të rëndësishme demokratike, shoqërore, njerëzore, të cilat kanë të bëjnë me përfshirjen sociale, me integrimin shoqëror dhe me detyrimin e shoqërisë për t'u kujdesur për çdo individ, aq më tepër për çdo fëmijë", u shpreh presidenti. Meta tha se, "duhet të marrim më shumë përgjegjësi për të krijuar një ambient më të sigurt, më frymëzues e më angazhues për të rinjtë e për fëmijët, që ëndrrat e tyre t'i shohin të realizueshme pikërisht në këtë mjedis".



Mbledhja e grupit parlamentar të PS-së

Kryeministri flet për median austriake pas samitit të Sofjes: Kemi bërë më shumë se çdo vend

# "Drejtësia", Rama: "Peshat e rënda" janë në kontroll, më parë ishin të paprekshëm

## "Jemi pas derës së BE, ne provuam luftën"

*Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama tha në një intervistë për median austriake "Kurier.at", se procesi i integrimit duhet të jetë i drejtë. "Ne po presim jashtë derës dhe po trokasim prej vitesh për të hyrë", tha ai.*

**Presidenti i Francës, Macron po kërkon që përpara sesa të pranohen vende të reja, BE duhet të reformojë veten nga brenda. A e kupton skepticizmin e tij?**

Europa duhet të ndryshojë dhe vendet e Ballkanit duhet të ndryshojnë, e kuptoj atë. Ajo që kërkojmë është një recetë. Në bisedimet e pranimit, duhet një recetë për një terapi të re për të trajtuar plagët dhe problemet e së kaluarës. Nga bisedimet e pranimit në BE, ka shumë më tepër presion mbi vendet kandidate. Procesi i pranimit është një proces i ndërtimit të shtetit për ne. Sigurisht, ne nuk jemi aty ku duam të jemi akoma. Por për të arritur atje, kemi nevojë për bisedime të pranimit. Përndryshe do të ishte si një martesë për të cilën ju nuk do dëshironi të flisni. Si duhet të përgatitet për të?



Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama dhe presidenti i Francës, Macron

**A ofron BE pranimin dhe në të njëjtën kohë i mban të gjashta vendet e Ballkanit Perëndimor në distancë prej saj?**

Ka një thirrje të fortë për më shumë luftë kundër kriminelëve dhe krimit të organizuar. Shqipëria ka bërë më shumë se çdo vend tjetër para fillimit të bisedimeve të pranimit. Vetëm të marrim reformën tonë gjyqësore: rekomandohet në raportet e progresit të BE-së si një model për të gjitha vendet e rajonit. Asnjë vend para nesh nuk e bëri një gjë të tillë, ndryshuam Kushtetutën, pranuam trupat e huaj. Na u tha: Duhet të ekzaminoni gjykatësit dhe prokurorët tuaj dhe më pas ju merrni "OK"-in për bisedimet e pranimit. Ne e bëmë atë dhe tani jemi duke u akuzuar, ka shumë krime dhe korrupsion? Cila mënyrë më e mirë për të luftuar kundër tij se sa për të ndërtuar një sistem tërësisht të ri gjyqësor? Në Shqipëri nuk ishte një problem për të arrestuar njerëzit, por për t'i dënuar ata. Por gjithmonë mund të thuash që duhet të bësh më shumë.

**Çfarë do të thotë kjo?**

Prej tre muajsh kemi një tribunal të veçantë, ku çdo gjykatës dhe prokuror duhet të zbulojë pasuritë e tij. A ka dy shtëpi? Studimi i fëmijës së tij në një universitet të shtrenjtë në Londër? Nga vijnë këto para? 27 gjyqtarë kishin për të shkuar tashmë, 17 të tjerë nuk u paraqitën në të njëjtën kohë në procedurë. 350 policë kanë lënë shërbimin. "Peshat e rënda" tani janë duke u kontrolluar, më parë ishin të paprekshëm. Tani kemi një revolucion shumë të ashpër, bazuar te reformat.

**DIPLOMACIA EKONOMIKE**

"Ambasadorët shqiptarë duhet të jenë kontakti i parë për kompanitë e huaja, të cilat kanë mundësi të vijnë në Shqipëri", deklaroi zv.ministri për Europën dhe Punët e Jashtme, Etjen Xhafaj, i cili tha se ka pasur një përpjekje proaktive për të realizuar atë që u quajt diplomacia ekonomike.

**A do të kishte Shqipëria një alternativë për anëtarësimin në BE?**

Njerëzit në Europë kurrë nuk kanë përjetuar një luftë. Ata besojnë se lufta është një film bardh e zi në TV. Por ne e kemi përjetuar atë. Ne kishim marrë 500 000 refugjatë në një vend me 2.5 milionë banorë. Ne e dimë se çfarë është lufta, prandaj Europa është kaq e rëndësishme për ne. Europa është feja jonë. Tashmë gjatë Perandorisë Osmane kemi pasur një thënie: Dielli ynë ngrihet në perëndim.

**A është përpjekja e BE për t'u bashkuar me gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor për të shmangur ndikimin e Rusisë?**

Kjo nuk duhet të jetë një dilemë mes më shumë reformave apo më shumë havjar. Kjo nuk ka rëndësi, ata mund të na ofrojnë aq shumë havjarë sa duan. Gjatë pesëdhjetë viteve të komunizmit na u tha: "Qielli është i kuq, jeta do të jetë e mrekullueshme". Progresi është i madh, por ende kemi shumë për të bërë. Tani kemi qiellin blu, na thuhet: "Jeta do të jetë e mrekullueshme, përparimi është bërë, por ende ka shumë për të bërë". Ne e dimë këtë, por procesi duhet të jetë i drejtë. Ne jemi duke qëndruar jashtë derës dhe duke trokitur për vite për të hyrë.


bashkëpunimi gjerman DEUTSCHE ZUSAMMENARBEIT

Implemented by giz

**OPEN CALL FOR TENDER**

**PREQUALIFICATION**

1. **GENERAL CONDITIONS**

1.1. **Requester:** Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit GmbH (GIZ), Office Tirana, Rr. Skenderbej, No. 21/1.
1.2. **Profile:** German Development Cooperation, Office in Tirana supports Albania on its path to European integration and development through projects implemented in : Economic development, Economic legal reform, Vocational education and training, Reform of the water sector, Rural development, and some other areas.
1.3 **Subject:** The GIZ Office Tirana invites qualified design companies to "Provide Design Stabilisation (Composting) Plant at Vumblo Transfer Station, Himara Municipality.

2. **Companies should fulfill the following requirements:**

2.1 The Companies have to be licensed as an engineering designer.
2.2 The Companies have to be experienced in the designing of the common design works.
2.3 The Companies have to fulfill the complete design and cost estimated for the future civil works of construction.

All legal entities interested in application process should ask for an application form to the address: giz-albanien@giz.de

3. The **due date** for submitting the application is **25 May 2018**. The documents should be submitted in a sealed envelope, marked "Application for prequalification of Design Stabilisation (Composting) Plant at Vumblo Transfer Station, Himara Municipality", addressed to:

**German Development Cooperation Office (GIZ), Office in Tirana,**
**Rr. Skenderbeg, No. 21/1**
**Tirane**

After the due date for submitting the application, the process of prequalification will follow. The submitted applications will be evaluated, and only prequalified candidates will be invited to answer to the bid.



EPSA enforcement private service

**SHOQËRIA PËRMBARUESE PRIVATE "E.P.S.A"**
**SHPK NJOFTON SHPALLJEN E ANKANDIT PER:**

1. **Are** me nr.33/26, e ndodhur ne Karpen, Kavajë, rregjistruar në ZVRPP Kavajë, Zk.2099,vol.11, fq.202, me sip.2,000 m2, cmimi që do të shitet është **3.548.664** lekë.
2. **Are** dhe truall me **nr.1/88**, e ndodhur ne Qerret, Kavaje, rregjistruar në ZVRPP Kavajë, Zk.3101, vol.9, fq.34, me sip.1,770 m2 cmimi që do të shitet është **8.793.590** lekë.
3. **Are** me nr.33/27, e ndodhur ne Karpen. Kavajë, rregjistruar në ZVRPP Kavajë, Zk.2099, vol.1, fq.203, me sip.4,050 m2 cmimi që do të shitet është **7.186.045** lekë.
4. **Are** me nr.70/9, e ndodhur ne Qerret, Kavajë, rregjistruar në ZVRPP Kavajë, Zk.3101, vol.2, fq.106, me sip.6,460 m2 cmimi që do të shitet është **4.584.875** lekë.
5. **Njësi** me nr.15/22+1-N1 e ndodhur ne Kavajë, rregjistruar në ZVRPP Kavajë, Zk.8551, nr.rregjistri hipotekor 14/69, vl.2011, datë 03.03.2011 me sip.116 m2 vlerësohet me vlerën e **9.056.191** lekë.
6. **Njësi** me nr.15/22+1-N2 e ndodhur ne Kavajë, rregjistruar në ZVRPP Kavajë, Zk.8551, nr.rregjistri hipotekor 14/70, vl.2011, datë 03.03.2011 me sip.91 m2 vlerësohet me vlerën e **7.104.426** lekë.
7. **Njësi** me nr.15/22+1-N3 e ndodhur ne Kavajë, rregjistruar në ZVRPP Kavajë, Zk.8551,nr.rregjistri hipotekor 15/71, vl.2011, datë 03.03.2011 me sip.95 m2 vlerësohet me vlerën e **7.416.708** lekë.
8. **Njësi** me nr.15/22+1-N4 e ndodhur ne Kavajë, rregjistruar në ZVRPP Kavajë, Zk.8551,nr.rregjistri hipotekor 15/72, vl.2011, datë 03.03.2011 me sip.211 m2 vlerësohet me vlerën e **16.472.899** lekë.
9. **Bodrum** me nr.15/22+1-B e ndodhur ne Kavajë, rregjistruar në ZVRPP Kavajë, Zk.8551, nr.rregjistri hipotekor 130/176, vl.2005-2007, datë 24.09.2007 me sip.609 m2 vlerësohet me vlerën e **13.261.358** lekë.Te gjitha pasurite e sipërcituara jane hipotekuar në favor te **Banka Raiffeisen sha.** Prsh Casa Nostra.

Ankandi zhvillohet ne **datë 11.06.2018 ora 16.00** në adresen Rr."I. Qemali", Pall."Fratari", K.6,Tirane. Per cdo informacion kontaktoni ne tel. 04 2262711 ose ne www.epsa.al

# AKU i sekuestron tregtarit elbasanas 10 tonë mish, dyshohet të jetë i kontaminuar


Foto ilustruese

**ELBASAN** - Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, në vijim të masave për disiplinimin e therjeve dhe të tregtimit të mishit në funksion të sigurisë ushqimore ka sekuestruar rreth 10 tonë mish në Elbasan, i cili dyshohet se është i kontaminuar. Mësohet se sasia e madhe e mishit është sekuestruar në lagjen "5 Maji" në Elbasan, në subjektin e shtetasit Elibert Latifi, 42 vjeç. "Nga kontrolli i ushtruar nga policia në bashkëpunim me AKU-në, në lagjen '5 Maji', në subjektin fizik të këtij shtetasi, i cili tregton e përpunon produkte mishi, ka rezultuar se ky subjekt tregtonte e përpunonte produkte mishi i papajisur me licencë nga Q.K.L, si dhe pa etiketë produkti. Në këtë subjekt u bllokuan nga specialistët e AKU-së 978 kg mish derri, 3840 kg kofshë pule, 3920 kg fileto pule, 37 kg mish viçi, 111 kg qofte dhe 645 kg gjiro gici, produkt i gatshëm për analiza të mëtejshme, pasi dyshohen si të kontaminuara", thuhet në njoftimin zyrtar të policisë. Sipas bluve, Latifi akuzohet për "Prodhim i kundraligjshëm i artikujve dhe mallrave industrialë dhe ushqimorë". Ndërkaq, AKU zyrtarisht deklaroi që aksioni ka disa ditë që është kryer dhe mishi nuk është i kontaminuar. Por, duke qenë se subjekti ka qenë i palicencuar, ata e kanë çuar në Durrës për analiza të mëtejshme. Gjithashtu, mësohet se sasia e madhe e mishit ka qenë e blerë nga një subjekt i licencuar.

### Hetimet nisën në 2016-ën, në rrjet e përfshirë edhe policja Entela Çala

# Trafiku, si kalonin emigrantët me dokumente false në SHBA e Britani

## *"Daily Mail": Grupi i strukturuar kriminal ka prodhuar më shumë se 1.000 dokumente të rreme*

Zbulimi i laboratorit në Tiranë, që falsifikonte pasaporta dhe dokumente si dhe shkatërrimi i rrjetit që operonte në këtë veprimtari kriminale ka marrë vëmendjen e mediave britanike. "Daily Mail" në një artikull të zgjeruar është ndalur tek rrjeti që ishte krijuar dhe operonte prej vitesh dhe që dërgonte emigrantë në vendet e BE-së dhe SHBA-ve me pasaporta dhe dokumente të falsifikuara kundrejt pagesës.

Sipas "Daily Mail", hetuesit besojnë se grupi i strukturuar ka prodhuar më shumë se 1,000 dokumente të rreme, nga të cilat deri në 800 mendohet të jenë përdorur. Rrjeti i kalimit të klandestinëve ishte i përbërë nga 17 anëtarë, duke përfshirë dy oficerë policie dhe ofronin dokumente false kundrejt shumës prej rreth 20,000 paund. Veprimtaria kriminale mendohet se ka vazhduar me vite të tëra, duke përdorur një biznes të printimit që prodhon fletushka promovuese në qendër të kryeqytetit shqiptar. Trafikantët prodhuan një sërë pasaportash të rreme franceze, italiane, hungareze, greke dhe rumune, letërnjoftime dhe patentë shoferi. Ata ishin të specializuar në pasaportat bullgare, të cilat sigurojnë hyrjen në Britaninë e Madhe si pjesë e BE-së dhe për këtë arsye për autoritetet britanike ishte e vështirë dallimi mes atyre që flasin gjuhën shqipe dhe bullgare.

**BANDA KRIMINALE**

Një burim i policisë shqiptare tha se dokumentet e rreme që ata krijonin ishin "gati 100 për qind të përsosura". Kompania e shtypit kishte edhe një faqe në internet, në gjuhën shqipe dhe angleze, ku ajo mburrej me punimet e saj. Emigrantët e paligjshëm dërgoheshin fillimisht në vende si: Francë, Gjermani, Itali, Norvegji ose Greqi, para se të fluturonin në Britani të Madhe, SHBA ose Kanada duke përdorur dokumentet e tyre të rreme për të fituar hyrjen. Të tjerë udhëtuan me rrugë tokësore në Francë, ku u takuan me një tjetër qelizë kontrabandë të njerëzve, siguroheshin që klandestinët të merrnin autobusë, makina, trena ose kamionë. Trafikantët u siguronin klandestinëve një histori dhe i ndihmonin ata si t'u përgjigjeshin çdo pyetjeje nga rojet kufitare. Banda, gjithashtu i këshillonte emigrantët të udhëtonin në kohën më të ngarkuar, kur kishte radhë të gjata në pikat kufitare dhe rojet kishin më pak kohë për të kontrolluar dokumentet.



Grupi kriminal



Dokumentet e sekuestruara

**HETIMI**

Zyrtarët filluan hetimin e rrjetit kriminal në vitin 2016, pas kapjes së një grupi emigrantësh që kishin paguar shuma të mëdha për të udhëtuar në Britani të Madhe në aeroportin e Tiranës. Ismail Alushani ishte një nga anëtarët e dyshuar të bandës të arrestuar. Ndërkohë efektivja e policisë Entela Çala, 43 vjeçe, ishte një nga dy oficerët e policisë të dyshuar për marrjen e parave nga rrjeti kriminal. Ky është suksesi i dytë brenda këtij viti, për policinë shqiptare kundër trafikut të paligjshëm të emigrantëve. Në mars, policia shqiptare shkatërroi një rrjet që kishte bërë miliona duke kontrabanduar 750 shqiptarë në Britani pas një operacioni ndërkombëtar.

### NGJARJA



## Dy turistë bien nga lartësia te "Shpella e Pëllumbasit", njërin e mori rrjedha

**TIRANË** - Një ngjarje e rëndë ka ndodhur mesditën e djeshme në vendin e njohur "Shpella e Pëllumbasit" në Tiranë, ku dy turistë kanë rënë nga lartësia. Bëhet fjalë për Xhorxho Seferin dhe Fabio Dukagjinin, të dy të moshës 21 vjeç. Sipas bluve, Dukagjini kishte mbetur në një grykë kanioni, por pas ndërhyrjes së zjarrfikësve dhe policisë është bërë e mundur nxjerrja e tij. Ai ka pësuar dëmtime të lehta dhe është dërguar në spital për të marrë ndihmën e nevojshme shëndetësore. Ndërkohë, blutë kanë vijuar kërkimet për gjetjen e Seferit, i cili dyshohet të jetë marrë nga rrjedha e lumit.

### Fitimet i investonin në blerje banesash dhe makinash

# Vidhnin veshje firmato nga qendrat tregtare, arrestohen katër femra shqiptare dhe një burrë

**GREQI** - Policia greke ka arrestuar 5 shqiptarë (4 gra dhe 1 burrë), të akuzuar për vjedhje në qendra tregtare dhe supermarkete. Dosja penale përfshin dhe 7 persona të tjerë që po kërkohen. Sipas komunikatës së policisë, bëhet fjalë për një grup kriminal të organizuar, aktiviteti i të cilit daton që nga viti 2016. Grupi vepronte me metoda të sofistikuara për të evituar kontrollet e sigurisë. Ata përdornin aparate për çaktivizimin e mekanizmave kundër vjedhjes. Sendet e vjedhura, veshje dhe këpucë firmato vendoseshin në çanta të posaçme, që i kishin faqet e brendshme të veshura me alumin që mos të diktoheshin nga skaneri i alarmit në dalje të njësive. Nga supermerketet vidhnin kryesisht pije dhe ushqime. Policia ra në gjurmë



të grupit pas hetimeve disamujore që filluan me arrestimin në flagrancë të dy shtetasve shqiptarë, nëntor-in e kaluar. Grupi i dërgonte veshmbathjet e vjedhura në Shqipëri, ku shiteshin me kile. Ndërsa pijet dhe ushqimet i merrte burri shqiptar i arrestuar, i cili kishte një dyqan ushqimor në Galaci të Athinës. Nga kontrollet në banesat e femrave të arrestuara si dhe në dyqanin e 42-vjeçarit u gjetën dhe u sekuestruan më shumë se 4.000 artikuj veshmbathjeje, si dhe më shumë se 1.000 pajisje shtëpiake dhe produkte që shiten në supermerkate. Policia ka sekuestruar gjithashtu në cilësinë e provës një numër të madh shënimesh mbi artikujt e vjedhur, shuma parash si dhe karta bankare. Policia thotë se fitimet e mëdha që nxirrnin nga biznesi i paligjshëm, ata i investonin në blerje banesash dhe makinash të shtrenjta.

SHÇBA sekuestron kamerat e sigurisë, identifikohen policët që dhunuan të riun

# U gjet i vdekur në paraburgim, bashkëshortja e 27-vjeçarit: Kishte shenja gjilpërash në trup

## *Entela Ftoj: Kam denoncuar shefin e dhomave të sigurisë dhe 2 efektivë. Më vranë jo vetëm burrin, por edhe mua e fëmijët*

**KORÇË**

Tri ditë pas ngjarjes së rëndë të ndodhur në qelitë e paraburgimit të Komisariatit të Korçës, ku u gjet i pajetë 27-vjeçari Enea Ftoj, bashkëshortja e tij ka kallëzuar penalisht tre policë, të cilët sipas saj kanë dhunuar deri në vdekje të shoqin. Nëna e tre fëmijëve deklaroi për "News 24" dhe "Gazeta Shqiptare" se përveç shenjave të dhunës, në trupin e të shoqit kishte edhe shenja gjilpërash. Ndonëse prokuroria ka nisur hetimet për ngjarjen në fjalë, ende nuk është asnjë masë administrative ndaj tre efektivëve. Në shtëpinë e marrë me qira, familjarët e Enea Ftojt presin ngushëllime sipas traditës. 27-vjeçari u përcoll me protestë pasditen e së premtes për në banesën e fundit, duke lënë në mjerim bashkëshorten dhe tri vajza të mitura, 6, 5 dhe 1 vjeçe. E papunë dhe pa profesion, bashkëshortja 21-vjeçare e Ftojt, Entela, tha dje se asistenca prej 2.500 lekë të reja nuk mjafton as për qiranë e apartamentit. Ndërkaq, mësohet se policia ka identifikuar efektivët që hynë në qelinë ku mbahej Enea Ftoj në komisariatin e Korçës. Shërbimi i Çështjeve të Brendshme dhe Ankesave (SHÇBA) që po heton vdekjen e të arrestuarit ka marrë kamerat e sigurisë që ndodhen vetëm në korridoret e komisariatit. Aty duken policët që kanë hyrë e kanë dalë nga qelia, ndërsa në dhomën e izolimit nuk ka kamera sigurie. Emrat e policëve të dyshuar për ushtrim dhune nuk bëhen me dije. Enea Ftoj ishte arrestuar për akuzën e vjedhjes me dhunë dhe sipas informacioneve ishte edhe përdorues i lëndëve narkotike. 27-vjeçari i kishte rrëmbyer varësen një gruaje në rrugë dhe policia e kishte kapur dhe mbyllur në qeli. Ai pritej të dilte para gjykatës, por familjarët atje mësuan se Enea kishte vdekur. Nga verifikimet e para, sipas burimeve, SHÇBA ka identifikuar të gjithë punonjësit e policisë, të cilët kanë qenë në detyrë ditën e mërkurë. Për rastin e rëndë SHÇBA ka bërë referimet përkatëse edhe në prokurori, ndërkohë që i është marrë kallëzim edhe bashkëshortes së të ndjerit.

**DËSHMIA E GRUAS SË VIKTIMËS**

"Jemi pa shtëpi, pa katandi. Ku të mbytem me tre fëmijët, ku të vete. A kam unë ta paguaj këtë qira? Nuk ia morën jetën vetëm atij. Më vranë edhe fëmijët, edhe mua", u shpreh Entela Foi. Në Drejtorinë e Policisë së Korçës, bashkëshortja e Eneas ka bërë kallëzim për tre efektivë, të cilët i konsideron përgjegjës për dhunën dhe keqtrajtimin e 27-vjeçarit gjatë tri ditëve të qëndrimit në komisariat. "Për Alqin, Kreshnikun dhe Gurin, që ai i bënte gjilpërat. Guri është shefi i dhomave të sigurisë atje. Dy të tjerët janë policë dhe më kanë rrahur burrin ditën që e arrestuan në pazarin e Korçës. Ai përveç shenjave të të rrahurës, kishte edhe tri shenja gjilpërash". Prokuroria e Korçës thotë se po vijon hetimet për rastin dhe është në pritje të përgjigjeve të ekspertizës mjeko-ligjore dhe ekspertimit të pamjeve të kamerave të sekuestruara në komisariat. Edhe pse rastet e dhunës në komisariatin e Korçës janë të përsëritura, ndaj efektivëve përgjegjës për episodet e dhunës ndaj të shoqëruarve nuk është marrë asnjë masë administrative nga Drejtoria e Policisë.



27-vjeçari Enea Ftoj



Entela Ftoj duke folur për "GSH"

**PROTESTA**

Enea Ftoj, i cili mëngjesin e së enjtes u gjet i vdekur në dhomat e paraburgimit në komisariatin e Korçës, të premten u përcoll për në banesën e fundit. Para varrimit, familjarë, të afërm dhe pjesëtarë të komunitetit rom në këtë qytet protestuan përpara komisariatit me arkivolin e tij në krahë, duke akuzuar policinë si shkaktare. Me pankarta në duar ku shkruhej: "Larg policisë raciste", "Duam drejtësi", ata bënë thirrje që përgjegjësit e vdekjes së babait të tre fëmijëve të përballen me ligjin.

---

**Hetimi, sekuestro preventive godinës bar-kafe "TATA"**

# Prostitucion dhe pastrim prash, çohen për gjykim Rinard Tata dhe 10 persona të tjerë

**SHKODËR** - Prokuroria e Shkodrës ka dërguar për gjykim grupin e kryesuar nga Rinard Tata (i njohur ndryshe si "Dan Bilzerani" i Shkodrës) dhe 10 persona të tjerë, që janë pjesë e këtij grupi kriminal, pasi akuzohen për prostitucion dhe pastrim parash. Pas përfundimit të hetimeve paraprake të procedimit penal nr.1623, të vitit 2014, prokuroria ka ngritur akuzë dhe ka dërguar në gjykatën e qytetit verior 11 të pandehur, të cilët prej shumë vitesh kishin rekrutuar disa vajza dhe i shfrytëzonin për prostitucion në disa lokale dhe hotele në qytetin e Shkodrës, e më pas paratë e përftuara nga kjo veprimtari kriminale i riciklonin në aktivitetet tregtar dhe ndërtimtari. Po ashtu, në funksion të këtij hetimi është vendosur sekuestro preventive mbi godinën bar-kafe "TATA", që ndodhet në lagjen "Manush Alimani" të këtij qyteti, në pronësi të të pandehurit Rinard Tata.

**PERSONAT E PANDEHUR**

**1.** I pandehuri Rinard Tata (alias Federik Tota), lindur dhe banues në Shkodër, i arrestuar, i dënuar edhe më parë, i cili akuzohet se ka kryer veprat penale të:
**1.** "Shfrytëzim i prostitucionit" në dëm të disa femrave.
**2.** "Mbajtja e lokaleve për prostitucion".
**3.** "Ushtrimi pa licencë i veprimtarive financiare".
**4.** "Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale", duke ricikluar në aktivitetin e tij privat dhe ndërtimtari paratë e përfituara nga shfrytëzimi i prostitucionit.
**5.** "Vjedhja e energjisë elektrike ose impulseve telefonike" për qëllime biznesi.
**6.** "Ndërtimi i paligjshëm", pasi ka ndërtuar 3 kate mbi pronën e tij ekzistuese.
**2.** E pandehura Sunila Mehja, lindur dhe banuese në Shkodër, e arrestuar, e cila akuzohet se ka kryer veprat penale:
**1.** "Shfrytëzimit të prostitucionit" në dëm të disa femrave.
**2.** "Mbajtja e lokaleve për prostitucion".
**3.** I pandehuri Kastriot Musa, lindur në Barbullush, Shkodër, i arrestuar, i cili akuzohet se ka kryer veprën penale të:
"Shfrytëzimit të prostitucionit" në dëm të disa femrave.
**4.** E pandehura Ardita Muça, lindur e banues në Shkodër, e arrestuar, e cila akuzohet se ka kryer veprën penale të "Prostitucionit".
**5.** E pandehura Angje Ndrecaj, lindur dhe banuese në Manati, Lezhë, e arrestuar, e cila akuzohet se ka kryer veprën penale të "Prostitucionit".
**6.** E pandehura Anita Lleshi, lindur në Burrel dhe banuese në Kamëz, e arrestuar, e cila akuzohet se ka kryer veprën penale të "Prostitucionit".
**7.** E pandehura Albana Musa, lindur në Korçë dhe banuese në Bushat, Vau Dejës, e arrestuar, e cila akuzohet se ka kryer veprën penale të "Prostitucionit".
**8.** E pandehura V.H., e hetuar në gjendje të lirë, e cila akuzohet se ka kryer veprën penale të "Prostitucionit".
**9.** I pandehuri E.L., i hetuar në gjendje të lirë, i cili akuzohet se ka kryer veprën penale të "Prostitucionit".
**10.** I pandehuri E.C., i hetuar në gjendje të lirë, i cili akuzohet se ka kryer veprën penale të "Prostitucionit".
**11.** I pandehuri M.P., i hetuar në gjendje të lirë, i cili akuzohet se ka kryer veprën penale të "Prostitucionit".

Akordohet fondi, përfitojnë ish-të përndjekurit e kategorisë parësore

Ornela Manjani

# Ministria e Financave: 263 milionë lekë për ish-të dënuarit politikë

## *Lista me përfituesit në të gjithë vendin*

Ministria e Financave akordon një fond prej 260 milionë lekësh për pagesën e dëmshpërblimit të ish-të burgosurve politikë. Përfituesit janë 142 ish-të dënuar të kategorisë parësore dhe pagesat e dëmshpërblimit janë miratuar me një vendim të posaçëm e Këshillit të Ministrit. Qeveria urdhëron Ministrinë e Financave që shuma e llogaritur të transferohet në një llogari speciale në Bankën e Shqipërisë. Pagesa e dëmshpërblimit për secilin përfitues të bëhet nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë në llogaritë personale të tyre, të hapura në bankat e nivelit të dytë, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 9831, datë 12.11.2017, "Për dëmshpërblimin e ish-të dënuarve politikë të regjimit komunist", të ndryshuar.

**KATEGORIA PARËSORE**

Janë gjashtë kategori prioritare dhe janë përcaktuar dokumentet që duhen plotësuar për çdo kategori përfituese. Të parat në listë janë gratë e ish-të dënuara që jetojnë në momentin e pagesës. Sipas urdhrit të Ministrisë së Financave, në kategorinë e dytë me prioritet janë personat ish-të dënuar mbi 75 vjeç në datën e hyrjes në fuqi të ligjit që vazhdojnë të jenë gjallë. Ndërsa në kategorinë e tretë me prioritet janë persona ish-të dënuar politikë të gjallë që vuajnë nga sëmundje të rënda. Për kategorinë e katërt me prioritet kanë personat ish-të dënuar që janë gjallë, të cilët pavarësisht moshës, në momentin e pagesës kanë fëmijë të mitur nën moshën 18 vjeç. Ndërsa për kategorinë e pestë prioritet kanë personat ish-të dënuar që nuk jetojnë, por në momentin e pagesës kanë trashëgimtarë të radhës së parë në moshë të mitur nën 18 vjeç. Në kategorinë e gjashtë prioritet kanë persona ish-të dënuar që janë gjallë dhe në momentin e pagesës nuk kanë mbushur 75 vjeç, të cilët duhet të dorëzojnë certifikatë personale jo më e vjetër se një javë nga data e dorëzimit dhe numër llogarie.



Foto ilustruese

## Lista e ish-të dënuarve politikë që marrin fondin 263 milionë lekë

| Emër | Mbiemër | Vendlindja | Shuma e dëmshpërblimit në lekë | Përfitimet nga ligje të mëparshme | | Dëmshpërblim i përfundimtar |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | Lekë | Letra me Vlerë | |
| Faslli | Guni | Tiranë | 1,072,000 | 200,000 | 720,000 | 152,000 |
| Shkelqi | Kapllani | Skrapar | 6,084,000 | 100,000 | 1,197,600 | 3,280,722 |
| Seit | Labi | Konispol, | 1,312,000 | 200,000 | 720,000 | 392,000 |
| Ronalt | Papa | Tiranë | 3,208,000 | 441,205 | 441,205 | 2,325,590 |
| Fatmir | Selmanaj | Vlorë | 112,000 | 0 | 103,355 | 8,645 |
| Nexhat | Gjeçi | Lekaj, Durrës | 10,360,000 | 200,000 | 1,600,000 | 8,560,000 |
| Vasil | Nikdhima | Piqeras, Sarandë | 2,352,000 | 0 | 1,897,073 | 454,927 |
| Osman | Çyrçiali | Tiranë | 5,014,000 | 0 | 822,575 | 4,191,425 |
| Agim | Kongjonaj | Tiranë | 1,278,000 | 0 | 120,000 | 1,158,000 |
| Selim | Gepeli | Durrës | 3,466,000 | 0 | 530,000 | 2,936,000 |
| Ylli | Nino | Tiranë | 2,516,000 | 0 | 413,260 | 0 |
| Pëllum | Zotaj | Tiranë | 3,608,000 | 0 | 0 | 2,715,000 |
| Paulin | Malaj | Ivanaj, Shkodër | 506,000 | 0 | 0 | 506,000 |
| Paulin | Ndoja | Stajkë, Shkodër | 1,198,000 | 0 | 0 | 1,198,000 |
| Skënde | Fejzulla | Fier | 550,000 | 0 | 0 | 550,000 |
| Muhare | Qerimi | Tiranë | 1,218,000 | 200,000 | 720,000 | 298,000 |
| David | Lumaj | Dedaj, Shkodër | 490,000 | 0 | 0 | 490,000 |
| Avdi | Bajra | Gjuricaj, | 2,942,000 | 83,507 | 1,200,000 | 1,658,493 |
| Ahmet | Suçi | Macukull, Mat | 960,000 | 200,000 | 478,301 | 281,699 |
| Ermira | Kullau | Tiranë | 1,014,000 | 0 | 0 | 1,014,000 |
| Stavro | Lito | Finiq, Sarandë | 10,520,000 | 0 | 1,727,644 | 8,792,356 |
| Gëzim | Mulletja | Tiranë | 3,650,000 | 0 | 597,041 | 3,052,959 |
| Fatmir | Shemshiri | Tiranë | 270,000 | 0 | 0 | 270,000 |
| Hamëz | Milushi | Markaj, Tropojë | 644,000 | 0 | 0 | 644,000 |
| Amlet | Kyçyku | Korçë | 568,000 | 0 | 170,000 | 398,000 |
| Mark | Pjetri | Lezhë | 1,132,000 | 0 | 260,000 | 872,000 |
| Agron | Luke | Libohovë | 3,428,000 | 0 | 1,125,699 | 2,302,301 |
| Agim | Rrubiega | Kavajë | 3,056,000 | 0 | 500,000 | 2,556,000 |
| Hamza | Ademi | Reres, Fier | 558,000 | 0 | 0 | 558,000 |
| Islam | Kora | Tiranë | 1,384,000 | 0 | 224,548 | 1,159,452 |
| Fatlli | Varvarica | Tiranë | 1,308,000 | 0 | 213,370 | 1,094,630 |
| Faik | Suli | Kastriot, Dibër | 3,192,000 | 0 | 500,000 | 2,692,000 |
| Nino | Lila | Kurjan, Fier | 2,662,000 | 0 | 436,932 | 2,225,068 |
| Venem | Ranxha | Elbasan | 5,266,000 | 0 | 1,200,000 | 4,066,000 |
| Osman | Mema | Helmas, Durrës | 1,136,000 | 0 | 200,000 | 936,000 |
| Sokol | Hykaj | Papaj, Tropojë | 364,000 | 200,000 | 720,000 | 0 |
| Kurt | Muslika | Tregtan, Kukës | 4,250,000 | 0 | 1,070,000 | 3,180,000 |
| Juljan | Berisha | Elbasan | 484,000 | 0 | 150,000 | 334,000 |
| Besim | Tirana | Durrës | 812,000 | 0 | 1,200,000 | 0 |
| Besnik | Likmeta | Likmetaj, | 568,000 | 200,000 | 720,000 | 0 |
| Xhevdet | Kreka | Tiranë | 500,000 | 0 | 0 | 500,000 |
| Aleksand | Vllasha | Lekaj, Shkodër | 5,358,000 | 0 | 800,000 | 4,558,000 |
| Gëzim | Kuca | Tiranë | 3,012,000 | 0 | 700,000 | 2,312,000 |
| Bore | Demaj | Iballe, Pukë | 882,000 | 0 | 0 | 882,000 |
| Qamil | Rexhaj | Golaj, Kukës | 2,440,000 | 0 | 700,000 | 1,740,000 |
| Thodhor | Fili | Mursi, Sarandë | 5,568,000 | 100,000 | 813,658 | 4,654,342 |
| Ardjan | Imeraj | Vlorë | 548,000 | 0 | 0 | 548,000 |
| Gani | Mani | Shkodër | 2,376,000 | 0 | 0 | 2,376,000 |
| Fazli | Deliu | Çabër, Kosovë | 10,010,000 | 0 | 0 | 10,010,000 |
| Fatmir | Grifsha | Çerkeze, Tiranë | 1,370,000 | 0 | 289,315 | 1,080,685 |
| Edmond | Proko | Fier | 2,104,000 | 0 | 344,548 | 1,759,452 |
| Leonidha | Llupi | Fier | 2,520,000 | 0 | 850,000 | 1,670,000 |
| Sulejman | Alija | Lubishtë | 5,696,000 | 0 | 0 | 5,696,000 |
| Liman | Krasniqi | Terpezë, | 2,120,000 | 50,000 | 346,521 | 1,723,479 |
| Xhevair | Toska | Orizaj, Berat | 8,384,000 | 0 | 1,378,192 | 7,005,808 |
| Sabostjan | Vuksani | Shkodër | 178,000 | 0 | 0 | 178,000 |
| Kushtrim | Lame | Ramice, Vlorë | 460,000 | 0 | 74,301 | 385,699 |
| Vladimir | Furtuna | Korçë | 442,000 | 0 | 400,000 | 42,000 |
| Elsa | Matja | Tiranë | 2,224,000 | 0 | 0 | 2,224,000 |
| Fatmir | Arapi | Vlorë | 5,996,000 | 0 | 984,001 | 5,011,999 |
| Xhelal | Çami | Tiranë | 3,320,000 | 0 | 545,425 | 2,774,575 |
| Vasil | Koça | Tiranë | 1,432,000 | 0 | 0 | 1,432,000 |
| Stefan | Goga | Kakavie, | 2,868,000 | 0 | 468,869 | 2,399,131 |
| Tahir | Belegu | Tiranë | 4,028,000 | 0 | 1,000,000 | 3,028,000 |
| Sabrie | Selimaj | Valbonë, | 974,000 | 159,781 | 25,000 | 789,219 |
| Ardian | Boka | Lekaj, Shkodër | 1,482,000 | 0 | 240,000 | 1,242,000 |
| Paulin | Noshi | Shkodër | 408,000 | 0 | 0 | 408,000 |
| Albert | Gega | Lushnje | 1,184,000 | 0 | 180,000 | 1,004,000 |
| Selman | Bezati | Tiranë | 5,030,000 | 0 | 823,555 | 4,206,445 |
| Aleks | Bala | Vlorë | 1,598,000 | 0 | 262,356 | 1,335,644 |
| Nikolla | Çjarra | Miriqi, | 5,110,000 | 0 | 600,329 | 4,509,671 |
| Besnik | Erebara | Tiranë | 1,022,000 | 0 | 685,465 | 336,535 |
| Ibish | Kelmendi | Pejë, Kosovë | 4,330,000 | 0 | 1,200,000 | 1,873,342 |
| Kadri | Llodos | Ninat, Sarandë | 1,156,000 | 0 | 0 | 1,156,000 |
| Sadri | Kazmaj | Grizhë, | 1,564,000 | 0 | 215,000 | 1,349,000 |
| Hilmi | Isufaj | Linaj, Shkodër | 222,000 | 0 | 200,000 | 22,000 |
| Nadir | Isufi | Shkodër | 836,000 | 0 | 136,822 | 699,178 |
| Pjetrus | Ndoci | Prekal, Shkodër | 562,000 | 0 | 0 | 562,000 |
| Bujar | Tafa | Tiranë | 1,166,000 | 0 | 391,890 | 774,110 |
| Ejll | Malaj | Ivanaj, Shkodër | 490,000 | 0 | 0 | 490,000 |
| Lefter | Roshi | Vagalat, Sarandë | 3,472,000 | 0 | 619,726 | 2,852,274 |
| Zyhdi | Shehu | Tiranë | 1,828,000 | 200,000 | 1,403,397 | 224,603 |
| Besim | Valteri | Vinjoll, Mat | 2,744,000 | 0 | 450,082 | 1,060,967 |
| Lulash | Thana | Plan, Shkodër | 1,174,000 | 0 | 191,616 | 982,384 |
| Hysen | Duda | Tiranë | 1,250,000 | 0 | 0 | 1,250,000 |
| Yllson | Ylli | Korçë | 272,000 | 0 | 0 | 258,886 |
| Andon | Popovsk | Vlorë | 2,582,000 | 0 | 0 | 2,582,000 |
| Shkëlze | Vellku | Bruz Madh, | 1,596,000 | 0 | 240,000 | 1,356,000 |
| Gazme | Kullau | Kuçovë | 234,000 | 0 | 40,000 | 194,000 |
| Rexhep | Demiri | Sarandë | 2,250,000 | 0 | 472,150 | 1,777,850 |
| Qemal | Murati | Derje, Tiranë | 5,596,000 | 0 | 1,054,027 | 4,541,973 |
| Gligora | Vardhami | Tiranë | 2,092,000 | 0 | 335,671 | 1,756,329 |
| Mirot | Pllumba | Hot, Shkodër | 1,174,000 | 0 | 0 | 1,174,000 |
| Silvana | Çuni | Letaj, Kukës | 4,512,000 | 200,000 | 542,027 | 3,769,973 |
| Gjergj | Hani | Durrës | 2,808,000 | 0 | 300,000 | 2,508,000 |
| Bardhu | Haraçiu | Sohodoll, | 2,654,000 | 0 | 462,247 | 2,191,753 |
| Namik | Ajazi | Tiranë | 2,454,000 | 0 | 469,151 | 1,984,849 |
| Fatmir | Kurti | Tiranë | 1,346,000 | 0 | 287,014 | 1,058,986 |
| Lefter | Sotiri | Tiranë | 2,748,000 | 0 | 2,161,315 | 586,685 |
| Jani | Marolli | Dardhë, | 416,000 | 0 | 0 | 416,000 |
| Petrit | Ishmi | Tiranë | 1,474,000 | 0 | 220,603 | 1,253,397 |
| Ndue | Gjelosh | Gurëz, Krujë | 3,424,000 | 0 | 561,068 | 2,862,932 |
| Skënde | Poka | Gjur Reç, | 860,000 | 0 | 321,534 | 538,466 |
| Myfit | Velani | Shkodër | 1,760,000 | 0 | 0 | 1,760,000 |
| Josif | Shkurti | Durrës | 528,000 | 0 | 200,000 | 328,000 |
| Jorgji | Mitro | Tiranë | 3,368,000 | 0 | 0 | 3,368,000 |
| Kadri | Shemshiri | Tiranë | 112,000 | 0 | 0 | 112,000 |
| Igli | Shenaj | Rreshen | 2,622,000 | 0 | 0 | 2,622,000 |
| Dhimit | Berberi | Nartë, Vlorë | 1,386,000 | 0 | 0 | 1,386,000 |
| Zeqo | Braho | Tiranë | 172,000 | 0 | 0 | 172,000 |
| Artan | Millaj | Stajkë, Shkodër | 306,000 | 0 | 0 | 306,000 |
| Tonin | Ndoci | Tiranë | 930,000 | 100,000 | 52,219 | 777,781 |
| Safer | Ymeri | Korçë | 174,000 | 0 | 18,411 | 155,589 |
| Muhare | Shehu | Korçë | 174,000 | 0 | 0 | 0 |
| Vladim | Shehu | Sulmi, Tiranë | 8,060,000 | 0 | 1,205,589 | 6,854,411 |
| Floben | Hasa | Elbasan | 1,794,000 | 0 | 0 | 1,794,000 |
| Mirash | Toma | Velipojë, | 1,492,000 | 0 | 0 | 1,492,000 |
| Edmon | Hoxha | Durrës | 2,358,000 | 0 | 600,000 | 1,758,000 |
| | | | | | | 263,686,873 |
| Sabri | Domi | Durrës | 1,386,000 | 0 | 250,000 | 1,136,000 |
| Zef | Doçi | Pukë | 428,000 | 0 | 0 | 428,000 |
| Pashko | Grishaj | Vukel, Shkodër | 1,714,000 | 0 | 330,000 | 1,384,000 |
| Antoni | Vezi | Durrës | 2,714,000 | 13,000 | 500,134 | 2,200,866 |
| Vasiar | Tabaku | Elbasan | 3,410,000 | 0 | 1,000,000 | 2,410,000 |
| Bashkim | Gjini | Lazarat, | 520,000 | 0 | 0 | 520,000 |
| Petrit | Shpuza | Shkodër | 1,958,000 | 0 | 0 | 1,958,000 |
| Mitat | Alushi | Kavajë | 5,522,000 | 0 | 1,671,063 | 3,850,937 |
| Miço | Guma | Himarë, Vlorë | 3,770,000 | 0 | 0 | 3,770,000 |
| Islam | Çuni | Vlorë | 6,568,000 | 0 | 800,000 | 5,768,000 |
| Gëzim | Sturçe | Shkodër | 316,000 | 0 | 0 | 316,000 |
| Piro | Nikolla | Sarandë | 3,200,000 | 0 | 526,685 | 2,673,315 |
| Ramaza | Dervishi | Karpen, Durrës | 734,000 | 100,000 | 20,000 | 614,000 |
| Ilirjan | Agaraj | Kropisht, Vlorë | 8,100,000 | 0 | 1,286,891 | 5,443,127 |
| Kajmak | Bojku | Peshkopi, | 242,000 | 0 | 0 | 242,000 |
| Agron | Seferkol | Arrze, Devoll | 1,782,000 | 0 | 360,000 | 1,422,000 |
| Petro | Caci | Tiranë | 5,332,000 | 0 | 876,164 | 4,455,836 |
| Jaho | Cirako | Elbasan | 1,240,000 | 0 | 0 | 1,240,000 |
| Fatmir | Cani | Elbasan | 972,000 | 0 | 0 | 972,000 |
| Bajram | Berisha | Elbasan | 1,024,000 | 0 | 150,000 | 874,000 |

STRATI

Shoqëria përmbarimore **"STRATI BAILIFFS SERVICE" Sh.p.k.**, njofton shpalljen për shitjen në ankand të pasurive të paluajtshme:

- Nr. Pasurie Nr. 6/36, Vol. 3, Faqe 137, Zona Kadastrale 1441, Arë me sipërfaqe 2400 m2, me vendndodhje ne Damjan - Tiranë, regjistruar në bashkëpronësi të Z. Ymer Tresa, Zj. Pranvera Tresa, Z. Florenc Tresa, Zj. Laerta Hakcani (Tresa). Çmimi fillestar i ankandit është 2.000.000 Lekë.
Ankandi për pasurinë e mësipërme zhvillohet në datë 23.05.2018.
Ankandi për pasuritë e mësipërme zhvillohet në ora 16.00, në ambjentet e Shoqërisë Përmbarimore "Strati Bailiff's Service", Rruga "Jordan Misja", Pall. 141/1, Shkalla 1, Ap. 7. Tiranë. Tel: 04 45 00 450, www.stratibailiff.com, info@stratibailiff.com

**ZYRA PËRMBARIMORE PRIVATE ENIRJETA ZISI**

**Permbaruese gjyqesore private Enirjeta Zisi z**hvillon ankandin per shitjen e pasurise se paluajtshme "Apartamenti" me siperfaqe 92.1m2, ZK.3866, Nr.Pasurie.300/143+1-7,Vol.83,Fq.186,Indeksi i Hartes K-34-100, te ndodhur ne Tirane, Yzberisht prane rruges "Joklin Persi ", kati i 3 ,shk.1 ap.7 Tirane,per shlyerjen e detyrimit ne favor te kreditorit Yzeir Llanaj,

Çmimi fillestar me të cilin fillon ankandi është ne shumen 4.778.400 (kater miljon e shtateqind e shtatedhjete e tete mije e katerqind) leke. e percaktuar ne vendimin gjyqesor.

**Ankandi zhvillohet ne date 20.04.2018, ora 16.00 ne zyren e Permbarueses gjyqesore private Enirjeta Zisi, Bulevardi "Gjergj Fishta", Pallati "Gora"Kulla.2,Kati i 2, Tirane Nr.Tel. 0694799000, email:enirjeta.zisi@gmail.com**

3H

**SHOQËRIA PËRMBARIMORE GJYQËSORE "3H" Sh.p.k**
Adresa: Rr." Demokracia" Pll.1, Kt.1, Vore, Tirane. .
Web: www.3-h.al; Email: shpgj_3h@yahoo.com Tel/Fax +355(0) 44532482

Njofton shpalljen e ankadit nga **dt.17.05.2018 deri ne dt. 25.05.2018** per: sende të luajtshme mjeti me targe AA 957 GX Nissan Atleon 140, Vit prodhimi 2000, karburant-nafte, per skrap ne pronesi te Subjektit "Harizi Co" me Nipt K82122503F

**Çmimi fillestar eshte 78,400.00 (shtatedhjete e tetemije e katerqind) Leke Ankandi zhvillohet ne zyren permbarimore ne daten 25.05.2018 dhe mbyllet me orarin zyrtar 16.00.**

## Nis aksioni në zonat turistike

# Tatimet: Kujdes kuponin dhe sigurimet e punonjësve, përndryshe gjoba



Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve njofton se ka nisur planin e masave për zbatimin me korrektësi të legjislacionit tatimor nga tatimpaguesit që ushtrojnë veprimtari në zonat turistike në mbarë vendin. Mbarëvajtja e këtij sezoni është në interes të së gjithë ekonomisë, të fluksit të turistëve, si dhe të bizneseve, që ushtrojnë veprimtari në zonat turistike. Administrata tatimore u bën thirrje të gjitha bizneseve dhe operatorëve turistikë që të zbatojnë me korrektësi legjislacionin tatimor dhe detyrimet që rrjedhin prej tij. Tatimet sjellin në vëmendje se strukturat e administratës tatimore do të kontrollojnë dhe verifikojnë të gjithë tatimpaguesit, përgjatë gjithë sezonit në lidhje me: 1. Respektimin e detyrimit për të qenë të regjistruar si biznes në QKB dhe në administratën tatimore. Mosrespektimi i këtij detyrimi penalizohet me bllokimin e mallrave dhe detyrimin për regjistrim direkt në TVSH. 2.Respektimin e detyrimit për dokumentimin e mallrave gjendje apo në transport. Në rastin kur tatimpaguesi i paregjistruar në TVSH gjendet me mallra të padokumentuar, përveç penalitetit përkatës të barabartë me detyrimin tatimor të mallrave pa dokument, gjithashtu bëhet edhe ndryshimi përgjegjësisë tatimore, duke e kaluar në tatimpagues me përgjegjësinë tatimore të TVSH-së. Në rastin kur tatimpaguesi është regjistruar në TVSH, vendoset penaliteti përkatës, i barabartë me detyrimin tatimor të mallrave pa dokument. 3. Respektimin e detyrimit për të lëshuar kupon tatimor apo faturë tatimore për çdo transaksion që tatimpaguesi kryen me klientët e tij. Sipas ligjit të Procedurave Tatimore, kur gjatë një verifikimi në terren konstatohet një tatimpagues, i cili nuk lëshon kupon tatimor për herë të parë, përveç vendosjes së gjobës në masën 50,000 lekë, për tatimpaguesit e regjistruar për TVSH-në bëhet edhe vlerësim tatimor nga zyra për tre muajt e fundit, duke përdorur metodat alternative. Pas konstatimit të parë, nëse tatimpaguesi vazhdon të mos e lëshojë kupon tatimor për të dokumentuar qarkullimin e realizuar të mallrave apo të shërbimeve, përveç aplikimit të dënimit në masën 50,000 (pesëdhjetë mijë) lekë, merret edhe masa e bllokimit të veprimtarisë në vendin ku është konstatuar shkelja për 30 ditë kalendarike. Çdo konstatim i përsëritur i moslëshimit të kuponit tatimor, pas dy konstatimeve të sipërpërmendura, përveç aplikimit të dënimit, konsiderohet evazion tatimor sipas pikës 2, të nenit 116, të ligjit të Procedurave Tatimore. Gjithashtu, publikohen emri i tatimpaguesit, NIPT-i dhe emri i përfaqësuesit të biznesit në faqen zyrtare të internetit të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.

## DPSHTRR fillon trajnimet për dëshminë e aftësisë profesionale për autoriparimet

# Punonjësit në servise, kushtet dhe afatet për të hyrë në kurse

## *Dokumentet që duhet të dorëzoni për të ndjekur kurset*

Ornela Manjani

Drejtoria e Kualifikimeve Profesionale (sektori i kualifikimeve) do të fillojë trajnimin e aplikantëve që kanë kërkuar të pajisen me Dëshminë e Aftësisë Profesionale për autoriparimet. Lajmi është bërë i ditur nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor, e cila lajmëron se trajnimi fillon me datë 21-28.05.2018 ora 10:00. Trajnimi do të zhvillohet pranë Qendrës së Kontrollit Teknik (ISH- NSHRAK-u), Tiranë. Burime zyrtare nga DPSHTRR bëjnë të ditur se trajnimet për dëshminë e aftësisë profesionale për autoriparimet do të vijojnë.

**KËRKESA PËR APLIKIM**

Aplikanti që kërkon të pajiset me DAP, në përputhje me përcaktimet e bëra në Ligjin nr.9573, datë 03.07.2006 "Për autoriparimet, shitblerjen, depozitimin e mjeteve rrugore me motor, të rimorkiove dhe të pjesëve të tyre të dala jashtë përdorimit ose të braktisura dhe për veprimtaritë që lidhen me to", të ndryshuar, duhet të plotësojë këto kërkesa: a) të jetë inxhinier mekanik ose teknik, mekanik transporti. b) Të mos jetë dënuar nga gjykata me vendim të formës së prerë për vepra penale të kryera në ushtrimin e veprimtarive të përmendura në pikën 2 të nenit 3 të këtij ligji. c) Të ketë aftësi fizike për të kryer këtë veprimtari, të vërtetuar nga organi shëndetësor përkatës, brenda juridiksionit të vendbanimit të tij.

**DËSHMIA PËR AUTORIPARIME**

Për t'u dhënë mundësinë të gjithë të interesuarve për të aplikuar për pajisjen me Dëshminë e Aftësisë Profesionale (DAP) të përgjegjësit teknik të veprimtarisë së autoriparimit dhe me Vërtetim të Aftësisë Profesionale (VAP) të titullarëve të Agjencive të Trajtimit të Praktikave të Qarkullimit të



Foto ilustruese

Mjeteve me Motor, DPSHTRR ka përgatitur të gjithë infrastrukturën e nevojshme për regjistrimin, testimin dhe pajisjen me DAP dhe VAP në plotësim të detyrimeve të Ligjit Nr. 9573, datë 03.07.2006 "Për autoriparimin, shitblerjen, depozitimin e mjeteve rrugore me motor, të rimorkiove dhe pjesëve të tyre të dala jashtë përdorimit ose të braktisura për veprimtaritë që lidhen me to", përgjegjësi teknik pajiset me Dëshmi Aftësie Profesionale për nënkategoritë: a)veprimtaritë e riparimit dhe të mirëmbajtjes së pjesëve mekanike dhe të motorit. b) Riparimin dhe mirëmbajtjen e karrocerisë. c) Riparimin dhe mirëmbajtjen e impiantit elektrik. ç)Riparimin dhe mirëmbajtjen e gomave. d) Subjektet që blejnë, shesin mjete me motor dhe rimorkio. dh) Subjektet që mbledhin, depozitojnë, shkatërrojnë mjetet ose pjesë të tyre të dala jashtë përdorimit apo të braktisura.

**DOKUMENTACIONI I NEVOJSHËM PËR REGJISTRIM**

Aplikantët që plotësojnë kushtet sipas nenit 4 të këtaj rregulloreje, për t'u pajisur me vërtetimin e regjistrimit duhet të dorëzojnë pranë Drejtorisë Rajonale të Shërbimeve të Transportit Rrugor (DRSHTRR) ku kanë vendbanimin, dokumentacionin e mëposhtëm:

a. Kërkesën në formë deklarate për pajisje me DAP (ku të ketë përcaktuar edhe nënkategorinë/ritë e kërkuara), sipas modeli 001S.

b. Kopjen e kartës së identitetit.

c. Kopje e noterizuar e diplomës 'Inxhinier mekanik') ose e Dëftesës së Pjekurisë (për teknik i mesëm mekanik).

d. Dokumentacionin teknik justifikues (origjinal ose fotokopje të noteruar) për atë që është e paraqitur si veprimtari e kryer prej tij, në CV, që kanë lidhje me fushën e veprimtarisë së nënkategorisë përkatëse.

e. Vetëdeklarim i personit, në lidhje me gjendjen e tij me organin e gjykatës, që nuk është dënuar me vendim të formës së prerë për vepra penale të kryera në ushtrimin e veprimtarive të përmendura në pikën 2, të nenit 3, të Ligjit nr.9573, datë 03.07.2006.

f. Vërtetim për aftësitë fizike për të kryer veprimtarinë e kërkuar, të vërtetuar nga organi shëndetësor përkatës, brenda juridiksionit ku banon.

**PROVIMI I NJOHURIVE**

**1.** Në provim merren aplikantët që janë të pajisur me autorizim dhe që kanë marrë pjesë në kursin përkatës të trajnimit.
**2.** Aplikantët për pajisje me DAP (Dëshmi Aftësie Profesionale), kanë të drejtë të paraqiten në provimin e njohurive të fituara në kurset e trajnimit, deri në tri herë brenda afatit të vlefshmërisë së autorizimit dhe vetëm në seksionet e kërkuara prej tyre.
Rinovimi i DAP (Dëshmi Aftësie Profesionale).
**1.** Rinovimi i DAP (Dëshmi Aftësie Profesionale) bëhet në rastet kur ky dokument dëmtohet (të dhënat e tij bëhen të palexueshme), shkatërrohet ose humbet.
**2.** Në rastin e dëmtimit, subjekti dorëzon dokumentin e vjetër të dëmtuar, dokumentin e identifikimit dhe 2 fotografi.
**3.** Në rastin e shkatërrimit, humbjes ose vjedhjes së dokumentit, subjekti duhet të paraqesë dokumentin e identifikimit, të dorëzojë 2 fotografi si dhe deklarimin përkatës për arsyen e rinovimit.
**4.** Në të gjitha rastet, subjekti kërkues plotëson kërkesën model 001S.
**5.** Dokumentet e mësipërme së bashku me një kopje të faturës dhe mandat-arkëtimit, administrohen në dosjen përkatëse të subjektit kërkues.
**6.** Procedurat e mëtejshme janë të njëjta si në rastin e aplikimit për herë të parë.

### Shtohen 692 biznese në Tiranë në tremujorin e parë

Në fund të tremujorit të parë të këtij viti, në Bashkinë e Tiranës numëron 692 biznese aktive më shumë nga sa deklaronte DPTTV në fund të vitit 2017. Rritja më e madhe ka ardhur në segmentin e bizneseve të mëdha dhe të vogla kryesore. Kjo do të thotë se rritja e hapësirës së sipërmarrjeve në Tiranës është shpërndarë njëtrajtësisht si me shtimin e bizneseve të vogla, ashtu edhe të mëdha. Ndërsa sa u takon tatimpaguesve të mëdhenj, apo të ashtuquajturave biznese VIP, ato janë rritur në segmentin e subjekteve sekondare, pra degëve të tjera me 42 njësi më shumë. Gjatë kësaj periudhë, numri i subjekteve që janë mbyllur duke aplikuar për çregjistrim apo kalim në status pasiv është 1143 biznese, kundrejt 2532 bizneseve të reja që janë hapur gjatë kësaj kohe. Bizneset e reja janë të përqendruara përgjithësisht në aktivitetet e shitjes me pakicë, ndjekur nga njësitë e shërbimit. Në shtim më të moderuar janë edhe bizneset që kanë si veprimtari shitjen me shumicë, profesionet e lira, si dhe njësitë e prodhimit. Shtimi i sipërmarrjeve ka rezultuar edhe në një rritje të lehtë të bizneseve të regjistruara për taksën e pasurisë.

Zbardhet formulari-tip për informim në lidhje me ecurinë e dosjes

# Pronarët në Fier, ATP merr në shqyrtim 1030 dosje

## *Rifreskohet lisa, procedurat për t'u njohur me ecurinë e shqyrtimit*

Ornela Manjani

Agjencia e Trajtimit të Pronave publikon listën me 1030 dosje ish- pronarësh që janë në proces shqyrtimi nga kjo agjenci. Kërkuesit janë në qarkun e Fierit dhe janë në pritje të vendimit të ATP-së. Në listën e përditësuar jepet numri i dosjes dhe data e aplikimit. Të gjithë ish-pronarët që kanë aplikuar për kthimin dhe kompensim pronë në Agjencinë e Trajtimit të Pronave dhe nuk janë njohur ende me vendimin e agjencisë mund të kërkojnë informacion në lidhje me fazën në të cilën ndodhet dosja. Agjencia e Trajtimit të Pronave ka në dispozicionin të pronarëve formularin -tip, "Informacion në lidhje me ecurinë e dosjes", i cili duhet të plotësohet dhe të dorëzohet në agjenci për të njohur me fazën në cilën ndodhet shqyrtimi i saj. Agjencia e Trajtimit të Pronave është e detyruar që brenda 15 ditëve nga momenti i dorëzimit të kërkesës të ktheje përgjigje pronarit në lidhje me ecurinë e dosjes.

**APLIKIMI**

Për t'u njohur me ecurinë e dosjes subjekti duhet të plotësojë dhe të paraqesë dorazi ose me postë pranë ATP-së dokumentacionin, kërkesën përkatëse me shkrim për informim në lidhje me ecurinë e dosjes, fotokopje të kartës së identitetit, dëshmi trashëgimie dhe prokurë të posaçme. Në faqen zyrtare të ATP-së mësohet se subjekti plotëson kërkesën me shkrim për informim në lidhje me ecurinë e dosjes pranë Zyrës së Marrëdhënieve me Publikun, në agjenci. Më pas kërkesa i kalon zyrës së protokollit, e cila pasi e protokollon i dërgon të gjitha kërkesat e ardhura Drejtorit të Përgjithshëm. Kreu i AKKP-ës ia delegon kërkesat sektorit përkatës për ndjekje dhe zbatim. Më pas sektori përkatës përgatitë informacionin e kërkuar dhe njofton subjektin. Në përfundim të shqyrtimit subjekti paraqitet pranë zyrave të ATP-së për të tërhequr shkresën me kthimin të përgjigjes në lidhje me ecurinë e dosjes ose i dërgohet me postë sipas kërkesës. Aplikimi për kërkesën për informim mbi dosjen nuk ka kosto.

**FORMULARI**

Formulari i aplikimit për formacion në lidhje me ecurinë e dosjes është i ndarë në tre seksione. Aplikanti duhet të plotësojë gjeneralitet dhe adresën dhe jetë i pajisur me mjet identifikimi në momentin e aplikimit. Në seksionin e dytë duhet të jetë përshkruar në mënyrë të saktë se në lidhje me çfarë kërkon informacion pala e interesuar, në këtë rast pronari që ka aplikuar për kthim e kompensim prone. Dhe ne seksionin e fundit janë të specifikuara pesë dokumentet që duhet të disponojë pronari në momentin e aplikimit.

**DOKUMENTACIONI QË DUHET TE PARAQISNI**

- Formulari tip
- Fotokopje e kartës së identitetit
- Kopje vendimi nga ish KKP/AKKP(nëse ka)
- Dokumente te tjerë


FORMULAR APLIKIMI

INFORMIM NË LIDHJE ME ECURINË E DOSJES

AGJENCIA E TRAJTIMIT TË PRONAVE
MINISTRIA E DREJTËSISË

Nëse keni pyetje, lutemi kontaktoni:
Tel: (+355) 42 22 56 831 / 38
E-mail: info.atp@atp.gov.al
Web: www.atp.gov.al

Shënim: Ju lutem plotësoni me kujdes dhe qartë informacionin e kërkuar në fushat më poshtë, ME SHKRONJË TË MADHE E NË NGJYRË BLU.

HAPËSIRË E REZERVUAR VETËM PËR INSTITUCIONIN

SEKSIONI A: INFORMACION MBI APLIKANTIN

1. Emri
2. Mbiemri
3. Emri i Babait
4. NID
5. Gjinia  Mashkull  Femër
6. Datëlindja
7. Vendlindja
8. Shtetësia
9. Adresa
10. Qyteti
11. Rrethi
12. Kodi Postar
13. E-mail
14. Nr. Tel. Celular
15. Nr. Tel. Fiks

SEKSIONI B: INFORMACION SPECIFIK MBI APLIKIMIN

16. Kërkoj informacion për:
Dosjen nr.  Emri i subjektit të shpronësuar  Qarku
17. Kërkoj kopje të vendimit

SEKSIONI C: DOKUMENTACIONI I PARAQITUR

Nënshkrimi i Aplikantit

KLAUZOLA DEKLARATIVE

Unë i/e nënshkruari/a ____________ në dijeni të përgjegjësive penale që rrjedhin nga deklarimi dhe paraqitja e të dhënave e rrethanave të rreme, nën përgjegjësinë time personale deklaroj se të dhënat e paraqitura në këtë formular janë të vërteta.

Nënshkrimi i Aplikantit

## 1030 DOSJE NË SHQYRTIM

| Nr | Date | Qarku | Statusi | Zona Kadastrale |
|---|---|---|---|---|
| 578 | 3/30/2001 | Fier | Ne shqyrtim | 8571 |
| 232 | 3/30/2001 | | Ne shqyrtim | L.Kongresi I Lushnjes |
| 76 | 3/30/2001 | Fier | Ne shqyrtim | 1027 |
| 569 | 3/31/2001 | Fier | Ne shqyrtim | 8571 |
| 572 | 3/31/2001 | Fier | Ne shqyrtim | 8571 |
| 577 | 3/31/2001 | Fier | Ne shqyrtim | 1380 |
| 1520 | 4/10/2001 | Fier | Ne shqyrtim | |
| 325/1 | 5/14/2001 | Fier | Ne shqyrtim | |
| 118 | 6/19/2001 | Fier | Ne shqyrtim | 1351 |
| 1507 | 7/5/2001 | Fier | Ne shqyrtim | |
| 492 | 7/24/2001 | Fier | Ne shqyrtim | 1143 |
| 330 | 7/24/2001 | Fier | Ne shqyrtim | dukas |
| 124 | 8/30/2001 | Fier | Ne shqyrtim | 1634 |
| 850 | 9/3/2001 | Fier | Ne shqyrtim | Fier |
| 493 | 10/15/2001 | Fier | Ne shqyrtim | 1422 |
| 329 | 10/15/2001 | Fier | Ne shqyrtim | corrush |
| 863 | 10/25/2001 | Fier | Ne shqyrtim | |
| 1517 | 11/9/2001 | Fier | Ne shqyrtim | Dermenas |
| 128 | 12/3/2001 | Fier | Ne shqyrtim | 1634 |
| 126 | 12/6/2001 | Fier | Ne shqyrtim | 2938 |
| 1513 | 12/6/2001 | Fier | Ne shqyrtim | Peshtan |
| 331 | 12/12/2001 | Fier | Ne shqyrtim | romes |
| 146 | 2/1/2002 | Fier | Ne shqyrtim | 2436 |
| 4–1 | 3/11/2002 | Fier | Ne shqyrtim | |
| 853 | 3/12/2002 | Fier | Ne shqyrtim | |
| 856 | 3/21/2002 | Fier | Ne shqyrtim | Fier |
| 854 | 3/28/2002 | Fier | Ne shqyrtim | |
| 138 | 4/4/2002 | Fier | Ne shqyrtim | 2435 |
| 164 | 4/8/2002 | Fier | Ne shqyrtim | 1341 |
| 15 | 4/12/2002 | Fier | Ne shqyrtim | 8572 |
| 137 | 4/16/2002 | Fier | Ne shqyrtim | 2265 |
| 132 | 4/17/2002 | Fier | Ne shqyrtim | 2265 |
| 4 | 4/17/2002 | Fier | Ne shqyrtim | 3105 |
| 134 | 4/29/2002 | Fier | Ne shqyrtim | 2938 |
| 148 | 5/8/2002 | Fier | Ne shqyrtim | 2265 |
| 4 | 5/27/2002 | Fier | Ne shqyrtim | 8571 |
| 139 | 6/24/2002 | Fier | Ne shqyrtim | 1351 |
| 497 | 7/9/2002 | Fier | Ne shqyrtim | 2869 |
| 339 | 7/15/2002 | Fier | Ne shqyrtim | greshic |
| 143 | 7/17/2002 | Fier | Ne shqyrtim | 1945 |
| 6 | 8/20/2002 | Fier | Ne shqyrtim | 8571 |
| 9 | 9/11/2002 | Fier | Ne shqyrtim | 2106 |
| 162 | 9/12/2002 | Fier | Ne shqyrtim | 1351 |
| 495 | 9/18/2002 | Fier | Ne shqyrtim | 1945 |
| 14 | 10/3/2002 | Fier | Ne shqyrtim | 8572 |
| 496 | 10/9/2002 | Fier | Ne shqyrtim | 1555 |
| 1525 | 10/11/2002 | Fier | Ne shqyrtim | |
| 152 | 10/19/2002 | Fier | Ne shqyrtim | 2802 |
| 860 | 11/4/2002 | Fier | Ne shqyrtim | Fier |
| 199 | 11/15/2002 | | Ne shqyrtim | Lushnje |
| 7 | 11/26/2002 | Fier | Ne shqyrtim | 1295 |
| 10 | 12/19/2002 | Fier | Ne shqyrtim | 1295 |
| 23 | 12/19/2002 | Fier | Ne shqyrtim | 1295 |
| 14 | 1/15/2003 | Fier | Ne shqyrtim | 8572 |
| 19 | 2/7/2003 | Fier | Ne shqyrtim | 1620 |
| 1532 | 2/12/2003 | Fier | Ne shqyrtim | |
| 498 | 3/4/2003 | Fier | Ne shqyrtim | 1539 |
| 155 | 3/7/2003 | Fier | Ne shqyrtim | 2265 |
| 12 | 3/13/2003 | Fier | Ne shqyrtim | 8572 |
| 28 | 3/13/2003 | Fier | Ne shqyrtim | 8572 |
| 42 | 3/27/2003 | Fier | Ne shqyrtim | 1596 |
| 27 | 3/28/2003 | Fier | Ne shqyrtim | 3848 |
| 864 | 4/3/2003 | Fier | Ne shqyrtim | |
| 156 | 4/9/2003 | Fier | Ne shqyrtim | 2265 |
| 40 | 4/10/2003 | Fier | Ne shqyrtim | 1271 |
| 157 | 4/22/2003 | Fier | Ne shqyrtim | 1422 |
| 499 | 4/25/2003 | Fier | Ne shqyrtim | 1090 |
| 31 | 5/6/2003 | Fier | Ne shqyrtim | 1380 |
| 158 | 5/16/2003 | Fier | Ne shqyrtim | 2111 |
| 607 | 5/16/2003 | Fier | Ne shqyrtim | |
| 36 | 5/25/2003 | Fier | Ne shqyrtim | 1883 |
| 41 | 7/4/2003 | Fier | Ne shqyrtim | golem |
| 46/1 | 7/16/2003 | Fier | Ne shqyrtim | |
| 161 | 7/21/2003 | Fier | Ne shqyrtim | 1965 |
| 163 | 9/1/2003 | Fier | Ne shqyrtim | 3436 |
| 1536 | 9/1/2003 | Fier | Ne shqyrtim | |
| 479 | 9/9/2003 | Fier | Ne shqyrtim | 2274 |
| 40 | 9/9/2003 | Fier | Ne shqyrtim | 3848 |
| 16 | 10/2/2003 | Fier | Ne shqyrtim | |
| 41 | 10/15/2003 | Fier | Ne shqyrtim | 3590 |
| 42 | 10/24/2003 | Fier | Ne shqyrtim | 3848 |
| 502 | 10/27/2003 | Fier | Ne shqyrtim | 1857 |
| 44 | 10/30/2003 | Fier | Ne shqyrtim | 2087 |
| 349 | 11/4/2003 | Fier | Ne shqyrtim | 1857 |
| 601 | 11/4/2003 | Fier | Ne shqyrtim | 1857 |
| 165 | 11/4/2003 | Fier | Ne shqyrtim | 1857 |
| 1539 | 11/20/2003 | Fier | Ne shqyrtim | |
| 350 | 11/27/2003 | Fier | Ne shqyrtim | 2104 |
| 160 | 12/3/2003 | Fier | Ne shqyrtim | 1635 |
| 503 | 12/4/2003 | Fier | Ne shqyrtim | 2104 |
| 270 | 12/15/2003 | Fier | Ne shqyrtim | ardenic |
| 347 | 12/18/2003 | Fier | Ne shqyrtim | 2076 |
| 1540 | 1/23/2004 | Fier | Ne shqyrtim | |
| 867 | 4/6/2004 | Fier | Ne shqyrtim | Fier |
| 48 | 4/6/2004 | Fier | Ne shqyrtim | 8572 |
| 1542 | 4/7/2004 | Fier | Ne shqyrtim | |
| 1541 | 4/14/2004 | Fier | Ne shqyrtim | Peshtan |
| 1543 | 5/18/2004 | Fier | Ne shqyrtim | Shen-Pjeter |
| 71 | 6/25/2004 | Fier | Ne shqyrtim | 1804 |
| 332 | 6/29/2004 | Fier | Ne shqyrtim | kute |
| 421 | 7/8/2004 | Fier | Ne shqyrtim | 8574 |
| 28 | 2/20/2006 | Fier | Ne shqyrtim | 8571 |
| 94 | 6/12/2006 | | Ne shqyrtim | 2265 |
| 104 | 6/16/2006 | Fier | Ne shqyrtim | 8571 |
| 19 | 5/14/2007 | Fier | Ne shqyrtim | 2287 |
| 45 | 6/11/2007 | Fier | Ne shqyrtim | 8534 |
| 49 | 6/12/2007 | Fier | Ne shqyrtim | 8572 |
| 67 | 7/12/2007 | Fier | Ne shqyrtim | 1295 |
| 76 | 7/24/2007 | fier | Ne shqyrtim | |
| 79 | 7/25/2007 | Fier | Ne shqyrtim | 1135 |
| 86 | 8/7/2007 | Fier | Ne shqyrtim | 8571 |
| 3 | 9/3/2007 | Fier | Ne shqyrtim | 2289 |
| 124 | 9/10/2007 | Fier | Ne shqyrtim | 3143 / 2636 |
| 108 | 9/10/2007 | Fier | Ne shqyrtim | 2786 |
| 121 | 9/10/2007 | Fier | Ne shqyrtim | |
| 117 | 9/10/2007 | Fier | Ne shqyrtim | 3300 |
| 147 | 9/19/2007 | Fier | Ne shqyrtim | krutje e poshtme |
| 161 | 9/19/2007 | Fier | Ne shqyrtim | 1819 |
| 157 | 9/19/2007 | Fier | Ne shqyrtim | 2286 |
| 158 | 9/19/2007 | Fier | Ne shqyrtim | 1610, 2789 |
| 156 | 9/19/2007 | Fier | Ne shqyrtim | 2451 |

INTERVISTA

# "Italia që ëndërronte Enver Hoxha dhe mbreti ynë i përbashkët"

Fatmira Nikolli

## *Nicola Predazi boton librin e tij studimor mbi marrëdhëniet italo-shqiptare në kohën e komunizmit*

*Në mesin e viteve nëntëdhjetë, ndërsa në shkollën time fillore, në ekipin tim të futbollit dhe në jetën time të përditshme prej fëmije vinin shumë shokë të rinj shqiptarë, mësuesi, për të na afruar me të sapoardhurit, na tha se mbreti i Italisë kishte qenë edhe mbreti i Shqipërisë. Më kujtohet se kjo më goditi shumë: në qoftë se mbreti ynë kishte qenë edhe mbreti i tyre - mendova - pse unë nuk di asgjë për vendin nga i cili vjen Erindi, që është aq i mirë në futboll? Dhe përse ai flet gjuhën time? Këto pyetje fëmijësh, i mora me vete edhe në universitet". Një kureshtje fëminore e Nicola Pedrazit është kthyer tanimë në një libër që këto ditë është paraqitur në Tiranë, ndonëse ende vetëm italisht.*

Në Festivalin "Ditënetët e librit" që mbahet të Muzeu Historik Kombëtar (16-20 maj), studimi i italianit Pedrazzi, nën titullin "Italia që ëndërronte Enveri", jep pamjen e Shqipërisë, nga përtej detit. Në një intervistë për 'GSH', Nicola Pedrazi, rrëfen edhe se nëse në periudhën e pasluftës komunizmi italian kishte pak marrëdhënie me komunizmin shqiptar, ka të bëjë kryesisht me ndikimin e Jugosllavisë. Sipas tij, shumë personalitete të komunizmit shqiptar u formuan në Itali, shumë prej tyre në Ventotene, në burgun fashist. Por regjimi i themeluar në Shqipëri në vitin 1946, fillimisht projugosllav, pastaj stalinist i ngurtë, e bëri të pamundur zhvillimin e atyre marrëdhënieve, që përvoja e përbashkët e antifashizmit do ta kishte bërë të mundur.

**-Pse një libër me temë Enver Hoxhën, nga erdhi stimuli?**

Libri im nuk ka si temë kryesore Enver Hoxhën, as diktaturën që instaloi ai, por marrëdhëniet mes Italisë dhe Shqipërisë gjatë Luftës së Ftohtë: që nga fundi i Luftës së Dytë Botërore (që çoi shumë italianë në Shqipëri), deri në vitet shtatëdhjetë, kohë e të ashtuquajturave vite "filokineze" të Shqipërisë, shumë interesante sepse Shqipëria ishte vendi i parë evropian në të cilin Kina ka investuar ndonjëherë. Stimuli erdhi nga një vëzhgim shumë i thjeshtë për një italian të moshës sime, lindur në vitin 1986. Në mesin e viteve nëntëdhjetë, ndërsa në shkollën time fillore, në ekipin tim të futbollit dhe në jetën time të përditshme prej fëmije vinin shumë shokë të rinj shqiptarë, mësuesi, për të na afruar me të sapoardhurit, na tha se mbreti i Italisë kishte qenë edhe mbreti i Shqipërisë. Më kujtohet se kjo më goditi shumë: në qoftë se mbreti ynë kishte qenë edhe mbreti i tyre - mendova - pse unë nuk di asgjë për vendin nga i cili vjen Erindi, që është aq i mirë në futboll? Dhe përse ai flet gjuhën time? Këto pyetje fëmijësh, i mora me vete edhe në universitet. Duke e romantizuar pak, por në të njëjtën kohë edhe duke qenë i sinqertë, do të thosha se libri im ka lindur nga nevoja për të kuptuar se nga vjen nga Shqipëria që pamë të derdhej në brigjet tona kur ishim të rinj?

**-Ishte vetëm kureshtja juaj?**

Nuk mendoj se kjo është një nevojë vetëm e imja. Shumë italianë të brezit tim kanë si kujtesën e tyre të parë politike shpërbërjen e ish-Jugosllavisë, fundin e Shqipërisë socialiste dhe luftën e Kosovës. Ky ishte konflikti evropian i fëmijërisë sonë paqësore dhe me sa duket, ndjejmë nevojën për të shkruar dhe për të vënë në pikëpyetje veten dhe marrëdhënien tonë me atë të kaluar. Duke ndjekur të njëjtën skemë, për analogji, pyes veten se me cilat pyetje, a me cilët libra po rriten në mendjen e tyre fëmijët e sotëm italianë, të cilët më shumë se brezi im janë në kontakt me imazhe të konflikteve, shkrirjes së shteteve dhe emigrimit. Siç është e qartë, se pas rënies së murit, historia e njerëzimit nuk u ndal, por për Italinë, Shqipëria nuk është më emergjencë dhe koha më në fund ka ardhur për kërkime historike. Pas më shumë se 25 vjetësh, ne kemi krijuar distancën e duhur për të bërë studime. Shpresoj që kjo distancë të përdoret nga historianët të rinj shqiptarë: për analiza, rindërtimin dhe të kuptuarit të regjimit të Enver Hoxhës. Por e përsëris: i imi nuk është një libër për regjimin, është një libër mbi marrëdhëniet italo-shqiptare në kohën e komunizmit.

**- Gjatë kërkimit të librit, çfarë zbulove që të befasoi më shumë?**

Në tri vite studimi, zbulimet kanë qenë të shumta. Kjo, edhe sepse isha dhe mbetem jo shumë i ditur mbi historinë shqiptare, por edhe mbi *historinë* e madhe që është historia e marrëdhënieve italo-shqiptare që u përpoqa të tregoja. Gjatë Luftës së Ftohtë marrëdhëniet midis Shqipërisë dhe Italisë janë të polarizuara, janë të ndërthurura me kontradiktat ideologjike të një epoke në të cilën çdo marrëdhënie i atribuohej kontekstit bipolar. Përkundër kësaj, krejt në heshtje marrëdhëniet italo-shqiptare vazhduan. Jo vetëm për shkak të vlerësimit që Italia gëzonte te (tele)shikuesit shqiptarë (tifozët e deri te anija 'Vlora'), por edhe me anë të atij interesi, tërësisht ideologjik dhe politik, me pakicën komuniste italiane, e cila, duke filluar nga lufta e përbashkët çlirimtare e kryer në Itali dhe në Shqipëri kundër pushtuesve gjermanë, kishin idealizuar përvojën e komunizmit shqiptar, në fakt duke besuar në propagandën e regjimit Enverian.


Nicola Predazi



Kopertina e librit në italisht

**-Ishte efektive propaganda?**

Një regjim që ndryshe nga sa na është thënë ka qenë gjithmonë shumë i vëmendshëm për imazhin e tij të jashtëm, si dhe për marrëdhëniet ndërkombëtare, edhe pse të kryera në nivelin e "palëve vëllazërore" në vend të atyre diplomatike. Këtu, le të themi se zbulimi që më goditi ishte pikërisht "hapja" e një regjimi që përshkruhet gjithmonë si i mbyllur plotësisht. Sigurisht që ishte i mbyllur kundër shqiptarëve, sepse sundoi me grusht të hekurt, por në kohën e Luftës së Ftohtë nuk mund të shpëtoje nga kampet. Ja pse ndonëse e izoluar, Shqipëria e Enver Hoxhës shpenzonte burime të konsiderueshme për propagandën e jashtme, në përkthimin e veprave të liderit dhe në financimin e formacioneve të vogla promaoiste, për ta shitur në tregun kinez në këmbim të një aleance, ku me sa duket Kina kishte gjithçka për të dhënë dhe asgjë për të marrë. Nëse Mao e mbajti Shqipërinë si një aleat të vlefshëm evropian dhe në qoftë se për një kohë të gjatë e financoi regjimin, e bëri këtë jo vetëm për shkak se Hoxha kërkoi njohjen ndërkombëtare të Pekinit, por edhe për shkak se regjimi shqiptar promovoi në gjithë Europën partitë komuniste filokineze. Në Itali, bashkëbiseduesi ishte Partia Komuniste e Italisë, marksiste-leniniste e Fosco Dinuçi. Pra, po flasim për figura të vogla të komunizmit italian, të cilat përmes Tiranës mund t'i shtrëngonin duart Maos.

**-Si ju dukej Shqipëria?**

Për këta njerëz, Shqipëria ishte një vend i hapur, ndërkombëtar, mbështetës, një eksperiment revolucionar në qendër të botës. Kjo është arsyeja pse unë zgjodha titullin e kundërt të historisë s njohur: jo më shqiptarë që ëndërrojnë Italinë si të ishte Amerika, por italianë që ëndërrojnë Enverin si të ishte revolucioni. Me rënien e murit, zhgënjimet ishin më shumë se një.

**-Si ishin marrëdhëniet e Hoxhës me komunistët italianë?**

Varet nga ajo që nënkuptohet me shprehjen "komunistët italianë". Nëse duam Partinë Komuniste italiane (PCI), janë marrëdhënie vëlazërore deri në 1956 (në vitin 1954 Hoxha fton Togliattin për të kaluar pushimet në Shqipëri), por ndërpriten papritmas, kur Shqipëria u prish me Bashkimin Sovjetik. Siç u përmend, gjatë periudhës pro-kineze të tjerë "komunistë italianë" krijuan marrëdhënie të forta me Partinë e Punës: stalinistë dhe maoistë që i bashkonte me Enver Hoxhën vlerësimi për komunizmin: një parti borgjeze që kishte mohuar revolucionin. Në vitet gjashtëdhjetë dhe shtatëdhjetë, Hoxha i kushtoi disa tekste atij që e quajti "revizionizmi Togliatti-an", tekste që u përhapën dhe u lexuan edhe në Itali.

**-Çfarë nuk shkoi?**

Nga një perspektivë historike, tani mund të pohojmë se ajo që për diktatorin shqiptar ishte e patolerueshme ishte hapja e Togliatit dhe partisë së tij ndaj komunizmit të Titos. Në destalinizimin e nisur nga Hrushovi dhe në teorinë *togliatti-ane* të "rrugëve kombëtare të socializmit", si edhe në eurokomunizmin Berlinguer, Hoxha ka parë gjithnjë rrezikun e një instalimi të modelit jugosllav. Një frikë shumë e kuptueshme, sepse ishin jugosllavët, ata që themeluan Partinë Komuniste Shqiptare dhe në qoftë se në vitin 1948 Stalini dhe Tito nuk do të kishin prishur çdo marrëdhënie, ka gjasë dhe do të ishte e mundshme që Hoxha nuk do të kishte qëndruar në pushtet. Me fundin e stalinizmit dhe shpalljen e bashkëjetesës paqësore të Bashkimit Sovjetik dhe në çdo evolucion a reformë të kampit komunist, Hoxha ka parë gjithmonë një kërcënim si të gjithë diktatorët, e është e vështirë të thuhet nëse kërcënimin që ka parë, e ka parë si kërcënim për veten apo për shtetin shqiptar.

**-Pse nuk qenë marrëdhënie më të afërta?**

Ajo që është e sigurt, është se nëse në periudhën e pasluftës komunizmi italian kishte pak marrëdhënie me komunizmin shqiptar, ka të bëjë kryesisht me ndikimin e Jugosllavisë. Shumë personalitete të komunizmit shqiptar u formuan në Itali, shumë prej tyre në Ventotene, në burgun fashist. Por regjimi i themeluar në Shqipëri në vitin 1946, fillimisht projugosllav, pastaj stalinist i ngurtë, e bëri të pamundur zhvillimin e atyre marrëdhënieve që përvoja e përbashkët e antifashizmit do ta kishte bërë të mundur. Megjithatë, duke bërë këtë lloj supozimi, gjithnjë duhet mbajtur parasysh se ndryshe nga komunistët shqiptarë, komunistët italianë morën pjesë me forca të tjera politike në hartimin e kushtetutës demokratike. Në këtë kuptim, në këtë pikëpamje, marrëdhëniet mes dy partive nga ana kushtetuese ishin të pamundura, pavarësisht nga konteksti ideologjik i Luftës së Ftohtë.

E DIEL
20 Maj
2018

MILOSAO

# *Arkitekti* Arben BIÇOKU

# "Piramida mund të vihej në funksion të Bibliotekës Kombëtare"

Piramida po shndërrohet në një qendër multifunksionale ashtu si në Tiranë janë zhvendosur në kohë të ndryshme shumë nga objektet e dikurshme. Për ekipin e ri të Bashkisë, ky quhet një novacion, por për Tiranën është humbja e një simboli të jashtëzakonshëm, që mund t'i shërbente Shqipërisë me atribute të tjera shumë më simpatike...



# Letërsi e angazhuar – arti politik në shekullin XXI



NGA DR. SILVANA LEKA

Prej kohësh lexojmë e dëgjojmë se artistët nuk duhet të bëhen mjete, vegla apo marioneta në duart e politikës. Po çfarë sugjerohet për këtë? Letërsi e angazhuar? Përsëri letërsi e angazhuar edhe në shekullin XXI...? E angazhuar si, dhe në ç'drejtim? Letërsi e angazhuar politikisht, e vendosur kundër politikave dhe ngjarjeve aktuale? Letërsi e angazhuar, si përqeshje dhe satirë, humor i zi ndaj çështjeve sociale, ndaj temës së emigrantëve, ndaj rikthimit të histerisë së masave dhe pranisë së kampeve në Europë? Letërsi e angazhuar ndaj çështjeve gjinore, fobive, përndjekjes dhe persekutimeve të ndryshme që u mbartën nga shekulli XX drejt shekullit XXI, ndaj luftërave në Siri apo valës në rritje të fashizmit politik dhe kapitalizmit agresiv në vendet e Europës juglindore? Apo letërsi që shkruan të kundërtën e asaj që bën politika dhe institucionet, kur gabojnë? Një letërsi që i kundërvihet asaj që shpesh njerëzit e besojnë verbërisht. Një letërsi rezistence, kundrejt asaj që është kthyer në *cliché*, kundër asaj që pranohet edhe pse nuk na pëlqen, ngaqë njerëzit janë thyer, ngaqë shpresat dhe besimi janë rrëzuar dhe të gjithë ndihen të lodhur, të zhgënjyer dhe të dorëzuar? Mos vallë angazhim do të thotë ngulmim i një autori ndaj të njëjtës çështje: angazhim ndaj lexuesit dhe ndaj zejes së shkrimit për të krijuar një vepër të mirë?

Në kohë të ndryshme dhe në rende të ndryshme shoqërore termi angazhim në letërsi ka njohur disa kuptime, të cilat shpesh kanë qenë edhe të kundërta. Për Bashkimin Sovjetik, për shembull, angazhimi në letërsi kishte gjithmonë kuptimin e agjitacionit dhe propagandës në dobi të kauzës socialiste dhe simpatisë ndaj komunizmit.

→ Vijon në faqen 16

Redaktor: Ben Andoni; Grafika Artan Buca 336

**Në këtë numër:** ARBEN BIÇOKU, SILVANA LEKA, FASLLI HALITI, FARUK MYRTAJ, SUL GRAGJEVI DHE SKICA NGA MAKS VELO...

MILOSAO

E diel 20 Maj 2018 GAZETA SHQIPTARE

A
ARGUMENT

*Në këtë intervistë, arkitekti i njohur flet për ndryshimet e Tiranës dhe intensitetin e ndërtimeve. Ai shprehet për Qendrën Ndërkombëtare të Kulturës, por edhe për shumë objekte dhe mbi të gjitha simbolikat e Tiranës. "Unë si arkitekt nuk jam kundër kullave. Ajo që personalisht do donja të ishim të kujdesshëm, janë intensitetet e ndërtimit. Shoh së fundmi tentativa për intensitete ndërtimi që janë të mëdha. Personalisht do isha kundra një shfrytëzimi shumë intensiv", shprehet ai për "Milosao".*

# Arkitekti Arben Biçoku: Piramida mund të vihej në funksion të Bibliotekës Kombëtare

INTERVISTOI BEN ANDONI

Piramida po shndërrohet në një qendër multifunksionale ashtu si në Tiranë janë zhvendosur në kohë të ndryshme shumë nga objektet e dikurshme. Për ekipin e ri të Bashkisë, ky quhet një novacion, por për Tiranën është humbja e një simboli të jashtëzakonshëm, që mund t'i shërbente Shqipërisë me atribute të tjera shumë më simpatike...

**Z. Biçoku, ju e njihni më së miri historinë e arkitekturës në Shqipëri, së bashku me transformimet nga epoka në epokë. Sipas jush cila do të ishte qasja më e mirë për përcjelljen e bashkëkohores dhe futjen e modernes në arkitekturë duke ruajtur njëkohësisht edhe traditën?**

"Arkitektët në çdo epoke kanë tendencë të bëjnë arkitekturën e epokës të tyre, të përqafojnë të renë. Edhe arkitekturat e epokave të shkuara që ne trashëgojmë kur janë realizuar kanë qenë modernë për kohen e tyre.

Sot nëse hedhim vështrimin çfarë realizohet do të gjejmë edhe shembuj shumë të mire të zhvillimeve arkitektonike, siç gjithashtu mund të gjejmë me shumicë shembuj që na vrasin sytë dhe që aspak nuk mund të përmenden për mire. Arkitektura është një fenomen shoqëror, jo thjesht një fenomen individual. Dhe përparimi i saj ka të bëjë shumë edhe me mendësinë shoqërore, me nivelin ekonomik të vendit, me mënyrën si drejtohet administrata politike, etj.

Nëse do me pyesnin çfarë çalon sot, unë do thonja respektimi i mendimit të shtresës së urbanistëve dhe arkitektëve. Do duhej që administrata ti merrte me tepër parasysh idetë e tyre. Gjithashtu dhe shoqëria duhet të kultivohet me tepër në drejtim të asaj që quhet arkitekturë e mire. Të mos harrojmë që ALUIZNI ka raportuar që pranë zyrave të tij janë vetëdeklaruar rreth 470.000 ndërtime pa leje. Këto ndërtime që për kohen janë kryer në shkelje të ligjit, sigurisht që dhe raportin me cilësinë e arkitëkturës në një mase të madhe e kanë për të dëshiruar.

Tendencat e arkitekturës së sotme, përveç funksionalitetit dhe estetikës, në nivele më të mira se me përpara, karakterizohen dhe nga një trajtim më miqësor me mjedisin, nga një eficencë shumë më e lartë energjitike, etj. Sot arkitektët bëjnë kujdes ti termoizolojnë sa më mire mbështjelljet e jashtme të ndërteses, si kur janë mure, duke i termoizoluar, po ashtu dhe kur janë xhama, duke i trajtuar me xhama speciale me përcjellshmeri të ulet termike. Arkitektët gjithashtu bëjnë kujdes që vetë ndërtesa të jetë prodhuese e energjisë, përmes paneleve fotovoltaike, përmes paneleve diellore për prodhimin e ujit të ngrohtë, apo formave të tjera të kapjes se energjisë së erës, ajrit, etj. Përparimi i teknologjisë dhe prodhimi i një game të gjerë materialesh veshëse industriale gjithashtu është një gjë që ka gjetur mjaft aplikim".

**Cila do të ishte "prerja e artë", si të themi, e raportit simbiotik midis tradicionales dhe modernes në arkitekturë, dhe cila është përvoja, përfshirë arritjet a gabimet tona në këtë drejtim?**

"Përgjigja e kësaj pyetjeje nuk është një formule e gatshme, që duke e thënë mbaron punë. Unë besoj se një arkitekt i mirë duhet ta njohe shume mire traditën. Mendoj gjithashtu që arkitektura është kontekstuale, bëhet sipas kushteve të mjedisit ku ti e propozon ndërtimin, pra duhet të marrë mirë parasysh se çfarë ka përreth. Por ndërkohë arkitektura është në vijimësi në një tendencë ndryshimi dhe përparimi. Nuk është një fenomen që rri statik në vend dhe nuk lëviz. Mua personalisht kur me është dashur të projektoj në zona historike, p.sh. në qytetin e Beratit, brenda lagjeve muzeale të tij, kam respektuar mënyrën tradicionale të konceptimit të ndërtesave, gjuhën që vinte nga banesat monument kulture të vendosura në mbrojtje. Ka vende të tjera, ku elementët e traditës nuk e dominojnë ambjentin e ndërtuar, p.sh. Tirana, ku ti ke shkallë më të madhe lirie për të propozuar një estetike me novatore. Sigurisht që edhe gabime gjen plot në këtë dinamike të shpejtë të zhvillimeve të qyteteve tona. Kjo dhe për faktin që tek në nuk ekziston një kritike e mirëfilltë arkitekture, nuk bëhet një debat qytetar për produktin arkitektonik".

**Ka një vëmendje të stërmadhe ndaj zhvillimeve në Tiranë, ndërkohë që marrëdhënia, ta quajmë fluide, midis tradicionales dhe modernes në ndërtime dhe arkitekturë haset kudo në Shqipëri. Ç'mund të na thoni ju për këtë raport në qytete të tjerë të vendit, si p.sh. në Korçë, Durrës, Elbasan, Gjirokastër, Shkodër, Berat, Sarandë, etj?**

"Qytetet tona kush me shumë e kush me pak kanë trashëguar në kohë një arkitekturë tradicionale. Por zhvillimet demografike shpesh kanë bere që mbivendosja dinamike e ndërtimeve të reja të zhdukë trashëgiminë e arkitektures tradicionale. Qyteti i parë që u përplas me këtë demografi dinamike zhvillimi që Tirana e pasluftës se dytë botërore. P.sh. në listën e humbjeve hyjnë ndërtimet e Pazarit të Vjetër, por edhe ato me të reja si ndërtesa e Bashkisë. Tirana u ripërplas me këtë fenomen edhe pas viteve '90 duke humbur shume nga kualitetet e saj tradicionale, dhe sidomos shumë ndërtime që i përkasin viteve '30, në formën e vilave kryesisht. Ka qytete që e kanë ruajtur relativisht mirë një pjese të ndërtimit të tyre tradicional, do përmendja Korçën, Shkodrën, dhe sigurisht Beratin dhe Gjirokastrën. Unë mendoj që në duhet të jemi më të vëmendshëm ndaj trashëgimisë dhe respektimit të saj".

**Pse pushteti lokal, sidomos ai që lidhet me qeverisjen socialiste e ndjen vetën më të fortë për të bërë ndryshime, qoftë dhe pa marrë aprovimin e publikut?**

"Pyetje interesantë kjo. Nëse vërejmë sjelljen politike të periudhës së tranzicionit do shohim që në nuk para e kemi qejf pyetjen e publikut, nga asnjëri nga krahët e politikes, as nga e djathta as nga e majta, pra nga klasa politike në përgjithësi. Në këtë vend mungojnë si referendumet kombëtare po ashtu dhe ato vendore. Ky është fenomen politik, dhe prek të tëra fushat e jetës, jo vetëm arkitekturën dhe ndërtimin.

Ndërkohë nëse vërejmë qeverisjen e sotme socialistë, krahasuar me atë të mëparshme të demokratëve vërejmë një ndryshim se ku po destinohen investimet publike. Ndërsa qeverisja socialiste është përqendruar në investimet që sjellin përmirësime në qytete, duke futur ketu si infrastrukturën po ashtu edhe fasadat e ndërtesave, sheshet publike, objektet shoqërore etj., qeverisja demokratë ka qenë e përqendruar me shume në investimet infrastrukturore interurbane, kryesisht në rrugët kombëtare.

Në të dy rastet kontaktet me publikun përgjithesisht janë veç në fushatat elektorale.

Gjithsesi tentativa e qeverisjes se sotme për tu marre me një mirërregullim të qyteteve për mua është për tu përshëndetur".

**A mendoni se kuadri ligjor ka mangësi, ka tej përqendrim kompetencash tek ekzekutivi qoftë në nivel qendror dhe vendor, që mund të duket edhe tek anashkalimi i mendimit të komunitetit, apo mungesës së pjesëmarrjes së qytetarëve në vendimmarrje?**

"Unë mendoj se i gjithë sistemi ynë politik ka difekte. Filluar që nga kushtetuta. Mbase kjo ngaqë ne jemi një demokraci e re dhe larg të qënit perfekte. Ne kemi një sistem politik ku dominon vullneti i kryetareve të partive, por ku



Arben Biçoku

## QNK, si mund të ishte!

"Për mua është e rëndësishme që ajo të jetë një qendër kulturore. Dhe atë shumëkush e mban mend pikërisht si qendër kulturore multifunksionale, mjaft njerëz kujtojnë aty "Rinfestet" e rinisë së tyre. Mbase edhe një diskutim me publikun këtu do të kishte vlerë. Fare mirë ajo hapësirë mund të kthehej edhe në funksion të Bibliotekës Kombëtare, e cila vijon prej kohësh të vuajë ngushticën dhe mungesën e ambienteve të nevojshme".



## Çfarë kemi humbur nga Tirana

"Qyteti i parë që u përplas me ketë demografi dinamike zhvillimi që Tirana e pasluftës së Dytë Botërore. Psh., në listën e humbjeve hyjnë ndërtimet e Pazarit të Vjetër, por edhe ato më të reja si ndërtesa e bashkisë. Tirana u ripërplas me ketë fenomen edhe pas viteve '90, duke humbur shumë nga kualitetet e saj tradicionale dhe sidomos shumë ndërtime që u përkasin viteve '30, në formën e vilave kryesisht. Ka qytete që e kanë ruajtur relativisht mirë një pjese të ndërtimit të tyre tradicional, do përmendja Korçën, Shkodrën dhe sigurisht Beratin e Gjirokastrën. Unë mendoj që në duhet të jemi më të vëmendshëm ndaj trashëgimisë dhe respektimit të saj".

# V
## VIZATIME

*Ky është cikli i tretë i autorit dhe na sjell një gjendje të caktuar nga përballjet me Parisin, qytetin e tij të lindjes. Pas “vrazhdësisë” së linjës, duket një ndjenjë nostalgjie që i vishet si shtresë ndjenjave të piktorit, jeta e të cilit ka pasur shumë oscilacione të dhimbshme dhe mbetet e mbushur me trishtime dhe zhgënjime pa fund. Paçka në këtë tis, një qenie merr shumë mesazhe pozitive nga nënvetëdija e Velos, që nuk e ndan Parisin nga kujtesa e tij...*











politikanët e tjere nuk kanë shume shkalle pavarësie. Unë si qytetar nuk kam mundësi të votoj për deputetin që më pëlqen, për këshilltarin bashkiak që më pëlqen. Duhet të zgjedh veç siglën e partisë që preferoj. Pra kthehemi në një sistem që kanë rëndësi dy njerëz, ai që është në krye të PS dhe ai që është në krye të PD. Të tjerat janë me pak të rëndësishëm. Ky nuk është një sistem i përsosur demokratik. Ndërkohë kjo si metode zbret edhe me poshtë duke pasur një sistem që gjithnjë vendimmarrja diktohet nga lart, dhe politika është me e pandjeshme për sinjalet që vijnë nga poshtë”.

**A nuk ju duket se ka ardhur koha të flitet për boshllëkun ligjor për referendume vendore?**

“U shpreha me lartë për këtë. Nuk besoj se në vetvete kemi mangësi në ligj për sa i përket referendumeve. Thjesht kemi ngritur një sistem politik i cili në vetvete ka nevojë për korrigjime. Dhe besoj se është mënyra e sjelljes se vetë politikes ajo që ka nevojë të përsoset më tepër se sa ligjet”.



**Të kthehemi tek kryeqyteti. Ka një shqetësim të ligjshëm qytetar se hapësirat dhe ndërtesat publike, madje me rëndësi mbarëkombëtare, janë lënë në harresë, u ndërrohet destinacioni, ndërkohë që institucione thelbësore të dijes, librit dhe analogjisë vuajnë nga mungesa e mjediseve, investimeve etj. Kritika janë hedhur, për shembull, për një VKM të qeverisë që ia kaloi pronësinë dhe administrimin e ish-Qendrës Ndërkombëtare të Kulturës [QNK] për tek Bashkia e Tiranës. A mendoni se QNK-ja do të mund apo duhej të ruhej dhe të transformohej në një Strehë të madhe dhe të mirëfilltë librit, kulturës dhe studimeve mbarëkombëtare shqiptare për Mijëvjeçarin e Tretë?**

“Unë personalisht do mund të listonja plot gjera që nuk shkojnë siç unë do dëshiroja. Kjo pak rëndësi ka. Një pjese të problematikes e shprehet edhe ju. Veç tyre ka dhe gjera të tjera që nuk shkojnë. Duke u rikthyer tek ndërtesa e ish QNK, mendoj se ajo është një ndërtese që e ka fituar qytetarinë e saj, dhe për me tepër karakterin e saj, që duhet të jetë një karakter kulturor. Në se do ishte më mirë të funksiononte? Këtu idetë janë të ndryshme, dikush e mendoi teatër (dhe u bë një projekt për ketë e u benë edhe punime), dikush strehë të librit, dikush muzeum (që në fakt është dhe destinacioni për të cilën ajo është projektuar). Për mua është e rëndësishme që ajo të jetë një qendër kulturore. Dhe atë shumëkush e mban mend pikërisht si qendër kulturore multifunksionale, mjaft njerëz kujtojnë aty Rinfestët e rinise se tyre. Mbase dhe një diskutim me publikun këtu do të kishte vlere. Fare mire ajo hapësirë mund të kthehej edhe në funksion të Bibliotekës Kombëtare e cila vijon prej kohesh të vuaje ngushticën dhe mungesën e ambjenteve të nevojshme”.

**A nuk po modifikohet krejt simbolika urbanistika e Tiranës me kullat që po mbijnë në çdo vend?**

“Unë do ju bënja kundërpyetjen, cila ka qenë simbolika e Tiranës? Tirana ka qenë në një zhvillim të vazhdueshëm. Dhe përveç shtrirjes horizontale në territor, është synuar edhe shtrirja në vertikalitet. Përshembull Hotel “Tirana” në sheshin “Skënderbej”, me lartësinë e tij prej 15 katëve, realizuar në vitet ’70 ka qenë një përpjekje për shtrirje vertikale. Të mos harrojmë që minarja e xhamisë së Et’hem Beut, dhe Kulla e Sahatit të Tiranës, u sfumuan si imazhe të para nga rruga e Durrësit, apo qoftë dhe nga sheshi Skënderbej, që me realizimin e ndërtesës që quhet Torre Drini në mesin e viteve ’90. Unë di që siluetës se humbur tashme të Tiranës është synuar ti behet një siluetë e re në vertikalitet. Kjo ka qenë domethenia e miratimit të studimit urbanistik të qendrës së Tiranës në vitin 2004, atij që quhet në zhargon plani Francez. Personalisht nuk e quaj të gabuar.

Unë si arkitekt nuk jam kundër kullave. Ajo që personalisht do doja të ishim të kujdesshëm, janë intensitetet e ndërtimit. Shoh se fundmi tentativa për intensitete ndërtimi që janë të mëdha. Personalisht do isha kundra një shfrytëzimi shume intensiv”.

A
ARGUMENT

*Në kohë të ndryshme dhe në rende të ndryshme shoqërore termi angazhim në letërsi ka njohur disa kuptime, të cilat shpesh kanë qenë edhe të kundërta. Për Bashkimin Sovjetik, për shembull, angazhimi në letërsi kishte gjithmonë kuptimin e agjitacionit dhe propagandës në dobi të kauzës socialiste dhe simpatisë ndaj komunizmit, shkruan autorja...*

# Letërsi e angazhuar – arti politik në shekullin XXI

NGA DR. SILVANA LEKA

*Vijon nga faqja 13*

Por pavarësisht këtyre, ekziston edhe një term i përpiktë që këtë letërsi e përkufizon tek letërsitë e angazhimit etik, shoqëror e politik. Ndonëse prirja dhe qëndrimi politik vërehet që me veprat e para të tragjedisë dhe komedisë greke, dhe madje, sipas disa studiuesve edhe teatri i Shakespeare-it, sidomos me *Rikardin e III-të*, është "një teatër politik" edhe kryevepra e George Eliot-it, *Middlemarch* po ashtu, termi "letërsi e angazhuar" lidhet me rastin kur shkrimtari e shpall haptazi dhe jo vetëm në forma letrare, përmes veprës, angazhimin e tij ndaj një çështjeje apo një kauze, të tilla si ato që u shfaqën menjëherë pas Luftës së Dytë Botërore.

Në këtë rrjedhë u përfshinë sidomos shkrimtarët dhe filozofët ekzistencialistë francezë të gjysmës së dytë të shekullit XX, të cilët ofruan qasje intelektuale në trajtimin e çështjeve publike, për t'ia lëshuar vendin më vonë dramave realiste të Arthur Miller-it, teatrit epik të Bertolt Brecht, komedive të Dario Fo apo autorëve si Selman Rushdie, Elfriede Jelinek, Harold Pinter, Carly Churchill, Ayn Rand, Jean Genet, Margaret Atwood, Jonathan Coe dhe shumë të tjerë.

Por letërsia e angazhuar nuk është një fenomen që i përket përjashtimisht kohërave moderne. Lista që mund të fillonte me Eskilin, për të kaluar në shekullin XIX me Anthony Throllop e për të vijuar me *Ushtarin e mirë Shvejk* të Jaroslav Hašek, pasurohet edhe me "Esetë" e Montaigne, shkruar me angazhim publik e qytetar shekuj më herët se të lindte termi "letërsi e angazhuar".

Duke u kthyer pas në kohë sjell në vëmendje se ishin vetë shkrimtarët e shekullit XX ata që kërkuan ta veshin me qëllime veprën e tyre dhe të shtronin pyetjet nëse një vepër letrare duhet të jetë e dobishme (?) e nëse po, kujt duhet t'i shërbej kjo vepër(?).

Letërsia e angazhuar gjatë shekullit XX nuk ishte dhe as nuk mbeti thjesht një term. Ajo u realizua si një lëvizje, që kishte lindur në formë kundërvënieje ndaj autorëve të shekullit të XIX dhe fillimit të shekullit XX, të cilët e shihnin botën të distancuar kur vinte çështja e përballjes "realitet – art". Ata nuk përfshiheshin fort në shoqëri, duke pëlqyer të mbeteshin "magjistarë të fjalës" apo "dëshmitarët me status të privilegjuar" artistik.

Qasja e tyre u braktis, sidomos me fillimin e Luftës së Parë botërore, duke e zhvendosur shkrimtarin drejt zhytjes në realitet, duke e përfshirë atë në "valët dhe vorbullat e jetës" dhe duke e nxitur të mbajë një qëndrim të caktuar dhe haptazi moral e publik lidhur me atë që ndodhte në shoqëri. Mbeti pak vend për mbrojtësit e veçuar të




vlerave humane dhe estetike, të cilët besonin se arti do ta shpëtonte botën. Mbeti pak hapësirë edhe për sogjetarin e vetmuar të shpirtit njerëzor. Llogoret e luftërave ishin ato që ndanë edhe pozicionet e autorëve. Nga tërheqja në botën e shkrimeve të tyre, nga kujdesi për të skalitur personazhet e vet, shkrimtarët e shekullit XX kaluan në aktivizëm qytetar dhe në përfshirjen publike mes njerëzve.

Lëvizjet për art të angazhuar kishin marrë nxitje edhe prej mendimtarëve, të cilët e plotësuan aktivizmin me mendim filozofik. Formalizmi, fenomenologjia, ekzistencializmi, strukturalizmi dhe poststrukturalizmi i dhanë shpjegim dhe baza teorike veprimit që kishte nisur ndërkohë.

Por nëse do të duhej që kronologjinë e kësaj forme të letërsisë ta fillonim me një emër, ndër më të parët do të ishte ai Jean-Paul Sartre. Ky autor ringjalli idenë e përgjegjësisë së madhe dhe thellësisht serioze që merr mbi vete shkrimtari ndaj shoqërisë në të cilën bën pjesë. Përgjegjësia e shkrimtarit, sipas tij, mund të merrej në kuptimin e ngushtë, si angazhim i një pjesëtari të një kulture të caktuar, por edhe si angazhim ndaj forme të zhvillimit të qytetërimit në përgjithësi. Kjo, pasi pyetjes retorike se "Çfarë është letërsia?", Sartre i përgjigjet me fjalët se letërsia na hedh e përfshin në betejë dhe se të shkruarit është një mënyrë për ta dashuruar lirinë…", por nga ana tjetër ai nuk e pranon mendimin e shpirtrave ushtarakë, duke kundërshtuar se *littérature engagée* është realizmi i vjetër socialist, nëse nuk është një ringjallje e populizmit, vetëm se më agresiv.

Lidhur me konceptin e letërsisë së angazhuar dhe, duke qartësuar pikëpamjet e tij mbi marrëdhëniet midis letërsisë dhe politikës e më gjerë, Jean-Paul Sartre, në tekstin shoqërues të *Les Temps Modernes* (1945), të cilin e shfrytëzoi për t'u shprehur ndaj *littérature engagée*, qortoi Marcel Proust për vetë-përfshirje të tepruar në tekst. Angazhimi i sugjeruar nga Sartre kuptohej si një sfidë morale dhe individuale e tij. Ky qëndrim përfshinte përgjegjësitë që merr autori, përshtatjen e sjelljeve publike që bën ai, përfshi këtu edhe format e shfaqjes së angazhimit, që nga pjesëmarrja në partitë politike e deri në drejtimin e shtypit, gazetave e revistave etj.

Më shumë sesa rekrutim apo rreshtim në formacione politike, bëhej fjalë për zgjedhjen e lirë të tij apo marrja e një qëndrimi për çështje të ndryshme politike. Por ajo që erdhi si produkt i asaj sjelljeje ishin qëllimet me dobi shoqërore. Angazhimi në letërsi, bënte fjalë për një kërkesë, një parim dhe një qëndrim. Është shkrimtari ai që vetëpërcaktohet, duke e ndjerë veten pjesë të një angazhimi në mënyrë të vullnetshme. Përveç Sartre, shekulli XX solli emra të tjerë të letërsisë së angazhuar, si George Orwell, që shkroi romane kritikë mbi regjimet totalitare, Eugene Ionesco që, përmes figurës së rinoqerontit krijoi metaforën e totalitarizmit dhe përshkallëzimin e fashizmit në Europë, Albert Camus, që mbajti qëndrime të hapura ndaj konfliktit algjerian apo André Malraux, që denoncoi Luftën Civile spanjolle.

Pozicioni që zgjodhën autorët apo artistët që u përfshinë në lëvizjen për letërsi të angazhuar erdhi si në formën e një reagimi jo kundrejt diçkaje të paemërtuar, por kryesisht kundër artit për art. Formë e kësaj kundërvënieje është gjithashtu edhe shprehja kundër asaj forme arti ku artisti priret dhe ndihet më shumë i detyruar ndaj zejes letrare sesa ndaj lexuesit, komunitetit dhe shoqërisë.

Edhe letërsia shqiptare që u zhvillua pas vitit 1944 ka historinë e saj lidhur me angazhimin e arteve dhe artistit në shoqëri. Letërsisë iu kërkohej të ishte jo vetëm e angazhuar, por edhe letërsi e partishme, në shërbim të propagandës. Ky angazhim, i cilësuar si "tendenciozitet", ishte shfaqur në formë kërkese që në vitin 1947, kur një artikull i Fadejevit u botuar në "Literatura jonë". Ndër të tjera autori shprehte tezën se zor mund të gjenden artistë më tendenciozë se Balzak, Dickens apo dhe Mark Twain, të cilët e "demaskuan kapitalizmën", qoftë përmes mendimeve të vetë autorëve apo përmes



## Për letërsinë e angazhuar

Lidhur me konceptin e letërsisë së angazhuar dhe duke qartësuar pikëpamjet e tij mbi marrëdhëniet midis letërsisë dhe politikës e më gjerë, Jean-Paul Sartre, në tekstin shoqërues të Les Temps Modernes (1945), të cilin e shfrytëzoi për t'u shprehur ndaj littérature engagée, qortoi Marcel Proust për vetëpërfshirje të tepruar në tekst. Angazhimi i sugjeruar nga Sartre kuptohej si një sfidë morale dhe individuale e tij. Ky qëndrim përfshinte përgjegjësitë që merr autori, përshtatjen e sjelljeve publike që bën ai, përfshi këtu edhe format e shfaqjes së angazhimit, që nga pjesëmarrja në partitë politike e deri në drejtimin e shtypit, gazetave e revistave etj.

## Letërsia shqiptare pas vitit 1944

Edhe letërsia shqiptare që u zhvillua pas vitit 1944 ka historinë e saj lidhur me angazhimin e arteve dhe artistit në shoqëri. Letërsisë i kërkohej të ishte jo vetëm e angazhuar, por edhe letërsi e partishme, në shërbim të propagandës. Ky angazhim, i cilësuar si "tendenciozitet", ishte shfaqur në formë kërkese që në vitin 1947, kur një artikull i Fadejevit u botuar në "Literatura jonë". Ndër të tjera autori shprehte tezën se zor mund të gjenden artistë më tendenciozë se Balzak, Dickens apo dhe Mark Twain, të cilët e "demaskuan kapitalizmin", qoftë përmes mendimeve të vetë autorëve apo përmes fjalëve të personazheve të tyre. Në këtë këndvështrim letërsia shqiptare e atyre viteve trajtohet si një armë ideologjike, ndërkohë që dhe autorët mbeteshin thjesht militantë.



**...NGA NUMRI I SHKUAR**

"Milosao" e këtij numri ishte relativisht e mirë. Shkrimi kryesor iu la Aleksandër Pavloviç, profesorit të ri nga Beogradi, i cili na solli një krijim të mrekullueshëm politiko-sociologjik se çfarë në të vërtetë duhet të marrin francezët dhe gjermanët nga shqiptarët dhe serbët. Autori është pedagog në universitetin e Beogradit dhe shquhet për esetë e tij tepër interesante. Arian Leka në një variant më të mirë e kishte përdorur tek "Poeteka" dhe falë tij e kishim në këtë numër.

Redaktori gjeti mundësinë e bukur dhe bëri një intervistë me kineastin e njohur polak Kryzsztof Zanussi, një nga njerëzit më të jashtëzakonshëm të këtij arti, i cili ishte në ditët e fundit në Tiranë. Ashtu si ndodh rëndom, personazhe të tilla vinë dhe largohen dhe publiku shqiptar nuk e di fare, e merr vesh shumë vonë ose është krejt indiferent. Mungesa e lajmërimeve të duhura, relativizimi i gjithçkaje dhe sidomos mungesa e hierarkisë së vlerave bëri që një nga kineastët, që mund të rrëfente shumë të largohej sikur nuk kish qenë fare. Gjithsesi, katër filma të trashëgimisë së tij të gjatë u shfaqën për publikun shqiptar. Redaktori e shijoi bisedën dhe intervistën me të.

Kreshnik Duqi, i cili vinte për herë të parë tek ne, na kish sjellë një shkrim interesant dhe rrëfente sesi përmes hulumtimeve është vërtetuar që shqiptarët kanë nxjerrë në dritë të dhëna të rëndësishme për identitetin kombëtar në muzikën e kultivuar, përmes marrëdhënieve me folklorin. Kjo gjë është vënë në dukje në periudha të rëndësishme historike, krahas përpjekjeve për një popull autonom, përpjekje të mëdha ka pasur dhe në fushën arsimore e kulturore...

Ag Apolloni, pas një kohe mungese, kish sjellë një rrëfim për Kazanxaqis. Vepra "Raport El Grekos" nuk hyn brenda kritereve zhanrore. Ajo nuk është as roman, as memoare, as ditar, as ese, as itinerar, as autobiografi, por ajo është "të gjitha nga pak". Prandaj edhe përcaktuesi kategorial që i vendoset veprës poshtë titullit, në gjuhë dhe botime të ndryshme, del ndryshe: roman, memoare, autobiografi etj. Redaktorit nuk i shkoi shumë ky realizim. E habitshme është se titulli është thjesht e mirë "Letër El Grekos". A ka një sens tjetër në Kosovë për përkthimin?!

Luan Rama ka një ndjeshmëri të lartë dhe humanizëm që e shpreh në çdo temë që parashtron. Brishtësia e ndjenjës e bën të kërkojë rrugë që ta transmetojë këtë marrëdhënie në çdo aspekt..., shkroi redaktori për ciklin me poezi të tij.

Dhe, ashtu si kemi vepruar, në këtë numër ollëm pesë punë të tjera të piktorit të njohur Maks Velo, realizuar në Paris. Punët dominuese shin nudot, por kishte edhe abstragime të tjera nga refleksionet e tij mbi veprat e klasikëve. Ndoshta redaktori duhej t'i mblidhte veç nudot, por zgjodhi një sistem eklektik, për t'i dhënë frymë krijimtarisë shumë aktive të grafistit... Ka një lirizëm "të vrazhdë", që i mbulon të gjithë peshën e angazhimit të tij të bukur, shkroi ai. Layout punoi mirë dhe paçka sikleteve të zakonshme me karakteret cirilikë ia doli mirë.

fjalëve të personazheve të tyre. Në këtë këndvështrim letërsia shqiptare e atyre viteve trajtohet si një armë ideologjike, ndërkohë që dhe autorët mbeteshin thjesht militantë. Ndaj asaj letërsie u krijuan pritshmëri shoqërore e politike, madje iu hartuan plane e u caktuan detyra konkrete, siç shihet në fletët e revistës "Literatura Jonë" në vitin 1949, në artikullin me titull "Plani dyvjeçar i shtetit dhe detyrat e Shkrimtarëve" Tridhjetë vjet më pas, në fjalimet e Enver Hoxhës *Për letërsinë dhe artin,* hidhet teza se "që të gjykohen veprat e një shkrimtari, bashkë me to duhet të gjykohet edhe aktiviteti i tij politik".

Por paradigma pro dhe kundër letërsisë së angazhuar, që nisi nga Sartre në vitin 1948 me pyetjen "ç'është letërsia" dhe që vijoi drejt viteve '50-'60 me "Nouveau Roman", duke shpallur vdekjen e angazhimit letrar, pasoi me diskursin postmodern mbi "epokën e fundeve", ku njeriu ka mbërritur "në fund të meta-rrëfimeve" (Lyotard), ku ka ardhur "fundi i historisë" (Fukuyama) si dhe "në fund të letërsisë." (Demanze, Viart).

Sot, kur njeriu i është "nënshtruar doktrinave ideologjike", duket se paradigma e formës së angazhimit letrar po rikonceptohet. Përmes eseve, poezive, teksteve nonfiction, vërehet një formë ndryshe e shfaqjes së kundërshtimit, e refuzimit kritik, që i rri disi larg formulës së angazhimit të Sartre. Por lexuesi, nga ana tjetër, së paku gjatë dekadës së parë të shekullit XXI, po dëshmon se ka më tepër etje për informacion sesa për letërsi, të angazhuar apo jo. Sidoqoftë, forma të angazhimit vërehen gjithmonë e më shumë në poezi dhe sidomos në "teatrin politik", që herë pas here e shohim të shfaqet edhe në skenat shqiptare.

Por a ka letërsia ndonjë rol a ndonjë qëllim tjetër më të lartë, përtej argëtimit?, do të pyeste Mario Vargas Llosa disa vite më parë. Për të mos e shfaqur haptazi pesimizmin lidhur me kalimin e artit thjesht në zbavitje, disa nga tekstet që botohen në këtë numër të revistës paraqesin forma të reja të angazhimit moral dhe qytetar në kontekste të tjera shoqërore, për të kundërshtuar banalitetin e së keqes dhe të keqen vetë, përmes letërsisë dhe shkrimit kushtuar idealeve që mbijetuan me shekuj, më së shumti lirisë.

L

LIBRI

*"Klik Ekspo Klik", Ministria e Kulturës, Muzeu Kombëtar dhe një sërë institucionesh të tjera krijuan një multifestival libri, si një alternativë e domosdoshme për të shtuar aktivitetet kulturore të Tiranës. Festivali "Ditë-netët e librit" ishte realisht një rikthim te magjia e letrës, në të gjitha aspektet, ku u gërshetuan këndshëm vargje, promovime, arie, skica, konkurse, përkthime, autorë të ftuar, rrëfime shkrimtarësh, sfilatë, libër e letër dhe shumë elemente të tjera ... Në një bashkëpunim të frytshëm me Ministrinë e Kulturës dhe Ministrinë e Arsimit, Bashkinë e Tiranës dhe Muzeun Kombëtar, ajo do të mbyllë sot një aktivitet që i ka kthyer Tiranës një dimension tjetër atë që lidhet me librin...*

# "Ditë-netët e librit" nis rrugëtimin drejt traditës

STAFF MILOSAO

Përgjatë katër ditëve, duke filluar nga dita e enjte dhe duke përfunduar të dielën, Klik Ekspo Klik në bashkëpunim me Ministrinë e Kulturës, Ministrinë e Arsimit, Bashkinë e Tiranës dhe Muzeun Kombëtar kanë zhvilluar me sukses aktivitetin Ditët-netët e Librit. Në pothuaj 60-70 aktivitete të zhvilluara, lektorë të ndryshëm, shkrimtarë, publicistë, njerëz të arteve figurative kanë shpalosur aktivitetin e tyre në një zhvillim model për qytetin. Muzeu Kombëtar është munduar që me infrastrukturën e vet të ndihë sa më shumë në të gjithë këtë proces, duke e përshtatur me kërkesat sipërore të Klik Ekspo Klik që ka një traditë të këndshme në krijimin e aktiviteteve të tilla.

Në këtë aktivitet, autorë si Bashkim Shehu, Stefan Çapaliku, Ledi Shamku Arian Leka, Kim Mehmeti, Çun Lajçi, Edmond Tupja, Nonda Varfi, Najada Hamza dhe shumë përkthyes dhe publicistë kanë referuar para publikut, por edhe kanë sjellë përvojat e tyre, duke dhënë sqimën e një aktiviteti të domosdoshëm për kryeqytetin. Në një gjetje shumë interesante me projeksione të ndryshme, karikaturat, letrat e dashurisë , spanjollët, ceremonia e çmimeve ilustratori më i mirë, dhe shumë aktivitete të Arkivit Qendror të Filmit, ka pasur një afrim të këndshëm për publikun, që është kureshtuar me zgjedhjen dhe realizimin. Në këtë aktivitet ka pasur një pjesëmarrje të gjerë nga Kosova, autorëve të së cilës i janë interpretuar poezi nga Ali Podrimja, Din Mehmeti, Azem Shkreli, Rexhep Hoti dhe Ismail Syla. Bashkëbisedimet e shkrimtarëve kanë tërhequr shumë publik, kurse elementë interesantë ka pasur me sfilatën "Libër & Letër" të Akademisë së Arteve nga Prof. Najada Hamza. Arian Leka realizoi me sukses një aktivitet kushtuar letërsisë ballkanike dhe njerëzve që e bëjnë atë në vendin tonë.

Një temë interesante ka zbërthyer në hullinë e saj Iris Elezi që ka folur për idenë nëse "Libri i përmirësuar nga filmi, a ndodh?". Zyrtarja është munduar të rrëfejë aportin mes librit dhe filmit, e mandej, edhe vetështndërrimit që pëson libri kur bëhet film. Drejtoresha e Arkivit Qendror Shtetëror të Filmit e ka drejtuar bisedën e saj me studentë të Artit Skenik, kritikë arti, skenaristë dhe studentë të Gjuhë-Letërsisë. Në aktivitet ka pasur një veprimtari për Kadarenë duke marrë shkas nga vargjet e proza lirike. Ndërkohë që autorët e këtij aktiviteti kanë menduar dhe për një temë interesante si libri "Dashuri në moshën e Krishtit", ku si shembull është marrë letërkëmbimi mes Dritëro dhe Sadije Agolli me temën: A ka më Letërkëmbim dashurie në moshën e "Fast-Textit"? Por gjeografia e aktivitetit ishte jashtëzakonisht e madhe dhe e larmishme.






**Seksionet kryesore ishin:**

1. **BOTIMET:**

Në këtë edicion të parë morën pjesë disa nga botuesit më në zë të vendit, të cilët përzgjodhën sezonin për të promovuar titujt dhe autorët e rinj, që e kanë bërë përmes një fushate të përbashkët, ku shumë më tepër sesa e veçanta dhe personalja, është kremtuar "Libri, leximi dhe krijimtaria" në një pamje më këndgjerë. Risia ishte se në këtë aktivitet nuk kishte pjesëmarrje vetëm nga Shqipëria por edhe prej Kosovës që ishte e pranishme, e madje dhe prej Botuesve Arbëreshë dhe të Rajonit të Puljas në një mobilizim të vërtetë të përçimit të vlerave të gjuhës dhe letërsisë shqipe në këtë vit të rëndësishëm.

2. **PARA DHE PAS LIBRIT:**

Nga njëra anë shtypshkronjat dhe tipografitë sollën teknologjitë e reja të shtypit, dhe nga ana tjetër Libraritë e Bibliotekat tradicionale apo online treguan ndikimin në hartën dhe shpejtësinë e shpërndarjes së librit më pranë lexuesit.

3. **ARSIMI:**

Nxitja e leximit, mënyrat e reja të mësimdhënies, lidhja me letërsinë dhe artet nga bankat e shkollës deri në nivelet e perfeksionimit profesional.

a) Nën kujdesin e Ministrisë së Arsimit, Shkollat e Mesme të Tiranës, ato profesionale dhe me orientim gjuhësor dhe artistik;

b) Shtëpitë botuese të teksteve shkollore propozuan titujt e rinj përkrah dhe letërsisë për fëmijë dhe adoleshentë;

c) Universiteti i Tiranës ishte i pranishëm përmes projekteve të Fakultetit të Gjuhëve të Huaja dhe atij të Gazetarisë, si Institucioni që gjeneron profesionistët e ardhshëm të përkthyesve, studiuesve, kritikëve, gazetarëve e autorëve.

d) Kompanitë vendase dhe të huaja propozuan platformat e reja të mësimdhënies dhe mësimnxënies, si shkollat audiovizuale (shembull SchoolMe Education), qendrat profesionale të kurseve të gjuhëve të huaja.

4. **EKSPOZITA:**

Hapësira kushtuar ekspozitave dhe arteve vizuale pati të dyja anët e medaljes, si ato të performimit live të ilustrimeve, kaligrafisë, animacioneve, ashtu dhe Ekspozita virtuale (përmes animacioneve), dhe Ekspozita statike dedikuar Kopertinave dhe posterave me domethënëse, Karikaturave, instalacioneve me vegla muzikore, Krijimeve për Skënderbeun parë nga këndvështrime të artistëve të ndryshëm, të rinj e të afirmuar.

Fakulteti i Arteve Pamore përshfaqi talente të rralla që ndërthurin krijimet vizuale me botën e botimeve, librit, kopertines, fonteve të germave të krijuara për herë të parë etj.

5. **SKENA MULTIMEDIALE:**

Kalendari i eventeve shoqëruese ishte i krijuar në mënyrë të tillë, që askush të mos ndihej spektator por të përjetonte në vetë të parë pasditet letrare, takim e shtrëngim duarsh me autorë e personalitete. Veprimtaritë kryesore u organizuan në Skenën multimediale në oborrin e brendshëm të Muzeut, po aq sa dhe në stendat e ekspozimit, sallat e brendshme të konferencave.

L
SHFAQJA

*Ky është një refleksion i muzikologut të njohur për një shfaqje që ka vlera historike në repertorin ndërkombëtar. Në këtë shkrim, në natyrën e zakonshme të autorit, pjesa na bëhet sa më e plotë, por na jepet edhe këndvështrimi i tij për shfaqjen, duke na treguar dhe historinë e realizimit të kësaj pjese të jashtëzakonshme...*



# Martesa e Figaros

## (Die Hochzeit Des Figaro)

NGA DR. SUL GRAGJEVI

Mu dha rasti ta shijoj edhe '*Martesen e Figaros*' në *DeVos Performance Hall* ashtu si *Don Giovannin*, dy herë, në Grand Rapids dhe Çikago.

Në Tetor të vitit 1781, *Mozarti* ishte i mërzitur përsëri me një libretist për operan. Ai arriti në Vienë në muajin Mars me shumë shpresë, me ambicje dhe me krenari për suksesin e operas së tij Idomeneo.

Në të vërtet, Mozarti ishte i punësuar te *Kryepeshkopi i Salzburgut*, por po i vinte fundi shërbimit të tij. Në moshën 25, për herë të parë ai mbetet i lirë në jetën e tij, i pavarur dhe tërësisht pa ndonjë mbështetje.

*Opera* ishte objektivi i parë i *Mozartit*. Tradita e pasur e teatrit *Vienez*, me operat *Italiane*, dramat *Frënge*, komeditë muzikore *Gjermane*, tërhoqën kohët e fundit *Perandorin Jozef* II. Si rezultat, e para opera *Vieneze e Mozartit* ishte singspieli *Gjerman* "*Die Entführung aus dem Serail*" (*Rrëmbim nga Sarajet*, 384). Çfarë thoshte *Mozarti*:" *Unë nuk di, por mendoj që në një opera poezia duhet të jetë absolutisht vajza e bindur e muzikës. Pse operat Italiane janë të suksesshme kudo – pavarësisht libreteve të dobët? .... Sepse në to muzika sundon në mënyrë supreme, dhe ju harroni çdo gjë tjetër. Natyrisht një opera do të jetë gjithmonë më e këndshme kur ajo është punuar mirë e bukur ..... gjëja më e mirë prej të gjithave është kur kompozitori, i cili kupton diçka rreth skenës dhe është i aftë të zbatojë disa nga sugjerimet, të bashkëpunojë me një poet inteligjent, ai është vërtet Feniks*..." *Ishte koha kur pas dy muajve, në javën e fundit të vitit 1781, Feniksi i vërtetë do të arrinte në Vienë. (Michael Rose, The Birth of an Opera*)

Gjithashtu, *Mozarti* shkruan:" ... *Konti Rosenberg i Princit Galicin (drejtor i oborrit të teatrove) foli me mua dhe më sugjeroi që unë duhet të shkruaj një opera Italiane. Unë isha gati për tekstin e aranxhuar të operas buffa nga Italia por ende nuk e kisha marrë në dorë .... Disa këngëtarë Italianë do të vijnë këtu për Pashkët* ..." por *Mozarti* nuk ishte i sigurt dhe për këtë ai kishte një ide për një tjetër *libret Gjerman*. Në fakt, *opera buffa Italiane* filloi përsëri dhe ajo ishte shumë popullore. *Mozarti* kaloi në dorë *njëqind librete*, ndoshta edhe më shumë, por praktikisht asnjë nuk e kënaqi. Do të ishte më mirë e më lehtë, siç pretendonte vetë Mozarti, që të gjendej një poet i cili do ta ndihmonte atë që të shkruante diçka komplete të re. "*Poeti ynë është këtu, padyshim, Abbate Da Ponte"* theksonte *Mozarti, "ai filloi një punë të rëndësishme në rishikimin e pjesëve për teatrin dhe duhet të shkruante 'per obbligo' një libret tërësisht të ri për Salierin. Ai më premtoi se pasi ta përfundonte këtë, do të shkruante një të ri për mua. Por nuk jam i sigurt nëse do të jetë i aftë të mbajë fjalën ose a do të ketë dëshirë. Por, megjithatë, në qoftëse ai është i lidhur me Salierin, unë kurrë nuk do të marrë gjë prej tij*". Ishte *ndikimi i Salierit* që ishte siguruar pozicioni i poetit për kompaninë e re *Italiane* drejtori i së cilës e donte *Da Ponten*. Por *Mozarti* e shihte gjithmonë me dyshim të madh *Salierin* dhe se pozitën e tij në *Vienë* e shihte të frikshme dhe të pafavorshme. *Da Ponte* shumë shpejt afrohet me *Mozartin* dhe bëhet libretisti i tij më i rëndësishëm, libretisti i tri operave, '*Don Giovanni*' 527, '*Martesa e Figaros*' 492 dhe '*Cosi fan tutte*' 588 (*Kështu bëjnë të gjitha*) Për të dytën, *Perandori Jozef* II thoshte që :" *e kuptoj se komedia e njohur 'Martesa e Figaros' ishte propozuar në përkthimin gjermanisht për Kärntnerthor Theater të Vienës. Meqenëse kjo pjesë është tepër ofenduese, e pakëndshme, unë e pranoj që censori do ta refuzojë ose do të kërkojë të bëhet ndryshim që të mos mbaj përgjegjësi për atë performancë dhe për ndikimin ndaj publikut*". Mirëpo, *Franc Niemeçek, mik i Mozartit* dhe jetëshkrues Çek, thoshte se censurimi i operas së *Mozartit në Vienë* nuk do të aplikohet me të njëjtën rreptësi si për teatrin. Por *Mozarti* fatkeqësisht nuk e përmendi *Figaron* në disa *letra* të cilat mbijetuan nga periudha e kompozimit të tij, ai pati nevojë t'i shkruante libretistit të tij zyra e të cilit që ishte në *Burgtheater*, nuk qe larg tij.

Në fakt, sipas *Da Pontes*, në *Vienë* ishin dy kompozitorë që gëzonin respekt të veçantë, *Vicente Martin*, kompozitor *Spanjoll* i cili favorizohej nga *Perandori Jozef* dhe *Ëolfgang Mozart.*

*Martin* kompozoi një opera *dramma giocosso* në dy akte, "*Burbero di Buon Cuore*" me libret *Italian* të *Da Pontes* i bazuar në një komedi *Frënge të Carlo Goldonit*, "*Le burru bienfaisant*".

Megjithëse *Mozarti* ishte i pajisur me *talent* dhe qëndronte mbi të gjithë kompozitorët e tjerë në botë, ai ishte gjithmonë përballë armiqve të tij të cilët e shikonin me xhelozi si gjeniun e Vienës. Një ditë, thoshte *Da Ponte*, shkova te *Mozarti* dhe e pyeta nëse kishte dëshirë të kompozonte muzikë për një dramë që mund ta shkruaj për të. "*Unë fillova të mendoj për zgjedhjen e dy subjekteve që mund të ishin të përshtatshëm për të dy kompozitorët të cilët ndryshonin me njëri-tjetrin nga stili i kompozimit, Mozart dhe Martin*". Më në fund, *Mozarti* i kërkoi *Da Pontes* që të mund të adaptonte komedinë e *Beaumarchais*, "*Martesa e Figaros*" si *libretto.*

*Da Ponte* e pranoi *si ide* dhe *i sugjeroi* se do ta bënte për çfarë kërkonte. Në fillim ekzistonte një vështirësi që duhej kapërcyer, dhe për këtë, *Da Ponte* i sugjeroi *Mozartit* që të punonin për muzikën dhe libretin fshehurazi dhe të prisnin për një mundësi të favorshme pasi t'ia kenë treguar drejtorëve të teatrit ose madje, *edhe Perandorit.* Çdo gjë kishte përfunduar, muzika dhe teksti brenda gjashtë javësh. *Reputacioni i Mozartit* kishte filluar të rritej nga *koncertet e pianos*. Por të mos harrojmë që pa *Da Ponten* në Europë dhe në të gjithë botën, kurrë nuk do të kishim parë *tri masterpjesët* më madhështore të *Mozartit*. Është gjithashtu e qartë, se *Da Ponte* në vitet e mëvonshme luajti një *rol të* rëndësishëm në jetën e Mozartit.

Reputacioni subversiv i "*Martesës së Figaros*" (*Le mariage de Figaro*) ishte në një masë të madhe një produkt i kohës politikisht të paqëndrueshme në të cilën shfaqej. Thelbi i vërtetë i *dramës*, më tepër është *social* sesa *satirë politike* rreth të cilës *Beaumarchais* shkroi komedinë komplekse, zbavitëse, një përzierje e komedisë, romancës dhe e kritikës së fuqishme sociale, për të cilën ishte e domosdoshme të bëhej një *libret i realizueshëm.* Babai i *Mozartit, Leopold*, jetonte *me të birin* në *Vienë* deri nga fundi i Prillit (1785) dhe nuk dinte asgjë rreth projektit që kish lënë, dhe në një letër që kish marrë nga i biri nga mezi i Shtatorit, nuk përmendej asnjë fjalë për një opera ndërsa *I burbero di Buon Cuore*, nuk u shfaq deri në Janarin e vitit 1786. Megjithatë, *Mozarti* u përqëndrua në muzikën e operas dhe se roli i tij ishte në fakt i jashtëzakonshëm ashtu si i vetë libretistit. *Da Ponte* e njihte mirë opinionin e *Mozartit* dhe thoshte se ky, e di që *suksesi i operas* varet në radhë të parë NGA POETI: që pa një *poemë të bukur*, një argëtim nuk mund të jetë *përsosurisht dramatik*.




Një kompozitor në lidhje me *dramën*, sipas *Da Pontes*, ashtu si një *piktor me ngjyrat*, kurrë nuk mund të fitojë efektet që kërkon, po t'mos i gjallërojë *fjalët e poetit* që kanë të bëjnë me *subjektin, karakteret, me anën komike*, të shkruaj *recitativ të shkurtër* e me *substancë*. Kështu, *figurat* e *komedisë së Beaumarchais* të ri-projektuara në mënyrën më të përsosur nga *Da Ponte*, morën nga duart e *Mozartit* krejtësisht një *dimension të ri*.

*Mozarti* dhe *Da Ponte* nisën të shkruajnë *komedinë* më të gjatë e më të ndërlikuar deri atëhere.

*Don Giovanni* ishte opera madhështore, *Cosi fan tutte* ishte më e sofistikuar, *Flauti Magjik* ishte krejtësisht diçka tjetër, pas të qeshurit, nuk ka *opera më humane* se '*Martesa e Figaros*'. *Tre këngëtarë* të njohur në *Vienë* që kishin kënduar në operan e *Paisiellos në Vienë*, një vit më parë, ishin *Nancy Storace, Francesco Benucci* dhe *Maria Mandini. Luisa Laschi*, një soprano *Italiane* e re ishte duartrokitur si *Rozina* në operan e *Paisiellos* dhe *ri-dalja* e saj si *Kontesha*, premtonte për një sukses në vazhdimësi për të njëjtën *audiencë*.

Të dy, *Francesco Benuci* (për të cilin Mozarti kish një opinion të lartë) dhe *Stefano Mandini* ishin me përvojë dhe *Jozefi* II i kishte tërhequr për kompaninë e tij origjinale të vitit 1783, bashkë me tenorin *Michael Kelly* dhe *sopranon Angleze, Nancy Storace*. Një kronikë-mbajtës, *Johann Pezzl* shkruante që "*interpretuesit në opera janë zgjedhur me kujdes dhe të paguar mirë. Mandini dhe Benucci janë dy aktorë buffo të përkryer*".

*Storace* ishte *Susanna* e parë e njohur në atë rol si *soprano-soubrette* e audiencës së *operas buffa* ndërsa *Francesco Bussani* ishte një *bass* me përvojë që këndoi në rolin e *Don Bartolo*'s, një rol i afërm në traditat e *operas buffa. Bartolo*, në fakt, ka qenë roli *komik* në '*Berberin*' e *Paisielos*.

*Stefano Mandini*, luajti rolin e vështirë të *Kontit*, por që këndoi si *tenor* në rolin e *Almaviva*'s te opera e *Paisiellos* dhe tani e përsëriti atë rol si një *bariton* i *Mozartit.*

Aria e *Figaros* "*Non piu andrai*" u kёndua nga *Francesco Benucci*, *bass-bariton*, gjallërisht dhe me zë të fuqishëm ndërsa *Mozarti, sotto voce*, thoshte, *Bravo*! *Bravo*! *Benucci* dhe, kur *Benucci* iu afrua pasazhit të bukur "*Cherubino, alla vittoria, alla gloria militar*", efekti arriti maksimumin për të gjithë interpretuesit dhe orkestren, në thirrjet: *Bravo*! *Bravo*! *Maestro. Viva, viva grande Mozart.* Ndërsa *seksteti* ishte pjesa favorit e operas për *Mozartin.* Babai i *Mozartit, Leopold*, i shkruante të bijës *Nannerl*: " *Sot, opera e vëllait tënd "Le nozze di Figaro" do të shfaqet për herë të parë. Do të ishte një surprizë në qoftëse do të ishte një sukses dhe e di që intrigat e fuqishme do të renditen kundër saj. Salieri dhe të gjithë mbështetësit e tij do të lëvizin përsëri qiellin dhe tokën për ta poshtëruar atë. Herr dhe Mme Duschek më thanë pak kohë më parë që kjo është për arsye të reputacionit të madh të vëllait tënd dhe talentit, aftësisë së jashtëzakonshme të tij*". Opera u bë një nga më të suksesshmet e *Mozartit,* një *komedi* thellësisht

humane, *'Martesa e Figaros'* është një martesë e shquar e *muzikës së Mozartit*, në kulmin e gjenisë së tij dhe me një nga libretet më të mirë të shkruar ndonjëherë. *Uvertura* e kësaj opere është shumë popullore, në *tonalitetin* Re *maxhor* e në tempon '*presto*' dhe ekzekutohet shumë shpesh si pjesë *koncertale* e veçuar nga opera. *Premiera* e operas u bë në *Burgtheater* të *Vienës* më 1 Maj 1786 duke fituar një popullaritet shumë të madh. Opera u dirigjua nga *vetë Mozarti* prej pianos. *Martesa e Figaros* arriti një *triumf* të madh *në Pragë* në Dhjetorin e vitit 1786 që ishte në të njëjtën kohë edhe *triumfi i Mozartit në arkitekturën e operas. Ariet e operas* janë të bukura, brilante, që karakterizohen nga *emocione humori*. Në këtë *opera* buffa me një libret dëfryes, *karakteret* janë *persona disa dimensionalë* falë *depërtimit psikologjik të Mozarti*t dhe muzikës së tij gjeniale. '*Le Nozze di Figaro*' është sot ndër operat më të frekuentuara në botë. *Figaro i Mozartit* nuk është fantastik dhe ëndërrues si *Flauti Magjik* (*Die Zauberflote*) apo si *Don Giovanni*, por një komedi e dashurisë me një ekuilibër të kënaqshëm, midis gëzimit dhe dëshpërimit, një adaptim i "*Le Mariage de Figaro*" të *Beaumarchais*, i pranueshëm nga autoritetet *Vieneze* atë kohë. "*Asnjë pjesë .... nuk ka shkaktuar aq sensacion sa opera Italiane e Mozartit* '*Le Nozze di Figaro*', shkruante *kritika* në '*Prager Oberpostamtszeitung*' *plot entuziazëm*, dhe pak ditë më vonë, '*ajo ende nuk është dëgjuar mjaft edhe pse teatri mbushet plot me spektatorë*'. Kur *Mozarti* u kthye në *Pragë në Shkurt*, atë e priste kontrata e re për operan tjetër '*Don Giovanni*'.

Performanca Amerikane e 'Martesës së Figaros'

Ditën e *premte*, më 4 Maj 2018 *pata rastin* të ndodhem në *DeVos Performance Hall* për të parë shfaqjen e bukur të operas '*Martesa e Figaros*' nga trupa e operas *Grand Rapids*. Performancën e dirigjoi *Maestro James Meena*, drejtor i përgjithshëm dhe dirigjent principal i *Operas Carolina* që në vitin 2000. Me një përvojë të pasur në *opera, balet, simfoni* dhe me një *vizion artistik e prezencë dinamike* në *podium*, sot është *drejtor artistik* i operas në *Grand Rapids. Maestro Meena* ka bashkëpunuar si *asistent dirigjent* te dirigjenti i njohur Anglez *Andre Previn*, dhe *Gunther Schuller, Michael Thomas, Anton Guadagno* dhe *Anton Coppola.* Gjatë gjithë kohës së operas, *Maestro Meena* dirigjoi me kompetencë orkestren, solistët dhe korin duke i mbajtur në një balancë të përsosur. *Orkestra na dha një zë të freskët, transparent dhe me shkëlqim Mozartian.* Në rolin e *Figaros* këndoi *bass-baritoni Jozef Barron* të cilin *Anthony Tommasini i Neë York Times*, e quajti "*vokalisht robust*". Interpretimi i tij ishte atë mbrëmje i përsosur. *Mr. Barron* ka kënduar në të gjitha '*operat house*' Amerikane, në Montreal, dhe në operat e Verdit, Puccinit, Çajkovskit, Wagnerit, Straussit, nëpër *Europë*. Interpretimi i *aries* së njohur, '*Non piu andrai*' ishte i përsosur. Ai ishte mjeshtër në rolin e *Figaros*, një *characterful Figaro.*

Në rolin e *Suzanës* interpretoi *soprano e re Italiane, Raffaella Di Caprio*, e diplomuar në *Konservatorin e Muzikës Domenico Cima-*

→ Vijon në faqen 20

T

TREGIM

# I dënuar me liri

*Dy rrëfime të mrekullueshme, të realizuara teknikisht shumë mirë, që përmbledhin brenda pak rreshtave shumë nga metamorfozat shqiptare të dekadave të fundit... Do ta mirëpresim sërish autorin*



NGA FARUK MYRTAJ

Kishte ndodhur përmbysja e radhës por ne, dëshmitarë të përmbysjeve të mëhershme, rrinim përsëri bashkë.

Një pedagog autoritar i ideologjisë së qeverisë së saporrëzuar, kryeredaktori i gazetës së pakicës që sapo kishte fituar shumicën, shkrimtari që duke qeshur thoshte se kurrë s'kishte lidhur ndonjë kontratë me popullin që të ishte edhe njeri i mirë, uleshim aty, tek majëkodra prej ku dukej si në pëllëmbë të dorës Sheshi i Lirisë, me Monumentin e Heroit Kombëtar në mes, dhe përpiqeshim të bënim sa më shumë gallatë me atë që thuhej se ndodhte. Në të vërtetë, edhe kushdo tjetër që ishte i ngeshëm, mund të vinte të ulej me ne, të pinte një birrë falas nga më i Kamuri i Kryeqytetit, që ishte i sigurtë se ai do të mbetej më i pasuri, edhe më tej, pra kushdo aty mund të gëzohej për çfarë kishte ndodhur. I vetmi kusht, vendosur nga pronari i lokalit aty, ishte të mos ndërprisnim tjetrin që fliste dhe të mos ngrinim zërin...

Atë pasdite ishte njoftuar një tjetër Miting i Madh i Opozitës së Gjerë. Asnjeri nga ne s'kishte ndërmend të shkonte.

Atje tej, në rrugë, siç e prisja, u duk të nxitonte ai. Ishte Qaniu. Qani Delvina, ish-i burgosuri politik që unë e doja shumë.

Unë e dija, por edhe të tjerët në atë tavolinë verore aty në anërrugë, e kishin dëgjuar nga unë që Qaniu më në fund ishte njeri i lirë. As që ia vlente për të të përmendnim se për 22 vjet me radhë ai kishte qenë në burg. Madje, asnjë keqardhje nuk pranonte Qaniu që, pas atyre 22 vjetëve burg, pikërisht ai, në pushtetin që erdhi më pas, ai të punonte në përgatitje betoni.

"Për ku me kaq ngut, Qani?"

"Për ku tjetër?! Atje e mbaj frymën unë!"

"Hajde merre një lëng të ftohtë, më parë...të lutem!"

"Të më falni, por s'dua të vonohem...Po të jeni aty, kur të kthehem, vij edhe unë..."

Nuk na e merrte për të keq, që ai shkonte atje dhe ne nuk bashkoheshim me të.

"Nuk ka nevojë të ta kujtoj përsëri se...?!"- bëra ta ngacmoja unë.

"Jo jo...! E di unë ç'do më thuash. Por të gjithë ju aty duhet të ma kujtoni se edhe për 14 vjet, dy muaj e trembëdhjetë ditë të tjera nga sot, unë do isha akoma në burg. Nisën këto mitingje, që dola para kohe unë..."

Qaniu e dinte se në këto mitingje e merrnin fjalën njerëz asnjeri prej të cilëve nuk kishte qenë në burg me të. Në 22 vitet e burgjeve të tij ata s'dinin fare që në këtë vend kishte burgje, dilnin edhe në Evropë, por Qaniu s'e kishte problem lirinë e tyre dikur. As donte të dëgjonte këto gjëra. S'kishin të bënin me të. E rëndësishme ishte që ai vetë, tashmë, ishte i lirë.

"Vërtet punoj në përgatitje betoni, por pasi mbaroj punë kthehem në shtëpinë time, jo në birucë...!"

"Po ata ..."

"Ç'punë kam unë me ata. Ata janë në tribunë, për qejfin e tyre, ata. Unë jam atje poshtë, në sheshin e madh...Vetëm atje, në mes asaj turme që gjëmon e buçet, jam edhe unë. Shaj sa dua e kë s'dua, e ngre zërin në kupë të qiellit, më mrekullon idea se nuk më përgjon kush dhe që s'do t'ja dij njeri për mua...dhe ajo që thamë: unë mund të isha ende në burg, vëlla...!"

Qani Delvina na përshëndeti me valavitjen në ajri të dorës tërë flluka kallosh të hershme dhe bëri për nga Sheshi i Lirisë.

Nxitonte. Në tribunë ia kishin filluar fjalimeve, dhe turma atje poshtë ngazëllente.

## Këpucë për Gjyqin e Fundit

Ishte njeri nga ne që po arrinim fitues në fund të Luftës. Elham e quanin.

Në prag të më-të-fundmes betejë, të gjithë mendonim se fitore kishte qenë shumë e shtrenjtë. Dukej shkoqur për të gjithë se ne mbaheshim fitues thjesht se po dilnim gjallë nga dimri. Këtë e pranonim të gjithë, me sinqeritet, e thoshim për veten, por edhe me ndokënd që e besonim si veten. Atëbotë, s'e merrnim vesh çfarë na pengonte ta thoshim hapur, edhe pse tërë kohën ishim mes njerëzish me të cilët kishim fituar tërë ato beteja. Askush nuk na kishte porositur, aq më pak urdhëruar, të mos e flisnim çfarë ndjenim, por ne silleshim pikërisht si të tillë.

Elhami, thjesht, diçka të tillë kishte thënë. Jo me fjalë si tonat. Gjuha e tij ishte tjetër. Ku e ku më e lartme. Gabimi i tij qe se, atë që ne të tjerët e thoshim "midis nesh", Elhami e kishte thënë me zë:

"Kush e merr vesh çfarë lufte do nisim pas fitores së fundit!"

Këtë kishte thënë ai njeri, sikur të vazhdonte të na rrëfente për librat e bukur që kishte lexuar përpara se të bashkohej me Luftën. Sa herë e hapte gojën ai, e ndiqnim me sy. Ia rrëmbenim fjalën nga goja, na e bënte lodhjen ëndërr dhe përpara çdo beteje na thoshte se e kishim të fituar atë përderisa e bënim për njeriun.

Nuk e morëm vesh kurrë, se kush dhe përse ia morën për keq këto fjalët e fundit. Këto fjalë, sikur ta kishte ditur, vërtetë i mbetën të fundit...

Do t'ja kenë dëgjuar allasoj, kush e di se si, thamë ne atëbotë. Por nuk pyetëm se si e përse ia morën për të madhe.

Nuk pyetëm as kur e veçuan nga ne, në orën e fundit, përpara betejës së fundit.

Nuk ta duam luftën tënde, i thanë, u dorëzove para betejës ë fundit, disfatist, i thanë...

Më keq akoma, kalove kundër, i tha Dori I Madh. Gjyqi Ynë të Dënon me Vdekje...Në Emër të Popullit!

Vendimi kishte formën e prerë, ekzekutimi duhej kryer menjëherë, para se të niseshin për betejën e fundit, sikur vërtetë populli kërcënohej prej fjalëve të Elhamit. Akuza ishte aq e rëndë, sa Elhami nuk e hapi më gojën.

E morën, duarlidhur, e vunë përpara, në sy tonë. Fill pas tij, skuadra e pushkatimit kaloi në anën e pasme të kodrës.

Tërë ne aty, me sytë tëposhtë, vazhduam pastrimin e armëve.

Vonë fare, dikush prej dëshmitarëve mbetur gjallë, rrëfen zë-ulët se Elham Mezini përpara skuadrës së pushkatimit i kishte mbushur sytë me lotë. Sikur...s'kishte ku ta gjente një armik atë moment, të vritej prej tij...

Këto, u thanë tani së fundi. Lufta ka dekada mbaruar. Po ndodhë ripërtypja. Ka ardhur hera të pyesim nëse fituam apo humbëm. Ata që jane ende gjallë prej skuadrës së pushkatimit mbajnë mend Elhamin dhe Dorin e Madh. Të dy, për shkak të një palë këpucësh.

Elhami ishte djalë i bukur, i gjatë, i shëndetshëm...Apo s'kishte një palë sy...Për fat, atë ditë kur do t'i humbiste të gjitha, mbante veshur një palë këpucë alpine, të forta, të ngrohta, të bukura. Ia kishte falur një oficer aleat. Sapo kaluam kodrës, matanë, Dori i Madh ia kërkoi ato këpucë...

"Ti po ikën, m'i lerë mua..."

"Nuk kam për t'i dhënë ty...Çdokush tjetër le t'i mbajë..."

"Edhe pesë minuta jetë ke...", kishte këmbëngulur Dori I Madh. Që edhe më pas, gjithë jetën, bëri lart me këtë lloj këmbëngulje.

"Gjallë jo..."

"Më vjen keq se do t'i bësh pis..."

Ne të skuadrës së pushkatimit dëgjonim. I dëgjuam, të gjitha. Dori i Madh dha urdhër dhe armët tona u ngritën. E rrëzuan Elhamin...

Ata matanë kodrës, dëgjuan krismat, jo fjalët e tij këmbyer me Dorin e Madh. Ua vonuam aq shumë sa, kur ua thamë, dukej se s'i hynte në punë kurrkujt. Atë ditë, që ne u kthyem pa Elhamin, ata vazhduan pastrimin e pushkëve.

Dori i Madh u kthye pak minuta pas nesh. Në qafë, si dylbi, si medaljon lufte, varur, këpucët alpine, spërkatur lehtë me ca bubureza të kuq...

P
POEZIA

*Një poezi filozofike e poetit të njohur shqiptar, që vjen pas pak kohësh te "Milosao". Përmes vargjeve, ai tregon cinizmin e kohës dhe përballjen e një Alter Ego-ja...*

# RREFIMI I NJE TE PENDUARI

NGA FASLLI HALITI

. poemë.

Unë një labirint piramide,
Katakombi
Një lesh e li
Një turbullirë
Hapësirë plot moçale
Lartësi gjithë vakuume
Shirit me gjysma fjalësh
Kasetë
Me gjysma bisedash
Me gjysma polemikash
Debatesh
Copëza këngësh
Tingujsh
Melodish
Liqen plot cektësira
Pa kaltërsi
Pyll
Pa lisa
Plot shkurre
Plot trungje shtrembakë
Pa zogj pa bilbila
Pa lauresha
Plot derra,
Ujqër,
Pa dhelpra



***

Unë
Jam një film fragmentar
Plot të këputura copë-copë
Plot poza të djegura
Flu
Një arë
Me grurë të blertë breshke
Me kalli pa kokrra…
Kokëpërpjetë
Djerrinë
Plot gjembaçë
Plot driza dhe ferra
Unë
Mbjell
Nuk korr
Miellin e sit
Brumi vjen i kulluar
Unë s'e gatuaj s'e pjek
Shtëpinë e lë fare pa bukë
Librin e lë pa lexuar gjer në fund…
Filmin s'e ndjek
Gjer në ***end, fine, telos, kanjec…***
Fjalët e tekstit nuk i marr vesh
Nuk i kuptoj
Melodinë nuk e riprodhoj
Refrenin e mërmëris me vete
Dëshiroj shumë
Por pa arritje
Shtroj problemet
S'i zgjidh saktësisht
X y z më dalin me mbetje
Me përqindje
Në fund
Në ushtrimet algjebrike mbrëmjeve
bëj minuse
Me qëllimin furbesk
Që t'i bëj pluse
Në mëngjes
Edhe rimat s'i qëlloj
Asonancat e mia janë anemike
Ngjyrat të përzjera lla• kobalt, pink
Krijoj njolla
Si trazirë ylberi mbi asfalt
Jam indiferent ndaj halleve të kujtdo
Vëmendja ime nuk u vë veshin telasheve të njerëzve…
Mendja bën fluturime nëpër qiejtë nëpër retë
Syri im
Sheh qimen
Në syrin e tjetrit
Nuk sheh trarin në syrin e vet

***

Unë
Një automatik difektoz
Fishekët më dalin të pazbrazur
Unë
Një orë e çakërdisur
Herë shkoj para
Herë prapa
Herë
S'punoj fare
Më mërzitet koha e mërzitur
Ndaj e lë të ikë si pelë e azdisur

***

Unë
Tren
Pa trenistë
Dal nga shinat
Çaj mes baltrave
S'i duroj dot shinat
Më mërzitin paralelet
Të cilat s'takohen kurrë
Kujtesa ime një usb boshe
Kompjuter me plot mishmash
Me një stivë mbresash imcake
Me cirkovolucione të përgjumura
Tru smirëzi
Dhëmbë
•atallë smeril
Hakmarrës i serta
I cili nuk fshihen dot
Me gomën e pendesës
Idhnak intolerant ekstremist i marrë
Vadis gjembaçin shkul zambakun e bardhë

***

Pështyj
Dhe lëpij të pështyrat
Fshij pikën e vesës në fytyrën e tjetrit
Lë pështymën e tjetrit në faqen time
Unë përtyp qelbësira të vjetra e të reja
Ha turpin me bukë,
Me bukë bajate
Pi në burim
Turbulluar
Nga unë
Vetë
Vdekjet
S'më hidhërojnë
Lindjet s'më gëzojnë
Nuk vete për ngushëllim
Në vakira s'qaj
Nuk vajtoj
Në dasma
Nuk këndoj
Mbaj vetëm iso
Nuk kërcej nuk vallëzoj…

***

Ha dhe mbetem i uritur
Pi dhe mbetem i etur
Si Tantali
Suksesi
I tjetrit
Më pikëllon
Më vret veshin
Pres me padurim
Dështimet falimentimet
Afishimet mbi xham: «Dyqani mbyllet!»
Flas vetëm për të djeshmen
Për të sotmen heshtje
Goja
Ky•ur
Të ardhme
Të nesërmes
S 'ia vë fare veshin
Më mbetet koka duke pas
Rri me sy
Nga e djeshmja
Më pushton nostalgjia
Dashuria
S'më
Prek fare
Errësira më qetëson
Drita më vret sytë më verbon
Shoh si lakuriqi me veshë dëgjoj me sy
Akullin dhe avullin i kam miq
Me ujin jam në mëri në gjak
Unë digjem nga etja
Ai s'ma shuan
Buzën
S'ma lag

***

Unë
Hidrofob i tërbuar
Unë u thur himne torfës
Kënetave me ujë verdhanë
Selekëve të mbuluar me fier
Kallamave me idile puhish fine
Ujin e poshtëroj
Laj këmbët
Laj rrobat me njolla vaji të zi
Shaj lumin që shuan etjen e blerimit…
I marr lirinë ajrit dhe erës
I burgos në bombola
Në goma makinash
Shaj Oqeanet
S'i shoh dot
Gjerësitë, gjatësitë, thellësitë e tyre përpirëse
Pellgjeve u përkulem me reverancë
Rrëkeve iu mbaj ison pa tinguj
Laj sytë me sklepa burimeve
Kafshimi më ngop
Puthja e buzëve
Vishnjë qershi
Neveri
Tres
Vesën
Për plumba
Shes ndërgjegjen
Pa më vrarë ndërgjegjja
Tall
Trimërinë
Përkëdhel frikën
Dashuria më hap krahët me dashuri
Unë e përqafoj me urrejtje
Kush më bëri
Mua kështu:
Unë s'jam krijues
Mua më bëri dikush
Po kush më bëri
Ju
Jeta
Shoqëria…

Apo më krijoi vetë Zoti, Perëndia...?

*1996 - 2017*

Vijon nga faqja 19

# Martesa e Figaros

*rosa* në *Avellino.* Ajo ishte gjithashtu finaliste në *Konkursin Leoncavallo* në *Potenza* më 2009 dhe fituese e Konkursit '*Esecuzione Musicale*' citta di *Eboli.*

Si *Suzana*, ajo ishte *karakteri kyç*, merr pjesë kudo. Në *aktin e parë* ajo këndon në *tre duete* nga të cilët, dy me *Figaron*, dhe një me *Marcelinen* ("*Via resti servita, madama brilante*") duke na dhënë një pasqyrë të qartë të *karakterit* të saj, plot gjallëri, lozonjare, por tërësisht *besnike e Figaros*. Përveç kësaj, është një *trio* e kënduar nga *Suzana, Konti* dhe *Basilio* ('*Cosa sento! tosto andate*') kur *Konti* zbulon *Cherubinon* në fshehtësi. Të *tre karakteret* janë *portretizuar me muzikë* ndërsa në aktin e tretë është *seksteti i famshëm*, *Suzana, Marcellina, Don Curzio, Konti, Bartolo* dhe *Figaro*, "*Riconosci in questo amplesso*" në të cilin *Figaro* zbulohet të jetë i biri i *Marcelinës* dhe i *Bartolos.* Këtu *Mozarti* portretizon përsëri *emocione* të ndryshme, bashkimi i prindërve me të birin dhe nga ana tjetër, *Konti* i zemëruar. *Finalet e operas* janë të ndërtuara në mënyrën më të përsosur në të cilat *orkestra ngarkohet me përpunimin simfonik të motiveve.* Edhe *kolegu i dirigjentit*, *drejtori i skenës*, *Garnett Bruce* solli vlera të larta në produksionin e operas dhe integritetin artistëve solistë në skenën e '*Figaros*'.

***Në Festivalin e Salzburgut***, 2006, e dirigjoi operan *Nikolaus Harnoncourt* në një performancë të bukur. *Anna Netrebko* ishte një *Suzana* e jashtëzakonshme dhe *Christine Schäfer* në një interpretim të shquar të *Cherubinos* ndërsa *Ildebrando D'Arcangelo* ishte një *Figaro* i përsosur, si gjithmonë, një *artist* i *skenës së Mozartit.*

Babai i *Mozartit, Leopold*, ishte i ngazëlluar dhe pas *suksesit të Pragës*, i shkruante të bijës *Nannerl*: "*Opera e vëllait tënd u shfaq me një sukses të paparë*" *Mozarti*: "*E pashë me kënaqësi absolute, si të gjithë njerëzit, me një kënaqësi evidente për muzikën e Figaros tim. Të mërkurë do të shkoj ta shoh e ta dëgjoj Figaron, në qoftëse nuk do të bëhem i shurdhër dhe i verbër .... Por tani asgjë tjetër për Figaron*".

***Dr. Sul Gragjevi, kritik muzike**



## "Maqedonia Ilindenase" ja emri i ri i shtetit fqinj

Kryeministri Zoran Zaev pas takimit me liderët e partive politike dhe krerëve shtetëror ka theksuar se opsioni dhe emri i propozuar që mund të jetë kompromis me Greqinë është "Republic of Ilinden Macedonia" apo në shqip siç e citoi edhe ai "Republika Ilindenase e Maqedonisë", shkruajnë mediat maqedonase.
Zaev tha se ky propozim do të thotë vazhdimësi historike e shtetit dhe të ardhmes së ndritur. *"Me këtë e forcojmë identitetin tonë maqedonas dhe të gjitha etnitetevе që jetojnë në Maqedoni"*, theksoi Zaev. Sipas tij, emri i gjuhës do të njihet si *"macedonian – maqedonas"* dhe identiteti po ashtu do të jetë i njejtë.



## Martohet Princ Harry, ceremonia në Windsor

Princi Harry dhe Meghan Markle janë shpallur burrë dhe grua, pas një ceremonie në Kështjellën Ëindsor.
Çifti shkëmbeu betimet dhe unazat përpara Mbretëreshës dhe 600 mysafirëve në Kishën e Shën Gjergjit. Meghan Markle hyri në kishë me një fustan të bardhë, elegant dhe shumë të bukur, teksa flokët i kishte të mbledhura. Kurora dhe vello i jepnin edhe më shumë hijeshi.
E teksa Harry i emocionuar e pa, i kapi dorën dhe i tha se dukej fantastike, përpara se të falenderonte babain e tij, Princin Charles, i cili e shoqëroi deri në altarin e kishës Shën Xhorxh nusen.

Opinioni i Ditës

# Çelja e negociatave dhe zhurmënaja 'Xhafaj'



Nga Fatos Çoçoli

*(vijon nga faqja 1)*

... parlamenti i këtij vendi u mblodh posaçërisht dhe të gjitha partitë politike dolën me një deklaratë të përbashkët në mbështetje të integrimit të vendit. Në tetor 2005, Parlamenti i BE-së miratoi hapjen e negociatave dhe rasti i Kroacisë përmendet si shembulli më i suksesshëm i përshpejtimit të integrimit të plotë të një vendi në Bashkimin Evropian. Një deklaratë e tillë i mungoi Shqipërisë pas 17 prillit, datës kur po Komisioni Evropian i rekomandoi Parlamentit të Bashkimit Evropian të çelte bisedimet e anëtarësimit me vendin tonë.

Në të kundërt, veprimi ndërkombëtar i opozitës kryesore të vendit po synon diskretitimin e qeverisjes së sotme, për të paraqitur pas datës 28 qershor 2018, në rast se Parlamenti Evropian e shtyn çeljen e negociatave nga mungesa e miratimit të njëzëshëm të 27 parlamenteve të vendeve anëtare, si dështim spektakolar të qeverisë së narkotrafikut tek ne. Në këtë mulli hyn edhe a ashtuquajtura "aferë (punë e pistë)" e ndërhyrjes së ministrit të Brendshëm të sotëm në mbrojtje të vëllait të tij të dënuar në Itali. Dëgjova shpjegimet e këtij ministri në konferencën për shtyp të disa ditëve më parë.

Për mua si qytetar, Fatmir Xhafaj e meriton të qëndrojë në detyrë. Pse? Sepse nuk ka shkelur ligjin. Edhe po të kishte ndërhyrë (gjë që nuk e ka bërë) në përcaktimin e nenit 491 të Kodit të Procedurës Penale, rregullim që mbron qytetarët shqiptarë që dënohen në mungesë në shtete të tjera, në bazë të nenit 6 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, vetëm do të kishte vepruar në dobi të qytetarëve të këtij vendi. Gjithçka tjetër, në mungesë të akuzave të forta për shkelje të ligjit, është zhurmënajë, fjalnajë dhe baltëhedhje që na prish shumë punë në këtë moment vendimtar për të na dhënë tani çeljen e bisedimeve të anëtarësimit me BE-në më 28 qershor 2018. Ndryshe do të vonohemi gjatë, ndoshta një vit apo dy, për arsye se shumë vende anëtare të BE-së dhe parlamentarë të tyre janë dyshues dhe mendojnë se Shqipëria është pak, në mos fare e përgatitur për të hyrë gradualisht në familjen e madhe evropiane. I tillë vend me mjaft parlamentarë të tillë është Holanda, por edhe në Francë ka mosbesim të theksuar.

Një vullnet i përbashkët politik për t'i bërë mirë Shqipërisë, i shprehur me një rezolutë të të tria partive parlamentare tek ne në mbështetje të hapave integrues të vendit, do të ndihmonte jo pak në fashitjen e mosbesimeve. Por kjo nuk po ndodh. Në të kundërt, baltosja dhe fjalnaja është shtuar. Në një bisedë që pata me një drejtues të një institucioni kryesor kushtetues, i ishte i mendimit se opozita me rastin 'Xhafaj' nuk po tregon mprehtësi dhe largpamësi. "Ministri Xhafaj është një shtetar me integritet dhe prania e tij në qeveri kushtëzon dhe frenon çdo vullnet epror për të shkelur ligjet. Ky ministër ishte nga ata të paktë që kishte kurajën të thoshte 'Jo' kur prekeshin interesat e qytetarëve. Ne kemi nevojë si ajri që thithim për institucione të forta dhe për drejtues që të dinë t'i thonë 'Jo' kryeministrit atëherë kur duhet, duke marrë përsipër edhe kosto, sidomos në fusha si drejtësia, rendi publik, financat publike, strategji afatgjata ekonomike etj.", u shpreh ky drejtues.

Zëvendësimi i zotit Xhafaj me ata që kanë vendosur shishen e qumështit në radhë do ta bëjë edhe më autokratike në vendimmarrje qeverinë. Shtyrja nga Parlamenti Evropian i bisedimeve të anëtarësimit të Shqipërisë në BE në një datë të mëvonshme nuk do të ishte një triumf i opozitës sonë ndaj kësaj qeverie, ndryshe nga sa kjo opozitë dritëshkurtër e sotme rreket të besojë, por humbje e fortë në kohë e qytetarëve shqiptarë. Dikush mund të thotë "E ç'humbim nëse ende rrimë larg kësaj Evrope plakë dhe të lodhur?". Humbim shumë, pse Polonia dyfishoi prodhimin për banor të saj nga vitit 2004 kur hyri në Bashkimin Evropian, nga 5.5 mijë euro për banor në 11.2 mijë euro që është sot. Dhe humbje të tilla mund të përkthehen lehtë në garat e ardhshme zgjedhore edhe me bjerrje të forta votash, për partitë që shpikën ose rritën lartësinë e pengesave për integrimin tonë evropian.

## HOROSKOPI

### DASHI
Lërini butësinë që të rrjedhë lirisht. Do të shërbejë për të çimentuar një lidhje të konsoliduar, ose të shkrijë ndrojtjen në një marrëdhënie të porsalindur. Do t'ju duhet të pranoni disa kompromise. Solidariteti është i barasvlershëm me suksesin e ndërmarrjeve.

### DEMI
Këtë ditë, humori i juaj është i lidhur me melankolinë, sepse planetët që nuk janë shumë në favorin e juaj. Do të keni apati dhe mungesë motivimi. Për t'ju ngushëlluar, do të keni shumë miq të sinqertë që ju mbështesin.

### BINJAKET
Me mbështetjen e shumë planetëve në harmoni, dita fillon me mbarësi. Të arrini objektivat do të jetë një lojë fëmijësh. Një takim i papritur me një mik të vjetër do të bëjë që të ndryshoni planet për mbrëmjen.

### GAFORJA
Në përgjithësi jeni të përkushtuar, por vullneti i personit që keni në krah ndërhyn për të ndryshuar gjërat, duke bërë që t'ju ndryshojë programin. Do të keni edhe zënka në çift, me grindje të lodhshme për të përcaktuar se kush do të imponojë vullnetin e vet.

### LUANI
Ditë me fat. Të ndihmuar nga bashkëpunimi i Hënës, Venusit, Marsit dhe Uranit jeni në një pozicion mbarësie. Do të ketë një shans edhe për ata që nuk pëlqejnë vetminë. Ndoshta nuk do të gjeni shpirtin binjak, por dikë që është pak a shumë ashtu.

### VIRGJERESHA
Të kapur nga doza të vogla dembelizmi është një "luks i nevojshëm", por nëse e teproni, mund të humbni të gjithë ditën dhe mund të pendoheni shumë të nesërmen. Plutoni, i cili ju mbështet prej shumë vitesh, do të vazhdojë të jetë miku i vetëm dhe i vërtetë. Ndërkaq, nuk mund të thuhet e njëjta gjë për yjet e tjera.

### PESHORJA
Ditë për t'u mbajtur mend, ku të gjithë do të jenë kundër njëri-tjetrit: ju, partneri, fëmijët, kunetërit dhe prindërit. Dhe kështu do të ketë një mori hatërmbetjesh dhe bashkëbisedime ironike. Edhe një marrëveshje ndëraksionere mund të prishet. Ju shkaktoni polemika, ndërsa të tjerët reagojnë keq.

### AKREPI
Kjo është dita ideale për të lënë mënjanë gjërat që nuk shkojnë në fushën profesionale dhe të përgatiteni për një ndryshim të qenësishëm të strategjisë ose objektivave që keni. Ndërkohë, shmangni të menduarit e gjërave shumë të mëdha dhe matini mirë mjetet dhe burimet që ju keni në dispozicion.

### SHIGJETARI
Më mirë t'i lëni gjërat ashtu siç janë, sot që planetët nuk janë shumë të favorshëm dhe ju provokojnë hapur, duke bërë që të humbisni kohë të çmuar. Është e vërtetë që jeni jashtëzakonisht të duruar, por çdo gjë ka një kufi.

### BRICJAPI
Pozicioni negativ i Uranit mund t'ju shtyjë të merrni vendime të papritura dhe të bëni ndryshime të rastit. Pa u shqetësuar, jepini zgjidhje të prerë situatave të ndryshme. Nisur nga pozicioni i Marsit, bëni kujdes ndaj ndonjë shqetësimi të shkaktuar nga vrulli i tepërt.

### UJORI
Do të jetë një ditë emocionuese dhe me shumë zhvillime. Yjet ju shtyjnë që të dilni, të takoni njerëz të rinj, të argëtoheni dhe të zbuloni botën e kulturës. Është ditë ideale për të organizuar një udhëtim, qoftë për punë, qoftë për kënaqësi.

### PESHQIT
Sot do t'ju duhet të përshpejtoni gjërat, sidomos nëse fitimi vjen menjëherë. Bëni kujdes me shpenzimet, pasi do të keni dëshirë të kryeni shumë blerje sot. Megjithatë, nëse vendosni të bëni blerje të mëdha, tregohuni të zgjuar në zgjedhje.

Fjalimi i Ditës

# Populistët në Itali, me një kontratë për qeverinë e ndryshimit

Nga Vasil Kureta

(vijon nga faqja 1)



... e dy partive që arritën rezultate më të larta në zgjedhjet e fundit, pra "Lëvizja 5 yjet" dhe "Lega Nord", Di Maio dhe Salvini i dhanë dorën e fundit programit të qeverisë së re, që në mënyrë domethënëse e kanë cilësuar: qeveria e ndryshimit. Zhvillimet në Itali dhe ky hap i ri, ku populistët vijnë në qeverisje, shënon një ndryshim shumë të rëndësishëm, që pritet të reflektojë në shumë drejtime, brenda Italisë, por sidomos brenda BE, ecurinë e të ardhmes së projektit europian dhe BE, por që mendohet të ketë ndikim edhe në zhvillimet në rajonin tonë dhe marrëdhëniet dypalëshe mes vendeve tona. Italia është një aleat strategjik i Shqipërisë, mbështetëse e vendosur dhe konstruktive në rrugëtimin drejt integrimit europian, ku jetojnë një numër i konsiderueshëm bashkatdhetarësh tanë.

Pse populistët arritën të fitojnë zgjedhjet në Itali, është një pyetje e ligjshme e jo pa vend e as një rastësi e thjeshtë. Në një farë mënyre është shfaqje apo pasojë e një problematike komplekse ekonomike, politike, sociale, që përjetohet brenda hapësirës së BE, ku veçantitë janë të dukshme në vendet konkrete. Është e kuptueshme në këtë kontekst, efekti i madh i krizës botërore e financiare, që me të drejtë u krahasua me depresionin e madh. Për shkak të një problematike të tillë, ka vite që në hapësirën e BE evidentohen dallgë tepër të larta të nacionalizmit, populizmit e euroskeptizmit, por edhe një konsumim shterues i partive të vjetra tradicionale, mbështetëse të projektit europian, që rrezikuan e konsumuan seriozisht qetësinë e qenien në qeverisje të tyre. Trysnia ndaj qeverisjes së këtyre partive erdhi duke u rritur ndjeshëm, duke u shndërruar në kërcënim real, por edhe në një disfatë të tyre.

Shfaqjet konkrete të prirjeve, koncepteve e qëndrimeve me natyrë nacionaliste apo të tërheqjes nga interesat e shtetit-komb, u konstatuan ndjeshëm sidomos në disa ish-vende socialiste të Europës Lindore, që sollën opsione e qëndrime kundërshtuese ndaj zgjidhjeve që u ofruan, në përballimin e krizës së refugjatëve, që udhëhiqeshin nga filozofia e sistemi i vlerave, që përbën bazamentin e projektit europian, e modelit perëndimor të zhvillimit. Opsionet që erdhën nga ato vende e qëndrimet kundërshtuese, anonin nga mbyllja drejt interesave të shtetit-komb dhe nuk udhëhiqeshin nga sistemi i vlerave. U duk se kjo shfaqje ishte e lokalizuar në atë hapësirë, por në të vërtetë prirjet nacionaliste e populiste apo konceptet e opsionet konkrete të tyre u shfaqën dukshëm edhe në programet politike e elektorale e veprimtarinë konkrete politike të partive populiste në gjithë hapësirën e BE, madje edhe në vendet bazament të projektit europian, Francë e Gjermani. Partitë populiste dhe euroskeptike u bënë kërcënim real për të ardhur në pushtet. Ky kërcënim në Francë u përballua me atë që mund të quhet "fenomeni Macron", por edhe fitorja në Gjermani nga partia e drejtuar nga Merkel, i thanë 'Jo' ardhjes në qeverisje të populistëve në këto vende të rëndësishme perëndimore. Në Itali qeveria "Xhentiloni", që erdhi pas dorëheqjes së Rencit, u shfaq shumë serioze e produktive, sfiduese e shumë problemeve të vështira të krizës, që solli qëndrueshmëri e rritje ekonomike, por që nuk mjaftoi që qytetarët të besonin te vazhdimësia dhe dizenjuan ndryshimin.

Një problematikë komplekse ekonomike e sociale dhe një goditje e rëndë nga kriza e refugjatëve, korrupsioni etj., në Itali kishte ushqyer e mbjellë shumë pakënaqësi e mosbesim ndaj partive të vjetra tradicionale, kishte prodhuar shumë pakënaqësi e pesimizëm ndaj mënyrës së qeverisjes. Populistët italianë e shfrytëzuan mirë këtë situatë, duke bërë problem diskutimi atë rreth problemesh që shqetësonin shumicën e qytetarëve dmth., çështjet e vendeve të punës e të punësimit, të nivelit e sigurisë së jetesës, të sigurisë për t'u mbrojtur nga goditjet e krimit, mafies dhe korrupsionit qeverisës, sigurisë për të ardhmen. Dhe në situata të tilla, në një rend afatshkurtër, populistët bëhen të besueshëm e të mbështetur. Në këtë situatë u zhvilluan edhe zgjedhjet nga të cilat përfituan populistët, sepse u ofruan t'i përballojnë këto shqetësime. Populistët u treguan të fokusuar te shqetësimet e mprehta dhe u treguan më të drejtpërdrejtë. Edhe pse në sondazhet e zhvilluara, qytetarët italianë kanë qenë mbështetës të projektit europian e të sistemit të vlerave, të gjendur përballë vështirësive serioze e mungesës së opsioneve bindëse te partitë e vjetra, i braktisën partitë e vjetra.

Me sa duket, klasa politike properëndimore e mbështetëse e projektit europian në Itali, nuk arriti t'u shpëtojë goditjeve e efekteve të nacionalizmit e populizmit, madje u mund nga partitë populiste, për shkak të dështimit në politikat qeverisëse e konsumimit të besimit të tyre në elektorat. Për shkak të thyerjes rëndë të besimit, ato nuk arritën dot të mbrojnë as vlerat e projektit europian, madje në një farë mënyre kanë ndihmuar avancimin e mendësive nacionaliste e populiste. Ky është një dëm shumë i madh për faktin se Italia është vend i rëndësishëm i BE, me kontribut shumë të madh në sendërtimin juridik, politik, ekonomik e organizativ të projektit europian, në historinë e avancimin të projektit europian, mbështetëse esenciale dhe shumë e vendosur e zhvillimit të BE nga pikëpamja ideore, ekonomike, financiare e politike. Populistët kishin në favor të tyre faktin se nuk ishin provuar më parë në qeverisje. Fakti që elektorati u besoi populistëve nevojën e kapërcimit të situatës, dëshmon problematikën komplekse shqetësuese në shoqërinë italiane, gjerësinë e shtrirjes dhe mprehtësinë e problemeve, por edhe nivelin e lartë të konsumimit politik e moral të partive tradicionale. Partitë qeverisëse në Itali u fokusuan shumë në përballimin e efekteve të krizës ekonomike e botërore financiare në vend, por në një farë mënyre nënvleftësuan akuzat e populistëve ndaj tyre, që i bënin përgjegjës për to.

Dhe ja, në renditjen e rezultatit të zgjedhjeve në Itali, dy partitë tradicionale apo të vjetra politike, "Forca Italia" dhe "Partia Demokratike" mbetën shumë prapa dy partive populiste. Ky rezultat dëshmoi dështimet në qeverisjen e mëparshme, por nuk ishte dhe nuk mund të jetë votë kundërshtuese ndaj projektit europian. Kjo fitore e populistëve në Itali nuk mund të shkojë pa u vënë re, apo të gjykohet me sloganin "kjo është demokracia", apo se "kështu ka vendosur sovrani". Natyrisht, që është një vendimmarrje e popullit italian, por qëndrimi e roli i Italisë në mbështetje të projektit europian dhe sistemit të vlerave ka rëndësi të veçantë në shumë aspekte, aq më tepër që BE ndodhet në një moment të rëndësishëm të konceptimit dhe ndërmarrjes së reformave të rëndësishme, në funksion të fuqizimit e ardhmërisë së projektit europian.

Gjatë fushatës elektorale këto parti kanë shpalosur edhe kritika e opsione të tjera ndaj projektit europian dhe ndaj përdorimit të euros, apo kanë hedhur edhe idenë e trajtimit të Rusisë si partner, apo se do të kërkonin edhe tërheqjen e sanksioneve ndaj Rusisë. Në atë program, që është dakordësuar deri tani mes tyre, siç mësohet nga mediat, në politikën e jashtme, qeveria që po formësohet dhe nëse fillon nga puna, do të ketë në qendër interesin kombëtar të Italisë. Mësohet se do të konfirmohet përkatësia në NATO, me SHBA aleat të privilegjuar, por mendohet edhe një hapje ndaj Rusisë, që mendohet të mos shihet si kërcënim, por si partner ekonomik e tregtar, potencialisht përherë më i rëndësishëm. Brenda këtij vizioni mendohet edhe heqja e sanksioneve ndaj Rusisë. Nëse kjo qeveri do të fillojë nga puna, me këtë program do të krijojë shqetësime të reja brenda BE. Nuk pritet që populistët të ndryshojnë filozofinë e sidomos e tyre, por pritet që partitë pro projektit europian të lëvizin sa më shpejt në drejtim të zhvillimit të qëndrimit kritik brenda vetes, që t'i kontribuojnë në mënyrë demokratike mbrojtjes së sistemit të vlerave, brenda zhvillimeve në Itali. Nevojitet një ndërgjegjësim i elektoratit italian për pritshmëritë që mundësohen nga çdo shmangie nga projekti europian dhe sistemi i vlerave, ku përveç partive proeuropiane edhe strukturat e shoqërisë civile e sidomos brezi i ri nevojitet ti kontribuojë jo ftohjes, por afrimit të mëtejshëm me sistemin e vlerave. Projekti europian është pronë e popullit italian para së gjithash, por klasat politike duhet t'i kontribuojnë si afrimit, ashtu edhe aftësimit për ta mbrojtur projektin europian, për ta avancuar e mos lejuar çdo cenim apo devijim prej tij.

Siç mësohet nga mediat, bëhet fakt në Itali një qeverisje me koalicion të dy partive populiste, edhe pse akoma nuk ka një emër për kryeministër, që kështu mbyll mundësinë e shkuarjes në zgjedhje të parakohshme. Tash dakordësia për qeverisje është arritur. Në funksion të idesë që ne jemi e do të jemi ndryshe, "Lëvizja 5 Yjet" dhe "Lega Nord" kanë menduar ta cilësojnë kontratën qeverisëse "Kontrata për qeverinë e ndryshimit", që shënon kështu zgjidhjen e krizës politike apo mbylljen e saj, por edhe nxjerrjen jashtë rolit protagonist të partive të vjetra, që u ndëshkuan nga vota e elektoratit. Di Maio dhe Salvini kanë gjetur dakordësinë qeverisëse, të materializuar në një dokument me mbi 20 pika, që ka në fokus sistemin fiskal, pensionet, të ardhurat minimale e punësimin, planin industrial etj. Në funksion të filozofisë së ndryshimit, programi i qeverisjes fokusohet te të ardhurat e qytetarëve, vendet e punës dhe në një reformë të qendrave të punësimit, nivelin e jetesës. Qeveria e re populiste në Itali duket se pretendon ndryshimin, por në proces do të mësohen edhe metodologjia, se si do të punojë për plotësimin e objektivave të vendosur dhe sidomos sa e aftë e efektive do të rezultojë, do të provohet nëse do të jetë realisht efektive dhe e suksesshme apo do të dështojë, duke ia lënë vendin një krize dhe një zgjidhjeje të re politike.

Prova ka filluar që nga prezantimi i kontratës. Kjo ka shumë rëndësi për fatin e qeverisjes, por sidomos me vendin e rolin e Italisë në zhvillimet europiane rajonale e botërore. E një rëndësie të veçantë është fakti se, në ç'marrëdhënie do të jetë ky ndryshim i pretenduar me përmbajtjen e projektit europian dhe qëndrimin e kontributin për mbrojtjen e avancimin e tij, me sistemin e vlerave, me reformimin funksionimin dhe të ardhmen e BE. Ky element do të ndikojë shumë në konkretizimin e qëndrimit të italianëve ndaj qeverisjes së re të ndryshimit. Besoj se italianët me votën e tyre kërkuan ndryshimin e qeverisjes, apo rritjen e efektivitetit të saj, por nuk besoj se do të pajtohen me ndryshimin e kursit europian e të avancimit të projektit europian. Ndryshimet në qeverisje e programe zhvillimi janë të domosdoshme, por ndryshimi i linjave themelore esenciale, siç është edhe marrëdhënia me projektin europian, sistemin e vlerave, BE e institucionet e saj, është problem thelbësor e kritik. Rezultati zgjedhor në Itali nuk është kurrsesi mandat kundër projektit europian apo mandat për populistët për të ndryshuar kursin europianist të Italisë.

www.gsh.al www.gsh.al www.gsh.al www.gsh.al www.gsh.al www.gsh.al

GAZETA SHQIPTARE

GSH.AL

- Na merrni!
- Na shkruani!
- Na lexoni!

GSH
www.gsh.al

Tashmë edhe lundroni!

